



nga

për

data

Ebu El-Hasen En-Nedevi

RRËFIME MBI  
PEJGAMBERËT  
PËR FËMIJË



LOGOS·A

Shkup, 2010

Copyright©Logos-A, 2010

Shënimi i CIP katalogut të këtij  
libri gjendet  
në Bibliotekën Kombëtare  
Universitare

ISBN 9989-58-352-8



Këtë libër gjithashtu mund ta gjeni  
edhe në bibliotekën  
elektronike të LOGOS-A  
në adresën e internetit  
<http://www.logos-a.com.mk>

Të gjitha të drejtat janë  
të rezervuara. Ky libër mund të  
kopjohet pjesërisht për përdorim  
personal dhe jofitimprurës.  
Kjo rekomandohet për qëllime  
promovuese të librit apo edhe për  
afirmim të kulturës së leximit në  
përgjithësi. Por, nuk lejohet  
riprodhimi, transmetimi apo kopjimi  
i këtij libri pa lejen paraprake  
të LOGOS-A.

EBU EI-HASEN EN-NEDEVI

RRE FIME MBI  
PEJGAMBERËT  
PËR FËMIJË

1-12

titulli i origjinalit:  
KISASUN-NEBIJJINE LILETFALI  
EBU EI-HASEN EN-NEDEVI

Shqipëroi nga gjuha arabe:  
Ataull-llah Aliu

## FJALA E SEJJID KUTUBIT PËR HASAN EN NEDEVIUN

E njoha autorin e kësaj broshure personalitetin Ebul-Hasen en-Nedevij, përmes penës së tij, një zemër dhe mendje islame, një njeri që jeton me Islamin, për të dhe që e njeh mirë atë.

Kjo është dëshmia të cilën e bëj për hir të All-llahut dhe e prezentoj këtë botim të kësaj broshure.

Rrëfimet për peygamberët, për fëmijë - në format të vogël - përbëjnë një vepër të çmuar të Ebul-Hasanit dhe vëllezërve të tij të nderuar në suazat e thirrjes islame. Nuk janë vetëm të rriturit ata të cilëve medeomos duhet t'u ofrohet Islami në formën e tij të pastër, por edhe zemrat e të vegjëlve kanë nevojë të madhe për këtë ushqim, që të ngopen

dhe ta shijojnë besimin e mirëfilltë në shpirtrat e tyre, dritën e tij në zemrat e tyre, buzëqeshjen e tij në shpirtërat e tyre, andaj pikërisht "Tregimet" janë materiali i parë që do t'i furnizojë këto zemra të vogla (shpirtdëlira).

Kjo broshurë edhe pse është shkruar për të vegjëlit, megjithatë, ka rëndësi për t'u lexuar edhe nga të rriturit. E shumicës, për shkak të kolonializmit të huaj nuk i është dhënë rasti për t'u edukuar e mësuar diç nga rrëfimet e Kur'anit Fisnik, për qëllimet e tij të thella, rëndësinë e imanit, ndikimin dhe edukimin e tij, ashtu siç e gjithë kjo është e parashtruar në këtë broshurë.

Kam lexuar shumë nga librat për fëmijë të cilët kanë të bëjnë me rrëfimet për peygamberët, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi ta, - dhe në Egjipt kam bashkëpunuar në hartimin e përmbledhjes "Tregime fetare për fëmijë", gjithashtu e marrë nga Kur'ani Fisnik. Andaj, pa e tepruar dëshmoj se puna e Ebul-Hasanit

në këtë broshurë që e kam në duar, është më e përkryer nga të gjitha ato të lartëcekurat. Them kështu për arsye se ajo përmban metoda të urta dhe shqyrtime të qarta të qëllimit të tregimit, ngjarjeve dhe qëndrimeve, shpjegimet dhe kuptimet në brendinë e tregimit, kështu që kjo kur të zë vend në brendinë e zemrave të të vegjëleve ose të mëdhenjve.

All-llahu e shpërbleftë me të mirë Ebul-Hasanin, ia shtoftë suksesin, me këtë i udhëzofte brezat e rinj (pasues) të cilët rrahen me stuhi dhe fortuna të ndryshme në rrugën e të cilëve mbillen ferra, e nga rrethi i tyre paraprihen në rreziqe, breza që kanë nevojë për udhëzim, dritë dhe përkujdesje, për sinqeritet në mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e tyre. All-llahut i takon sukcesi dhe Ai është më meritator për të gjitha.

*Sejjid Kutub*

## Fjala e Botuesit

Në vargun e gjatë të bibliotekës Filizat që ka filluar me lektyrat shkollore e që vazhdon me shumë tituj të tjerë interesante e të dobishëm për lexuesit tanë më të vegjël, kësaj radhe SHB "Logos-A" ka vendosur të botojë një seri të veçantë duke botuar 12 tituj nga historia e peygamberëve.

Aty, përmes rrëfimeve të bukura e me gjuhë të lehtë të autorit E.H. Nedevi, si dhe përkthimit të shkëlqyeshëm të përkthyesit Ataullah Aliu, të vegjëlve u ofrohen shumë ngjarje të historisë islame që besojmë se do ta përmbushin kërshërinë e fëmijëve, por edhe do t'u mundësojnë ta mësojnë historinë e pasur e të lavdishme të peygamberëve të Allahut.

*Botuesi*

## PARATHËNIE

I nderuar biri<sup>1</sup> i vëllait tim!

Të shoh se i lakmon rrëfimet dhe tregimet. I këtillë është çdo fëmijë i moshës sate. Këto rrëfime i dëgjon me gjithë dëshirë, i lexon me shumë vullnet, mirëpo unë brengosem sepse në dorën tënde nuk shoh tjetër përpos tregimeve për macet, për qentë, për luanët, për ujqit, për majmunët dhe arinjtë, e për këtë ne duhet të bartim përgjegjësinë, e kjo është ajo që e has të botuar.

Tanimë ke filluar ta mësosh gjuhën arabe meqë ajo është gjuhë e Kur'anit, e të dërguarit dhe gjuhë e fesë, e ti ke vullnet të mrekullueshëm në të mësuarit e saj, por unë turpërohem meqë ti nga tregimet arabe nuk e gjen atë që i përgjigjet moshës sate, përpos tregimeve për shtazët, përrallave dhe të trillimeve të ndryshme.

E pashë të arsyeshme që të shkruaj tregime mbi pejgamberët (paqja dhe

<sup>1</sup> Muhammedi, i biri i dr. Abdul-Ali El-Husni, i biri i vëllaut të autorit, falënderojmë All-llahun që u dallua në arabisht, është redaktor i revistës "Rilindja Islame" e cila botohet në Lukë të Indisë.

shpëtimi i All-llahut qofshin mbi ta), për ty dhe për bijtë e muslimanëve të moshës sate në një stil të lehtë që i përgjigjet moshës dhe shijes tënde, dhe këtë e bëra, e ky është libri i parë nga "Rrëfime mbi peygamberët për fëmijë", që ta dhuroj ty.

Duke u nisur nga stili dhe natyra e fëmijëve, u mbështeta në përsëritjen e fjalëve dhe fjalive, në fjalët e lehta dhe në qartësinë e tregimit.

Shpresoj që ky libër i vogël do të jetë libri i parë dhe një nismë e mbarë që fëmijët do ta lexojnë në gjuhën arabe (shqipe) dhe që do ta mësojnë në shkollat e tyre.

Do të gëzoj nëse do All-llahu me tregimet për peygamberët, të dobishme për mrekulli, të pastra e të përshtatshme, të lehta e të bukura, ndërkaq, në ta nuk ka asgjë nga gënjeshtria dhe trillimi.

O Muhamed! Me ty All-llahu e gëzoftë madhërinë tënde, të prindërve tu, të xhaxhait tënd dhe të Islamit dhe e përtëritë bereqetin e stërgjyshërve tu ndaj teje, në këtë shtëpi dhe mbi gjithë muslimanët.

*Ebul-Hasen en-Nedevi*



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NE EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Kush i  
theu  
idhujt?

|



## 1 SHITËSI I IDHUJVE

Para një kohe të lasht,  
në një fshat ishte një njeri i famshëm i  
quajtur Azer dhe i cili shiste idhuj.

Në këtë fshat gjendej një shtëpi e  
madhe në të cilën kishte shumë idhuj.

E njerëzit u përkuleshin këtyre idhujve.

Edhe Azeri u përkulej këtyre idhujve  
dhe i adhuronte me të madhe.

## 2 DJALI I AZERIT

Azeri kishte një djalë fort besimdrejt.

Ky djalë quhej Ibrahim.

Ibrahimi i shihte njerëzit duke iu përkulur  
idhujve dhe duke i adhuruar ato.

Ibrahimi e dinte se idhujt janë gurë.

E dinte se gurët nuk flasin dhe nuk  
dëgjojnë.

E dinte se gurët nuk bëjnë dëm por dhe  
nuk sjellin dobi.

Vërente se miza qëndronte mbi idhuj e

ato nuk mundnin ta largonin.

Vërente se miu e hante ushqimin e idhujve e nuk pengohej.

Ibrahimi thoshte vetë me vete: përse njerëzit, u përkulen idhujve?

Ibrahimi i parashtronte vetes pyetje:  
Përse njerëzit u luten idhujve?

## 3 KËSHILLA E IBRAHIMIT

Ibrahimi i thoshte prindërit të vet:

O babai im, përse i adhuron këta idhuj?

O babai im, pse u përkulesh këtyre idhujve?

O babai im, pse u lutesh këtyre idhujve?

Vërtet këta idhuj nuk flasin dhe nuk dëgjojnë!

Vërtet këta idhuj nuk dëmtojnë dhe nuk sjellin dobi!

Për çfarë arsye u shtron atyre ushqim dhe pije?

O babai im, vërtet këta idhuj nuk hanë dhe nuk pinë!

E Azeri hidhërohej, nuk kuptonte.

Ibrahimi e këshillonte popullin e vet, e njerëzit hidhëroheshin dhe nuk e kuptonin.

Ibrahimi tha: Kur të shkojnë njerëzit unë do t'i thyej idhujt e me këtë rast ata do të kuptojnë.

## 4 I BRAHIMI I THYEN IDHUJT

Erdhi dita e festës e njerëzit u gëzuan.

Për festë dolën të mëdhenj e të vegjël.

Edhe prindi i Ibrahimit doli, ndërkaq Ibrahimit i tha: nuk del edhe ti me ne?

Ibrahimi u përgjigj: Unë jam i sëmurë!

Njerëzit shkuan e Ibrahimi mbeti në shtëpi.

Ibrahimi erdhi tek idhujt dhe u tha:

A nuk flitni? A nuk dëgjoni?

Ky është ushqim dhe pije! A nuk hani?  
A nuk pini?

Idhujt heshtnin sepse ata janë gurë e nuk flasin.

Ibrahimi tha: “Çka keni pra, që nuk po flitni”?

Idhujt heshtën dhe nuk folën.

Me këtë rast Ibrahimimi u hidhërua dhe e mori sëpatën, u ra idhujve me sëpatë dhe i theu që të gjithë.

Idhullin më të madh Ibrahimimi e la dhe e vari sëpatën në qafën e tij.

## 5 KUSH E BËRI KËTË?

Njerëzit u kthyen dhe hynë në tempullin e idhujve.

Ata dëshiruan t'u përkulen idhujve meqë kjo ishte ditë feste.

Mirëpo, ata u çuditën dhe mbetën pa fjalë.

Por edhe u brengosën dhe u hidhëruan.

Ata thanë: “*Kush e bëri këtë me zotat tanë?*”

Pastaj thanë: “*Kemi dëgjuar për një djalosh që i përgesh ato, të cilin e quajnë Ibrahim.*”

“*I thanë: A e bëre ti këtë me zotat tanë, o Ibrahim?*”

“*Ai u përgjigj: Jo atë e bëri i madhi i tyre, ju pyeteni ata nëse janë që flasin?*”

Njerëzit e dinin se idhujt janë gurë.

E dinin se gurët nuk dëgjojnë dhe nuk flasin.

E dinin se edhe idhulli më i madh gjithashtu është gurë.

Se idhulli më i madh nuk mund (nuk është i aftë) të ecë dhe të lëvizë.

Se idhulli më i madh nuk mund t'i thyejë idhujt.

E Ibrahimit i thanë: Ti e di se idhujt nuk flasin.

Ibrahimi tha: Po si i adhuroni idhujt, vërtetë ata nuk dëmtojnë dhe nuk sjellin dobi?

Si u luteni idhujve, vërtet ata nuk flasin dhe nuk dëgjojnë?

A nuk kuptoni asgjë, a nuk mendoni?

Njerëzit heshtën dhe u turpëruan.

## ZJARR I FRESKËT

Njerëzit u tubuan dhe thanë: Çfarë bëjmë? Vërtet Ibrahim i theu idhujt dhe i ofendoi zotat!

Njerëzit pyetnin: Çfarë dënimi i takon Ibrahimit?

Çfarë ndëshkimi i takon Ibrahimit?  
Përgjigjja ishte: *"Digjeni atë (Ibrahimin)  
dhe ndihmoni zotat tuaj."*

Kështu edhe u bë: e ndezën zjarrin dhe e hudhën në të Ibrahimin.

Mirëpo All-llahu e ndihmoi Ibrahimin dhe zjarrit i tha: *"O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin"*.

E zjarri u bë i freskët dhe shpëtim për Ibrahimin.

Kështu njerëzit panë se zjarri nuk e dëmton Ibrahimin.

Gjithashtu njerëzit panë se Ibrahim i ishte i gëzuar, se ishte shëndoshë e mirë, kështu që u habitën dhe u hutuan tepër.

## 7 KUSH ËSHTË ZOTI IM?

Një natë Ibrahim i pa një yll dhe tha:  
Ky është zoti im.

E kur humbi ylli, Ibrahim i tha:

Jo, ky nuk është zoti im.

Pastaj Ibrahim i e pa Hënën dhe tha:

Ky është zoti im?

E kur humbi Hëna, Ibrahimimi tha:

Jo, ky nuk është zoti im.

Lindi Dielli e Ibrahimimi tha:

*“Ky është zoti im, ky është më i madhi.”*

Kur Dielli humbi në natë, Ibrahimimi tha:

Jo, ky nuk është zoti im.

Vërtetë All-llahu është i gjallë, nuk vdes.

All-llahu është i përhershëm, nuk humb.

All-llahu është i fuqishëm, Atë nuk mund ta mposhtë asnjë send.

Ylli është i dobët meqë e mposht mëngjesi.

Hëna është e dobët meqë e mposht Dielli.

Dielli është i dobët meqë e mposht nata dhe mjegulla.

Nuk më ndihmon ylli, sepse është i dobët.

Nuk më ndihmën Hëna sepse ajo është e dobët

Nuk më ndihmon Dielli, sepse ai është i dobët.

Mua më ndihmon vetëm All-llahu.

Sepse All-llahu është i gjallë, nuk vdes.  
I përhershëm, nuk humb.  
I fuqishëm, Atë nuk mund ta mposhtë  
asgjë.

## 8 ZOTI IM ËSHTË ALL-LLAHU

Ibrahimi e kuptoi se All-llahu është  
Zoti i tij.

Se All-llahu është gjallë, nuk vdes.  
All-llahu është i përhershëm, nuk humb.  
All-llahu është i fuqishëm Atë nuk  
mund ta mposhtë asgjë.

Ibrahimi e kuptoi se All-llahu është  
Zoti i yllit.

All-llahu është Zot i Hënës.  
All-llahu është Zot i Diellit.  
All-llahu është Zot i të gjithë botëve.  
All-llahu e udhëzoi Ibrahimin, e bëri  
pejgamber dhe të afërm.

All-llahu e urdhëroi Ibrahimin që ta  
thërrasë popullin e tij dhe ta pengojë atë  
nga adhurimi i idhujve.

## 9 THIRRJA E IBRAHIMIT

Ibrahimi e thirri popullin e vet në rrugë të All-llahut dhe i pengoi ata nga adhurimi i idhujve.

Ibrahimi popullit të vet i tha: Çka jeni duke adhuruar?

*“Ata i thanë: adhurojmë idhujt.”*

*“Ibrahimi u tha: A ju dëgjojnë ata juve kur u luteni?”*

*“Ose, a ju sjellin juve dobi apo dëm?”*

*“Ata thanë: Por kështu i gjetëm se bënin edhe prindërit tanë!”*

Ibrahimi tha: E unë nuk i adhuroj këta idhuj, por jam armik i tyre.

Unë e adhuroj Zotin e botëve.

*“Zoti që më krijoi, Ai më udhëzoi mua.”*

*“Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pijë.”*

*“Dhe kur të sëmurem Ai më shëron.”*

*“Ai më bën të vdesë e mandej më ngjall.”*

Ndërkaq, idhujt nuk krijojnë dhe nuk udhëzojnë, ata nuk e ushqejnë dikë dhe nuk i japin të pijë.

E kur të sëmuret ndokush ata nuk e shërojnë dhe ata nuk e bëjnë dikë të vdesë dhe nuk e ngjallin.

## 10 PRANË MBRETIT (sunduesit)

Në qytet ishte një mbret shumë i madh dhe shumë mizor.

Dhe njerëzit i përkuleshin mbretit.

Mbreti dëgjoji se Ibrahim i përkulet All-llahut e nuk i përkulet askujt, andaj u hidhërua dhe e kërkoi Ibrahimin.

Ibrahimi erdhi meqë ishte i tillë që nuk i frikohej askujt përpos All-llahut.

Mbreti i tha: Kush është zoti yt o Ibrahim?

Ibrahimi u përgjigj: Zoti im është All-llahu.

Mbreti pyeti: Kush është All-llahu o Ibrahim?

Ibrahimi tha: *“Ai që jep jetë dhe vdekeje!”*

Mbreti tha: *“Edhe unë jap jetë dhe vdekeje.”*

Mbreti e thirri një burrë dhe e mbyti atë.

E thirri një tjetër dhe e liroi.

Dhe tha: Unë jap jetë dhe vdekje, një burrë e mbyta e tjetrin e lirova.

Mbreti ishte shumë i marrë, e i këtillë është çdo idhujtar. Ibrahimimi dëshironte që ta kuptojë mbreti dhe ta kuptojë populli i tij.

Ibrahimimi i tha mbretit: *“Zoti im sjell Diellin nga Lindja, sille ti ate nga Perëndimi.”*

Mbreti u habit dhe heshti.

Ai u turpërua dhe nuk gjeti përgjigje.

## || THIRRJA PËR PRINDËRIN E VET

Gjithashtu Ibrahimimi dëshironte ta thirrte babain e tij dhe atij i tha:

*“O babai im, pse e adhuron atë që as nuk dëgjon, e as nuk sheh!”*

*“Pse adhuron atë që nuk të bën dobi e as nuk të dëmton!”*

*“O babai im, mos adburu djallin!”*

O babai im adhuroje Mëshiruesin!  
Babai i Ibrahimit u hidhërua dhe tha:  
Unë të kundërvihem, më lë rehat dhe  
mos më thuaj asgjë.

Ibrahimi ishte i urtë dhe babait të vet i  
tha: *“Qofsh i lirë prej meje”*

Njëherit i tha: Unë shkoj prej këtu dhe i  
lutem Zotit tim.

Ibrahimi u brengos fort, shprehu  
dëshirë të shkojë në qytet tjetër, ta  
adhurojë Zotin e Tij dhe t'i ftojë njerëzit  
në rrugë të All-llahut.

## 12 NË MEKË

U hidhërua populli i Ibrahimit, u  
hidhërua mbreti dhe u hidhërua babai i  
Ibrahimit.

Ibrahimi dëshiroi të shkojë në një qytet  
tjetër që atje ta adhurojë All-llahun dhe  
t'i ftojë njerëzit për ta njohur All-llahun.

Ibrahimi u përshëndet me babain dhe  
doli nga qyteti i tij.

Ai ia mësyu Mekes e me te ishte edhe bashkëshortja e tij Haxherja.

Meka ishte e tillë që nuk kishte as bar në të e as drurë.

Nuk kishte në të as pus e as lumë.

Nuk kishte në të kafshë e as njeri.

Ibrahimi arriti në Mekë dhe u vendos në të.

Ai e braktisi bashkëshorten e tij Haxheren dhe djalin e tij Ismailin, e kur vendosi të shkojë Ibrahimi bashkëshortja e tij Haxherja e pyeti: ku ia ke msy o zotëriu im?

A më braktis mua këtu?

A më braktis, e këtu nuk ka as ujë e as ushqim!

A thua All-llahu të urdhëroi të veprosh kështu?

Ibrahimi iu përgjigj: Po!

Haxherja tha: Atëherë mos na humb neve të dy.

## 13 PUSI I ZEMZEM-it

Ismaili ndjeu etje menjëherë, nëna e tij dëshiroi t'i jepte ujë për të pirë, mirëpo ku është uji? Meka si e tillë nuk ka pus e as lum!

Kështu Haxherja kërkon ujë dhe vrapon prej Safasë gjer në Merve dhe prej Merves gjer në Safa (dhe anasjelltas). All-llahu e ndihmoi Haxheren dhe djalin e saj Ismailin dhe për ta krijoi ujë.

Uji rrodhi prej tokës, piu Ismaili dhe Haxherja dhe mbeti uji, e ky ishte pusi i Zemzemit. All-llahu e bekoji Zemzemin, e ky është pusi nga i cili pinë njerëzit kur shkojnë në haxh dhe kthehen me ujë Zemzemi në vendet e tyre.

A ke pirë ujë zemzemi?

## 14 ËNDRRA E IBRAHIMIT

Pas një kohe Ibrahim i u kthye në Mekë. E takoi Ismailin dhe Haxheren,

Ibrahimi u gëzua me djalin e tij Ismailin. Ismaili ishte fëmijë i vogël, vraponte, luante dhe dilte me babain e tij.

Ibrahimi e donte Ismailin shumë.

Një natë Ibrahimi pa në ëndërr se e therrte Ismailin.

Ibrahimi ishte pejgamber i sinqertë dhe ëndrra e tij ishte ëndërr e çiltër. Ai ishte i afërmi i All-llahut, dhe dëshiroi të veprojë ashtu siç e urdhëroi All-llahu në ëndërr.

Ibrahimi i tha Ismailit: *“Unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?”*

*Ismaili iu përgjigj: O babai im, vepra ashtu siç je urdhëruar, e ti do të më gesh mua, nëse do All-llahu, prej durimtarëve!”*

Ibrahimi e mori Ismailin me vete e gjithashtu e mori edhe thikën.

Kur Ibrahimi arriti në Mine, deshti ta therrte Ismailin. Ismaili u shtri në tokë. Ibrahimi deshti ta therrte dhe e vëndoi thikën në fyt të Ismailit.

Mirëpo All-llahu dëshiron të shohë, a do të veproj miku i tij ashtu siç urdhërohet.

Dhe, a më shumë e do All-llahun apo birin e vet.

Dhe Ibrahim kaloi në provim.

All-llahu e dërgoi Xhibrilin me një dash prej xhenetit (parajsës) dhe i tha: There këtë e mos e ther Ismailin.

All-llahu pëlqeu veprën e Ibrahimit dhe muslimanët i urdhëroi me therje në Bajramin e Kurbanit.

Paqja dhe shpëtimi i All-llahut qofshin mbi dashamirin Ibrahim.

Po ashtu paqja dhe shpëtimi i All-llahut qofshin mbi birin e tij Ismailin.

## 15 QABJA

Ibrahimi shkoi, e më vonë u kthye, dhe deshti të ndërtojë një shtëpi të All-llahut. Shtëpia kishte shumë, mirëpo nuk kishte shtëpi të All-llahut që në të adhurojnë All-llahun.

Edhe Ismaili me babain e tij deshi të ndërtojë një shtëpi të All-llahut.

Ibrahimi bashkë me Ismailin i bartën gurët nga kodrat.

Ibrahimi dhe Ismaili ishin ata të cilët e ndërntuan Qaben me duart e tyre.

Ibrahimi e përkujtonte All-llahun dhe i lutej Atij.

Edhe Ismaili e përkujtonte All-llahun dhe i lutej Atij.

*“O Zoti ynë, prano prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di shumë”.*

E All-llahu pranoi lutjen prej Ibrahimit dhe Ismailit dhe e bekoj Qaben.

Ne drejtohem kah Qabja për çdo namaz.

Muslimanët udhëtojnë për në Qabe në ditët e haxhit.

Sillen rreth e rrotull Qabes dhe falen në të.

All-llahu e bekoj Qaben dhe e pranoi lutjen prej Ibrahimit dhe Ismailit. Paqja dhe shpëtimi i All-llahut qofshin mbi Ibrahimin, Ismailin dhe Muhammedin.

## KSHITËPIA E SHENJTË

Ibrahimi kishte edhe një bashkëshorte tjetër e cila quhej Sara.

Gjithashtu ai kishte edhe një djalë tjetër prej Sarës i cili quhej Is'hak.

Ibrahimi banonte në Sham, e aty banonte edhe Is'haku.

Is'haku ndërtoi një shtëpi të All-llahut (xhami) në Sham, siç e ndërtuan një shtëpi të All-llahut babai i tij dhe vëllai i tij në Mekë.

Prandaj kjo xhami (mesxhid) që e ndërtoi Is'haku në Sham është shtëpi e shenjtë.

Kjo shtëpi e shenjtë është Mesxhidi Aksaja, që All-llahu e bekoj rrethin e saj, Ai i bekoj bijtë e Is'hakut siç i bekoj bijtë e Ismailit, të cilët ishin peygamberë dhe mbretër.

Is'haku kishte një djalë i cili quhej Jakub dhe ishte peygamber.

Ndërkaq Jakubi kishte dymbëdhjetë djem, prej tyre ishte Jusufi i biri i Jakubit.

E Jusufi është ai për të cilin në Kur'an  
është shkruar një rrëfim mahnitës  
(i mrekullueshëm).

E tani, në pjesën tjetër vijon ky rrëfim!



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Rrëfimet  
më të  
bukura

2



## ËNDËRR E HABITSHME

Jusufi ishte djalosh që kishte njëmbëdhjetë vëllezër. Ai ishte djalë i bukur dhe tejet i zgjuar e mendjeprehtë. Babai i tij, Jakubi, atë e donte më shumë se të gjithë bijtë e tij të tjerë. Një natë Jusufi pa ëndërr të habitshme.

Pa njëmbëdhjetë yje, pa diellin dhe hënën, të cilat të gjitha i përkuleshin atij.

Jusufi i vogël u habit shumë! Nuk e kuptoi këtë ëndërr se si i përkulen njeriut yjet, dielli dhe hëna? Jusufi i vogël shkoi te babai i tij Jakubi dhe ia rrëfeu atij këtë ëndërr të mrekullueshme.

I tha: *“O babai im, unë pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin e hënën, i pashë duke më bërë mua sexhde!”*

Babai i tij ishte pejgamber.

Jakubi për shkak të kësaj ëndrre u gëzua shumë.

Babai iu përgjigj: "All-llahu të bekoftë ty o Jusuf, se ti gjatë jetës sate do të arrish shumë (do të kesh prestigj)".

Kjo ëndërr është sihariq për dituri dhe pejgamberi.

All-llahu e begatoi gjyshin tënd Is'hakun dhe stërgjyshin tënd Ibrahimin.

E Ai të begaton edhe ty dhe familjen e Jakubit.

Jakubi ishte i shtyrë në moshë, i njihte vetitë e njerëzve, e dinte se si mposhtë shejtani dhe si ai luan me njerëzit.

Për këtë arsye i tha: *“O djali im, mos ia trego këtë ëndërr ndonjërit prej vëllezërve tu, sepse ata do të xhelozojnë dhe do të bëhen armiq të tu.”*

## 2 ZILIA E VËLLEZËRVE

Jusufi kishte një vëlla tjetër prej nëne, i cili quhej Bunjamin.

Jakubi që të dy i donte fort, ashtu që nuk e donte asnjërin si këta të dy.

Vëllezërit hidhëroheshin dhe ndjenin xhelozin ndaj Jusufit dhe Bunjamin.

Ata thonin: "Përse babai ynë më shumë i don Jusufin dhe Bunjamimin?"

Përse babai ynë i don Jusufin dhe Bunjaminin e ata janë më të vegjël dhe të dobët?

Përse nuk na don neve sikur Jusufin dhe Bunjaminin, kur ne jemi djelmosha të fortë? Kjo është një punë e çuditshme?!"

Jusufi meqë ishte djalë ende i vogël, ua tregoi ëndrrën vëllezërve të tij, e vëllezërit kur e dëgjuan ëndrrën u hidhëruan fort, kështu që zilia e tyre u shtua edhe më tepër.

Një ditë u tubuan vëllezërit dhe thanë: "Ta mbysim Jusufin ose ta largojmë në ndonjë vend të largët".

Me këtë rast babai i ynë do të ketë dashuri të singertë ndaj nesh.

Njëri prej tyre tha: "Jo, por do ta lëshojmë atë në ndonjë pus rreth ndonjë rrugë, ku do ta marrë dikush nga kalimtarët".

Me këtë vendim u pajtuan të gjithë vëllezërit.

### 3 DELEGACIONI PËR TE JAKUBI

Pasi që u pajtuan për këtë mendim, erdhën te Jakubi.

Jakubi frikohej shumë për Jusufin, meqë e dinte se vëllezërit e xhelozojnë dhe nuk e duan.

Jakubi nuk e lëshonte Jusufin me vëllezërit e tij.

Jusufi luante me vëllaun e tij dhe nuk shkonte larg.

Vëllezërit e dinin këtë, por ata vendosën për të keq.

Ata thanë: O babai ynë, përse nuk e lëshon Jusufin me ne? Pse frikohesh?

Ai është vëllai ynë i vogël dhe i nderuar, e ne të gjithë jemi bijtë e një babait. Vëllezërit përherë luajnë së bashku.

Përse ne të mos shkojmë e të lozim së bashku?

*“Dërgoje nesër atë me ne, le të hajë pemë dhe le të luajë, me siguri do ta ruajmë atë”.*

Jakubi ishte i shtyrë në moshë, i mençur dhe i urtë, prandaj nuk dëshironte që Jusufi të largohet prej tij.

Për këtë arsye edhe druante fort për Jusufin.

Bijve të vet u tha:

*"Kam frikë se do ta hajë ujku, kur mungon kujdesi juaj për të".*

Ata thanë: "Kurësesi! Si do ta hajë ujku duke qenë ne të pranishëm?"

Si do ta hajë, duke qenë ne djelmosha të fuqishëm?"

Dhe Jakubi e lejoi Jusufin.

## 4 PËR NË MAL

Kur Jakubi i dha leje Jusufit, vëllezërit u gëzuan shumë.

Shkuan në një mal dhe Jusufin e lëshuan në një pus të malit. Nuk patën mëshirë ndaj Jusufit të vogël, nuk patën mëshirë as ndaj plakut të shtyrë në moshë, Jakubit.

Jusufi ishte djalë i vogël, kishte zemër të vogël.

Pusi ishte i thellë dhe tejet i errët.

Jusufi ishte i vetmuar.

Mirëpo All-llahu e silaroi Jusufin dhe i tha: "Mos u dëshpëro dhe mos u friko".

All-llahu është me ty, dhe ti do të realizosh të arritura të mëdha.

"Vëllezërit tu do të vijnë te ti dhe do t'u tregosh se si kanë vepruar".

Meqë e lëshuan Jusufin në pus dhe u liruan nga ai, u tubuan dhe thanë:

"Çfarë do t'i themi babait tonë?"

Disa prej tyre thanë: "Babai ynë thoshte se frikohem se mos do ta hajë Jusufin ujku, e ne do t'i themi atij se e ka thënë të vërtetën dhe se vërtet Jusufin e hëngri ujku".

Vëllezërit u pajtuan për këtë dhe vendosën që babait të tyre t'i thonë se vërtet Jusufin e ka hëngër ujku.

Disa prej vëllezërve thanë: "Por çfarë dëshmie do të kemi për këtë?"

Ata thanë: "Dëshmia e kësaj do të jetë gjaku".

Vëllezërit morën një dash dhe e therrën, ndërsa me gjakun e tij e ngjyrosën këmishën e Jusufit.

Vëllezërit u gëzuan fort dhe thanë:  
"Tani babai ynë do të besojë".

## 5 PRANË JAKUBIT

*"E në mbrëmje erdhën duke qarë te babai i tyre".*

*"Thanë: O babai ynë, ne shkuam të bëjmë gara, e Jusufin e lamë te teshat tona, por atë e kishte ngrënë ujku"!*

*"Si dëshmi ia sollën këmishën e Jusufit të përlyer me gjak të rrejsëm".*

I thanë: "Ja, ky është gjaku i Jusufit!"

Babai i tyre Jakubi ishte pejgamber, i shtyrë në moshë dhe shumë më i mençur se djemtë e tij.

Jakubi e dinte se kur ujku e han njeriun, e copëton atë dhe ia shqyen këmishën.

Ndërkaq këmisha e Jusufit ishte e paprekur, edhe pse e ngjyrosur me gjak,

Jakubi e dinte se ai është gjak i rrejshëm dhe se rrëfimi i ujkut është rrëfim i trilluar.

Jakubi djemve të vet u tha: *“Këtë rrëfim e menduat”, por “durim të mirë”*. Jakubi shumë u dëshpërua për Jusufin, mirëpo ai bëri durim të mirë.

## **J**JUSUFI NË PUS

Kështu pra vëllezërit u kthyen në shtëpi, e Jusufin e lanë në pus.

Vëllezërit darkuan dhe ranë për të fjetur.

E Jusufi në pus, as shtrat e as ushqim.

Vëllezërit e harruan Jusufin dhe fjetën.

Por Jusufi nuk fjeti dhe nuk e harroi asnjërin.

Jakubi mbeti duke e përmendur Jusufin, e Jusufi mbeti duke e përmendur Jakubin.

Jusufi gjendej në pus, e pusi ishte i thellë.

Pusi gjendej në mal, e mali ishte i shkretë, ishte natë, e nata ishte tejet e errët.

# 7 PREJ PUSIT NË PALLAT

Një grup njerëzish kaluan nëpër mal.  
Gjatë rrugës i pushtoi etja dhe kërkonin  
ndonjë pus.

Më vonë e panë pusin dhe dërguan një  
njeri që t'u sjellë atyre ujë.

Njeriu shkoi te pusi dhe e lëshoi kovën  
në pus; kur e tërhoqi kovën ajo ishte e  
rëndë.

E kur e nxori atë, por ç'të shihte, në  
kovë gjendej një djalosh!

Njeriu u habit dhe bërtiti:

*"Sibariq! Ja një djalosh!"*

Njerëzit u gëzuan shumë dhe e fshehën  
Jusufin.

Arritën në Egjipt, dolën në treg dhe  
brohoritnin:

"Kush e blen këtë djalosh? Kush e blen  
këtë djalosh?"

Azizi e bleu Jusufin me dirhemë të  
caktuar - me pak para.

Tregtarët e shitën atë, por nuk e njohën  
Jusufin.

Azizi shkoi me të në pallatin e tij dhe i tha gruas së tij që të sillet mirë me Jusufin, se vërtet ai është djalë besnik.

## 8 BESNIKËRIA DHE NDERSHMËRIA

Bashkëshortja e Azizit i bëri lajka Jusufit për ta tradhtuar. Mirëpo, Jusufi u largua dhe tha: Kurrresi!

Unë nuk e tradhtoj zotëriun tim, sepse ai bëri mirë ndaj meje dhe më respektoi.

Unë i frikohem All-llahut.

Bashkëshortja e zotëriut u hidhërua dhe u ankua te bashkëshorti i saj.

Zotëriu e kuptoi se gruaja e tij nuk e thotë të vërtetën.

Po ashtu e kuptoi se Jusufi është besnik, dhe bashkëshortes së vet i tha: *“Vërtet ti qenke fajtores!”*

Jusufi u bë i njohur në Egjipt me bukurinë e tij, dhe çdokush që e shihte thoshte: *“Ky nuk është njeri, ky nuk është*

*tjetër vetëm se ndonjë engjëll (melek) i lartë!”.*

Hidhërimi i gruas së zotëriut u ashpërsua aq shumë saqë i tha Jusufit:

"Atëherë do të shkosh në burg!"

Jusufi iu përgjigj: *“Burgu është më i dëshiruar për mua!”.*

Pas disa ditëve zotëriu e pa të arsyeshme që Jusufi të dërgohet në burg, edhe pse e dinte se Jusufi është i pafajshëm.

Kështu Jusufi hyri në burg.

## 9 KËSHILLA NË BURG

Jusufi hyri në burg, por të gjithë të burgosurit e kuptuan se ai është djalosh fisnik, se ka dituri të madhe, dhe se ai ka zemër të mëshirshme.

Kështu, të gjithë të burgosurit e deshtën dhe e respektuan.

Njerëzit u gëzuan me Jusufin dhe e madhëruan.

Me të hyrë në burg dy burra ia treguan  
ëndrrat e tyre.

*Njëri prej tyre tha: “Unë e ëndërrova veten se  
po shtrydhi rrush për verë”.*

*“Ndërkaq tjetri tha: Unë ëndërrova se po  
bart mbi kokë një bukë nga e cila hanin  
shpezët”.*

Që të dy e pyetën Jusufin për komentin  
e ëndrrave të tyre.

Jusufi dinte t'i komentoj ëndrrat.

Ai ishte një peygamber prej peygamberëve.

Në kohën e tij njerëzit adhuronin zotëra  
të tjerë përpos All-llahut.

Shpikën shumë zota nga vetëpadituria e  
tyre.

Kështu thonin: Ky është zot i së mirës,  
ky është zot i detit, ky është zot i  
furnizimit e ky është zot i shiut.

Tërë këtë Jusufi e shihte dhe qeshte.

Tërë këtë Jusufi e dinte dhe qante.

Jusufi dëshironte t'i thërrasë ata në  
rrugë të All-llahut.

All-llahu dëshiroi që të ndodhë kjo në  
burg.

A nuk e meritojnë të burgosurit  
këshillën?

A nuk e meritojnë të burgosurit  
mëshirën?

A nuk janë të burgosurit shërbëtorë të  
All-llahut?

A nuk janë të burgosurit bijtë e  
Ademit?

Jusufi ishte në burg, mirëpo ai ishte i lirë  
dhe i guximshëm. Jusufi ishte nevojtar,  
mirëpo ishte shpirtmadh dhe bujar.

Vërtet peygamberët ngrisin zërin e së  
vërtetës në çdo vend.

Vërtet peygamberët bëjnë mirë në çdo  
kohë.

## 10 URTËSIA E JUSUFIT

Jusufi në vete tha:

Vërtet nevoja i solli këta dy burra tek unë.

E nevojtari zbutet dhe përulet.

E vërtetë, nevojtari respekton dhe  
dëgjon.

Po t'u thosha atyre dyve diç, do të dëgjonin ata dhe të burgosurit e tjerë.

Mirëpo Jusufi nuk shpejton.

Por atyre u tha:

Unë do t'ju informoj për kuptimin e ëndrrës para se t'ju vijë ushqimi.

U ulën (ata dy) dhe u qetësuan.

Në vazhdim Jusufi u tha:

Unë jam dijetar për interpretimin e ëndrrave. *“Kjo është nga ajo që ma mësoi Zoti im (nuk është fall e as parashikim)”*. Të dy të burgosurit u gëzuan dhe u qetësuan.

Këtu Jusufi e gjeti rastin dhe e filloi këshillën e tij.

## || KËSHILLA PËR MONOTEIZMIN (NJËSHMËRINË) E ALL-LLAHUT Y.H.S.H.

Jusufi tha: *“Kjo është nga ajo që ma mësoi Zoti im (nuk është fall e as parashikim)”*.

Mirëpo All-llahu nuk ia jep diturinë e vet çdokujt.

All-llahu nuk ia jep diturinë e Tij politeistit.  
A e dini (ju të dy) përse më mësoi Zoti im?  
Sepse unë e braktisa rrugën e politeizmit.

*“Unë e ndoqa fenë e prindërve të mi:*

*Ibrahimit, Is'hakut, Jakubit”.*

*“Neve nuk na takon t'i përsbkruejmë  
kurrnjë send shok All-llabut”.*

Jusufi në vazhdim tha:

Ky monoteizëm nuk është vetëm për ne.  
Por ai është për mbarë njerëzimin.

*“Ky (besim i drejtë) është dhuratë e madhe  
nga All-llahu ndaj nesh dhe ndaj njerëzve të  
tjerë, por shumica e tyre nuk ia dinë  
vlerën”.*

Këtu Jusufi u ndal dhe i pyeti ata të dy.

“Ju thoni zoti i së mirës, zoti i detit, zoti  
i furnizimit dhe zoti i shiut”.

E ne themi "All-llahu është Zot i botëve".

*“A është më mirë të adhburohen zota të  
ndryshëm ose All-llahu, i vetmi ngadhënjim-  
tar”?*

Ku janë zoti i së mirës, zoti i detit, zoti i  
furnizimit dhe zoti i shiut?

*“Më mundësoni të shoh se ç'krijuan ata në*

*tokë; a mos kanë pjesë ata në qiej”?*

Shikoni në tokë dhe drejt qiellit dhe shikoni në njeriun.

*“Kjo është vepër e krijimit të All-llahut, e më tregoni pra mua se ç’krijuan ata të tjerët pos Tij”?*

E si janë zoti i së mirës, zoti i detit, zoti i furnizimit dhe zoti i shiut?

*“Emra me të cilët i pagëzuar ju dhe prindërit tuaj”.*

Vendimi i takon All-llahut, sundimi i takon All-llahut, toka është e All-llahut, urdhri i takon All-llahut.

*“Mos adhuroni askë tjetër pos Atij”.*

*“Kjo është feja e drejtë”.*

*“Por shumica e njerëzve nuk e dinë”.*

## 12 KOMENTIMI I ËNDRRAVE

Kur Jusufi e mbaroi këshillën e tij, ua tregoi dy të burgosurve kuptimin e ëndrrave të tyre.

Ai tha: *“Njëri nga ju do t’i japë të pijë verë zotëriut të vet”*.

E tjetri do të varet, kurse shpezët do të hanë nga koka e tij”.

Të parit i tha: *“Më përkujto mua te zotëriut yt”*.

Këta dy të burgosur dolën nga burgu. I pari ishte ai që i jepte të pijë sundimtarit të tij, ndërsa i dyti u var.

Pijedhënësi harroi ta përmendë Jusufin te sunduesi, kështu që Jusufi qëndroi në burg vite të tëra.

## 13 ËNDRRA E SUNDIMTARIT

Sundimtari i Egjiptit pa një ëndërr të çuditshme.

Pa në ëndërr shtatë lopë të majme, të cilat hanin shtatë lopë të dobëta.

Gjithashtu sundimtari pa shtatë kallinj të gjelbër (që kishin lidhur frytin) e shtatë të tjerë të tharë.

Sundimtari u habit nga kjo ëndërr e

çuditshme dhe i pyeti këshilltarët e tij për komentimin e kësaj ëndrre.

Ata i thanë: "Kjo nuk është asgjë, meqë njeriu në gjumë sheh shumë gjëra që nuk do të thotë se ka të vërteta në to".

Mirëpo pijedhënësi tha: "Jo, unë do t'ju informoj për komentimin e kësaj ëndrre".

Kështu, pijedhënësi shkoi në burg dhe e pyeti Jusufin për komentimin e ëndrrës së sundimtarit.

Jusufi ishte shumë bujar, fisnik dhe i mëshirshëm ndaj krijesave të All-llahut, prandaj edhe pranoi ta komentojë ëndrrën e sundimtarit.

Jusufi ishte shumë bujar e fisnik dhe nuk dinte fare për koprracinë.

Jusufi e tregoi kuptimin dhe e udhëzoi për planifikim.

Ai i tha pijedhënësit: "Mbillni shtatë vjet vazhdimisht, e çka keni korrur lënie në kallinj, përveç një pakice nga e cila do të hani".

Pas kësaj do të ketë thatësi të përgjithshme dhe ju do të hani ngapak

nga ajo që e keni tubuar.

Kjo thatësi do të zgjasë shtatë vjet.

Pas kalimit të këtyre shtatë vjetëve të vështira do të vijë ndihma që do t'i qetësojë njerëzit.

Pas këtyre fjalëve pijedhënësi shkoi dhe e informoi sundimtarin për kuptimin e ëndrrës së tij.

## 14 SUNDUESI E THËRRET JUSUFIN NËPËRMJET SHËRBËTORIT TË TIJ

Kur sunduesi e dëgjoi këtë interpretim dhe këshillë u gëzua fort dhe tha: "Kush është ai që e bëri këtë interpretim?"

Gjithashtu sunduesi tha: "Kush është ky njeri fisnik i cili na këshilloi dhe priu në planifikim?"

Pijedhënësi tha: "Ky është Jusufi i drejtë, e gjithashtu ai më tregoi se unë do të jem pijedhënës për zotëriun tim sundimtarin".

Sundimtari shprehu dëshirë ta takojë Jusufin, dhe e dërgoi dikë te ai dhe tha: *“Ma sillni atë (njeri), thjesht ta veçoj për vetveten!”*.

## 15 JUSUFI E KËRKON PËRGJEGJËSIN E BURGUT

Kur i dërguari erdhi te Jusufi dhe atij i tha se sunduesi e thërret, ai nuk u pajtua të dalë nga burgu në këtë mënyrë.

E njerëzit të thonë se ky është Jusufi? Ky deri dje ishte në burg, ai e tradhtoi Azizin.

Vërtet Jusufi ishte shpirtmadh, i ndershëm, i zgjuar dhe mendjemprehtë.

Po të ishte dikush tjetër në vend të Jusufit në burg dhe t'i vinte atij i dërguari i sunduesit, dhe t'i thoshte se sunduesi të thërret, me siguri do të vraponte drejt portës së burgut që të dalë sa më shpejt.

Mirëpo Jusufi nuk shpejtoi.

Mirëpo Jusufi nuk nxitoi.

Por të dërguarit të sundimtarit i tha:  
"Unë dëshiroj të bëhen hulumtime për  
çështjen time"

Sundimtari pyeti për Jusufin, kështu që  
kupto i edhe ai edhe populli se Jusufi  
është i pastër dhe i pafajshëm.

Kështu Jusufi doli i pastër nga burgu,  
ndërsa sunduesi e nderoi.

## **K**PËRGJEGJËS I DEPOVE TË VENDIT

Jusufi e dinte se shumë pak besnikëri ka  
te njerëzit.

Jusufi e dinte se shumë tradhti ka tek  
njerëzit.

Jusufi e shihte se njerëzit bëjnë tradhti  
ndaj pasurisë së All-llahut.

E shihte se në vend ka shumë depo, por  
të rrënuara dhe tërësisht të shkatërruara.

Ato janë të shkatërruara sepse mbretërit<sup>1</sup>  
nuk i frikohen All-llahut.

<sup>1</sup>Udhëheqësit dhe përgjegjësit

Pasurinë e hanë qentë e tyre, ndërkaq njerëzit nuk kanë çfarë të hanë.

I stolisin shtëpitë e tyre, ndërkaq njerëzit nuk kanë çfarë të veshin.

Nuk mund ta kënaqë popullin me depot e vendit vetëm ai i cili është besnik dhe i dijshtëm.

Kush është besnik e nuk është i dijshtëm, ai nuk din për depot e vendit dhe nuk di si t'i shfrytëzojë ato.

Kush është i ditur, e nuk është besnik, i shfrytëzon ato por tradhton.

Mirëpo Jusufi ishte besnik dhe i dijshtëm. Jusufi ishte ai i cili nuk dëshiroi t'i lejojë mbretërit që të shfrytëzojnë pasurinë e popullit.

Jusufi ishte i tillë dhe nuk mund t'i shikonte njerëzit se si vdesin nga uria.

Jusufi ishte njeri që nuk turpërohej nga e vërteta.

Prandaj edhe i tha mbretit:

*“Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, meqë unë jam besnik dhe i dijshtëm”.*

Vërtet Jusufi ishte besnik për depot e Egjiptit.

Kështu u qetësua populli dhe e falënderonte All-llahun.

## 17 ARDHJA E VËLLEZËRVE TË JUSUFIT

Siç kishte lajmëruar Jusufi, në Egjipt dhe në Sham u paraqit uria. Kishin dëgjuar banorët e Shamit, e edhe Jakubi se në Egjipt gjendet një njeri i mëshirshëm. Se në Egjipt është një njeri bujarë fisnik, i cili është edhe përgjegjës i depove të vendit.

Kështu njerëzit shkonin tek ai dhe merrnin ushqim<sup>2</sup>. Edhe Jakubi i dërgoi djemtë e tij në Egjipt për mall që të kthehen me ushqim.

Ndërkaq, Bunjamini mbeti te babai i tij, sepse Jakubi e donte shumë dhe assesi nuk dëshironte që të largohet prej tij, meqë frikohej për të sikur që frikohej për Jusufin.

<sup>2</sup>Drithëra - grurë

Kështu, vëllezërit e Jusufit u drejtuan për te Jusufi duke mos e ditur se ai është vëllau i tyre, Jusufi.

Gjithashtu ata nuk e dinin se ai është Jusufi, të cilin e kishin hedhur në pus.

E ata mendonin se ai tanimë kishte vdekur.

E si të mos vdiste kur ishte i hedhur në pus.

Ishte në pus e pusi ishte i thellë.

Pusi gjendej në mal, e mali ishte i shkretë.

Kjo kishte ndodhur gjatë natës, e nata ishte e errët.

*“Pas një kobe erdhën vëllezërit e Jusufit dhe bënë tek ai. Jusufi i njobu menjëherë, por ata nuk e njihnin”.*

Ishin refuzues të Jusufit, nuk e njihnin, mirëpo Jusufi nuk i refuzoi, por përkundrazi, i njofti.

Jusufi e dinte se këta e hudhën në pus, dhe se janë ata të cilët dëshironin mbytjen e tij, mirëpo All-llahu e mori në mbrojtje atë.

Megjithatë Jusufi nuk u tha asgjë atyre dhe nuk ua zbuloi identitetin e tij.

# 18

## DIALOGU NDËRMJET JUSUFIT DHE VËLLEZËRVE TË TIJ

Jusufi iu drejtua atyre dhe u tha:

"Prej nga jeni ju?"

Ata thanë: "Nga Ken'ani!"

Ai i pyeti: "Kush është babai juaj?"

Ata thanë: "Jakubi, biri i Is'hakut, e Is'haku biri i Ibrahimit (paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ta)".

Ai tha: "A keni ju ndonjë vëlla tjetër?"

Ata thanë: "Po, e kemi një, i cili quhet Bunjamin!"

Ai sërish pyeti: "Përse nuk ka ardhur me ju?"

Ata thanë: "Për arsye se prindi ynë nuk e lëshon atë dhe nuk dëshiron të largohet nga ai".

Ai tha: "Për çfarë shkakut nuk e lëshon atë, a është ai fëmijë shumë i vogël?"

Ata thanë: "Jo, por ai kishte një vëlla i cili quhej Jusuf. Njëherë erdhi me ne, e ne shkuam të bëjmë gara, ndërsa Jusufin

e lamë te teshat tona dhe atë e kishte ngrënë ujku".

E Jusufi qeshi në vete, por nuk tha asgjë. Megjithatë, ai u përmallua tepër për vëllain e tij Bunjaminin.

Ndërkaq, All-llahu dëshiroi që ta sprovojë Jakubin për herë të dytë.

Kështu Jusufi i urdhëroi ata për ushqim, dhe u tha: *"Ma sillni një vëlla tuajin që e keni nga baba, sepse nuk mund të merrni ushqim po që se nuk vini me të"*.

Jusufi dha urdhër për rikthimin e të hollave të tyre dhe ato u vënë në plaçkat e tyre.

## 19 BISEDA NDËRMJET JAKUBIT DHE BIJVE TË TIJ

Vëllezërit e Jusufit u kthyen te babai i tyre, e informuan atë për të gjitha duke i thënë: "Lëshoje me ne vëllaun tonë, përndryshe nuk do të kemi dobi te Azizi".

E kërkuan prej Jakubit Bunjaminin duke i thënë: *“Me siguri do ta ruajmë atë (nga çdo e keqe)”*.

Jakubi tha: *“A t’ju besoj për këtë, ashtu sikur që ju besova më parë për vëllaun e tij (Jusufin)”?*

A e harruat ngjarjen e Jusufit?! A do ta ruani Bunjaminin siç e ruajtët Jusufin?

*“All-llahu është mbrojtësi më i mirë dhe Ai është mëshirues i mëshiruesve”*.

Kështu ata i gjetën paratë e tyre në plaçkat e tyre dhe babait të tyre i thanë: "Vërtet, i nderuari Azizi është burrë fisnik, na e ktheu pasurinë dhe nuk mori prej nesh kundërvlerë".

Lëshoje me ne Bunjaminin që ta marrim edhe pjesën që i takon atij".

Jakubi u tha atyre: "Nuk e lëshoj me ju derisa t'ia jepni besën All-llahut se ju do të ktheheni me të, përpos nëse nuk keni mundësi".

Ata iu betuan All-llahut, ndërkaq Jakubi tha: *“All-llahu është garantues për këtë që e thamë”*.

Gjithashtu Jakubi bijve të vet u tha:  
*“O bijtë e mi, mos hyni (në Egjipt) të gjithë  
nëpër një derë, po hyni nëpër dyer të  
ndryshme”.*

## 20 BUNJAMINI TE JUSUFI

Vëllezërit hynë nëpër dyer të ndryshme, siç  
i urdhëroi babai i tyre dhe arritën te Jusufi.

Kur Jusufi e pa Bunjaminin u gëzua  
fort dhe e vendosi atë në shtëpinë e tij.

Jusufi i tha Bunjaminit: *“Unë jam vëllai  
yt”* dhe Bunjamini u qetësua. Pas një  
kohe të gjatë Jusufi e takoi Bunjaminin  
dhe i përkujtoi prindërit e tij, shtëpinë  
dhe fëmijërinë e tij.

Jusufi shprehu dëshirë që Bunjamini të  
mbetet tek ai që ta shohë atë për çdo  
ditë, që të bisedojë me të dhe ta pyesë  
për shtëpinë e tij.

Mirëpo si të arrihet deri te kjo, meqë  
Bunjamini nesër duhet të kthehet në  
Ken'an?

Si të arrihet deri te kjo meqë vëllezërit  
iu betuan All-llahut se do të kthehen së  
bashku me të?

Si është e mundur që Jusufi ta burgosë  
Bunjaminin tek ai pa kurrfarë shkasi?

E njerëzit të thonë: "E burgosi zotëriu  
ken'anasin pa kurrfarë shkasi, vërtet kjo  
është një mizori e madhe".

Mirëpo Jusufi ishte mendjemprehtë dhe  
i mençur.

Ai kishte një enë të çmueshme në të  
cilën pinte.

Këtë enë e futi në plaçkat e Bunjaminin e  
pastaj një thirrës bërtiti: "Ju jeni vjedhës".

Vëllezërit u kthyen dhe pyetën: "Çka  
keni humbur?"

Shërbëtorët e sundimtarit thanë: Kemi  
humbur enën e sunduesit, e kush e sjell  
atë enë do të shpërblehet me një barrë  
deveje.

*"Ata vëllezërit e Jusufit thanë: Pasha  
All-llahun, ju e dini se ne nuk kemi ardhur  
për të bërë shkatërrime në tokë dhe nuk jemi  
vjedhës!"*

*“(shërbëtorët) Thanë: “Nëse jeni gënjeshtarë, çfarë duhet të jetë ndëshkimi i atij që ka vjedhur?”*

*“(vëllezërit) Thanë: Dënimi i tij është që vetë ai të robërohet në barrën e të cilit gjen-det. Kështu ne i dënojmë të padrejtit!”*. Ena doli nga trasta e Bunjaminut e vëllezërit u turpëruan, mirëpo ata pa kurrfarë turpi thanë: "Në pastë vjedhur ky (Bunjamini), ka pas vjedhur më parë edhe një vëlla i tij (Jusufi)". Jusufi e dëgjoi këtë shpifje por ai heshti dhe nuk u hidhërua, meqë ishte fisnik dhe i urtë.

*“Ata thanë: O zotëri, ai ka një baba shumë plak, pra, në vend të tij merre ndonjërin prej nesh. Bëre këtë të mirë se ti je prej atyre që bëjnë mirë!”*

*“Ai (Jusufi) tha: All-llahu na ruajtë, të marrim një tjetër në vend të atij te i cili e kemi gjetur gjësendin tonë?! Ne atëherë do të jemi të padrejtë!”*

Dhe kështu Bunjamini mbeti te Jusufi, ndërkaq dy vëllezërit u gëzuan.

*bb*

Vërtet Jusufi ndjehej tejet i vetmuar, meqë një kohë të gjatë nuk e kishte parë asnjë anëtar të familjes së tij.

E All-llahu e solli Bunjaminin te ai, e a mos ta ndalë atë që ta shohë dhe të bisedojë me të. A i takon mizorisë të qëndrojë vëllai pranë vëllait. Kurrsesi!

## 21 TE JAKUBI

Vëllezërit ishin të brengosur se si të kthehen te babai i tyre?

Ata mendonin se çfarë t'i thonë babait të tyre.

Ata para shumë vjetësh e pikëlluan me Jusufin, a ta pikëllojnë edhe sot me Bunjaminin?

Sa i përket vëllait të madh të tyre, ai refuzoi të kthehet te Jakubi dhe vëllezërve të tij u tha:

"Ju kthehuni te babai juaj dhe thuani: O Babai ynë, djali yt vodhi e ne dëshmojmë vetëm për atë që e dimë, e për të fshehtën ne nuk ishim rojë!"

Kur Jakubi e dëgjoji ngjarjen, e diti se All-llahu ka dorë në këtë, dhe se All-llahu e sprovon me këtë.

Para shumë vjetësh u pikëllua për Jusufin, e sot pikëllohet për Bunjaminin, vërtet All-llahu nuk i lëshon mbi të dy fatkeqësi, All-llahu nuk e pikëllon atë me të dy djemtë.

All-llahu nuk e pikëllon atë me të dy djemtë siç ishin Jusufi dhe Bunjamini.

Në këtë All-llahu ka dorë të fshehtë.

Në këtë All-llahu ka urtësi të fshehtë.

Vërtet All-llahu çdoherë i sprovon robërit e vet e pastaj i gëzon dhe begaton.

Edhe djali i madh mbeti në Egjipt, meqë refuzonte që të kthehet në Ken'an.

Kështu, Jakubi edhe për herë të tretë do të pikëllohet ashtu siç u pikëllua në dy rastet e para.

Vërtet, kjo nuk bëhet.

Por këtu u qetësua Jakubi dhe tha: "...shpresoj që All-llahu do të m'i sjellë të gjithë. Ai është më i dituri, më i urti!".

## 22 ZBULIMI I FSHEHTËSISË

Mirëpo Jakubi ishte njeri i cili në gjoksin e tij kishte zemër njeriu, e jo copë guri.

E përkujtoi Jusufin, e përsëriti dëshpërimin e tij dhe tha: *“O dëshpërim i im për Jusufin..!”*

E qortuan bijtë e tij Jakubin dhe ia tërhoqën vërejtjen se ai vazhdimisht e përkujton Jusufin derisa një ditë do të shkatërrohet.

Jakubi tha: *“Unë hidhërimin dhe pikëllimin tim ia parashtroj All-llahut, e unë di për All-llahun atë që ju nuk e dini”.*

Jakubi e dinte se humbja e shpresës është kufër (mosbesim), prandaj kishte shpresë të madhe te All-llahu.

Jakubi i dërgoi bijtë e tij në Egjipt që të bëjnë përpjekje për t'i gjetur Jusufin dhe Bunjaminin.

Jakubi i këshilloi ata që mos të humbin shpresat nga mëshira e All-llahut, kështu që vëllezërit shkuan në Egjipt për herë të tretë.

Hynë te Jusufi, iu ankuan atij për varfërinë dhe fatkeqësinë e tyre dhe i kërkuan ndihmë.

Këtu Jusufin e shqetësuan dëshpërimi dhe dashuria dhe nuk mundi ta mbizotroi veten.

Bijtë e babait tim dhe bijtë e pejgamberëve ankohen për varfërinë dhe fatkeqësinë e tyre te një mbret prej mbretërve.

Deri kur do ta fshehë çështjen prej tyre, deri kur do ta shikoj gjendjen e tyre dhe deri kur nuk do ta shoh babain tim.

Jusufi nuk mundi ta përmbajë veten dhe atyre u tha:

*“A e dini se çka keni bërë me Jusufin dhe vël-  
lain e tij kur ishit injorantë?”*

E vëllezërit e dinin se këtë fshehtësi nuk e dinte askush përpos Jusufit dhe atyre.

Kështu ata e kuptuan se ai është vetë Jusufi. Subhanallah (lavdi i qoftë Zotit)! A është Jusufi gjallë, a nuk ka vdekur në pus.

Çudi! Domethënë Jusufi është zotëruesi i Egjiptit!

A ai është përgjegjës për depot e vendit?  
A ai që urdhëronte për ushqimin tonë?  
Dhe nuk mbeti te ata kurrfarë dyshim  
se ai që u fliste atyre ishte Jusufi, i biri i  
Jakubit!

*“Ata i thanë: A ti je vetë Jusufi...?!”*

Ai tha: *“Unë jam Jusufi, e ky është  
vëllai im, All-llahu na dhuroi shpëtimin, sepse  
ai që ruhet dhe bën durim, s'ka dyshim se  
All-llahu nuk e humb shpërblimin e  
punëmirëve”.*

Ata thanë: *“Pasha All-llahun, është e vërtetë  
se All-llahu të ka lartësuar mbi ne, kurse ne  
vërtetë ishim fajtorë!”*

Jusufi nuk i qortoi për veprimin e tyre,  
por u tha:

*“... All-llahu ju faltë juve; Ai është më  
mëshirues i mëshiruesve!”*

## 23 JUSUFI IA DËRGON KËMISHËN JAKUBIT

Jusufi ishte mallëngjyer tepër për ta  
takuar Jakubin, e si të mos mallëngjehej

për të, meqë ndarja zgjati tepër shumë.

E përse të ketë durim tani meqë u zbulua fshehtësia.

E si t'i vijnë të shijshme atij haja dhe pija kur babait të tij nuk i vijnë të shijshme as haja e pija e as gjumi.

Tanimë u zbulua fshehtësia, doli në dritë, e All-llahu dëshiroi ta gëzojë Jakubin.

E Jakubi ishte verbuar nga të qarët e shumtë dhe dëshpërimi i thellë.

Jusufi u tha vëllezërve të vet:

"Ju shkoni me këtë këmishën time dhe hidhjani atë babait tim në fytyrë, e atij do t'i kthehet të pamurit, e pastaj ejani tek unë me tërë familjen time".

## 24 JAKUBI TE JUSUFI

E kur djemtë shkuan në Ken'an me këmishën e Jusufit në dorë, Jakubi e ndjeu erën e Jusufit dhe tha: "Unë po e ndjejë erën e Jusufit..!"

*“Ata (që ishin të pranishëm) thanë: Për All-llahun, ti vërtet qëmoti je në humbje”.*

Mirëpo, Jakubi ishte i drejtë. *“Kur erdhi myzhdexhin, ia vuri atë (këmishën) mbi fytyrën e tij, ashtu që atij iu kthye të pamurit dhe tha: A nuk ju thashë se unë di nga All-llahu çka ju nuk dini?”*

*“Ata thanë: O babai ynë, lutu për ne të na falen mëkatet tona, se me të vërtetë ne kemi qenë fajtorë!”*

*“Më vonë do t'ia kërkoj Zotit tim faljen tuaj, - tha Jakubi, - se vërtet Ai është që falë, është mëshirues”.*

E kur Jakubi arriti në Egjipt atë e priti Jusufi, e mos pyet për gëzimin dhe disponimin e tyre!

Në Egjipt kjo ishte një ditë e rëndësishme dhe e bekuar.

Dhe Jusufi prindërit e vet i vendosi në fron të pallatit, e ata të gjithë e rrespektuan Jusufin.

E Jusufi tha: *“... kjo është domethënia e ëndrrës sime të mëparshme, Zoti im këtë tani e bëri realitet,..!”*

*“... unë pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin e hënën, i pashë duke më bërë mua sexhde!”*

Kështu Jusufi i bëri All-llahut falënderim shumë të shkëlqyeshëm. Gjithashtu për këtë shprehu edhe mirënjohje të madhe. Jakubi dhe familja e tij mbetën në Egjipt një kohë të gjatë derisa Jakubi dhe bashkëshortja e tij ndërruan jetë.

## 25 PËRFUNDIMI I MIRË

Jusufin kjo pronë e madhe nuk e preokuponte dhe nuk e largonte nga All-llahu xh.sh.

Jusufi çdoherë e përkujtonte All-llahun, e adhuronte Atë dhe i frikohej Atij.

Ai gjykonte sipas dispozitave të All-llahut dhe i zbatonte urdhrat e Tij.

Jusufi nuk brengosej shumë për pronën e vet dhe nuk e konsideronte atë si çështje madhore.

Ai ishte i tillë që nuk dëshironte të vdesë si mbret dhe të hyjë në radhën e mbretërve, por dëshironte të ketë një vdekje të robit të zakonshëm dhe të tubohet në një vend me të mirët.

Lutja e Jusufit ishte:

*“Zoti im, Ti më ke dhënë mua pushtet, ma mësove komentimin e ëndrrave; o Krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestar imi në dynja e në Abiret, më bën të vdes si musliman dhe më bashko me të mirët!”*

E All-llahu Jusufin e mori si musliman dhe e bashkoi me stërgjyshërit e tij Ibrahimin, Is'hakun dhe Jakubin, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi ta dhe mbi Pejgamberin tonë.



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Anija e  
Nuhit  
a.s.

3



## PAS ADEMIT A.S.

All-llahu i bekoi pasardhësit e Ademit e në mesin e tyre pati shumë burra dhe gra. Pasardhësit e Ademit u shpërndanë dhe u shtuan në mbarë dheun.

Po të kthehej Ademi e t'i shihte bijtë e tij, nuk do t'i njihnte.

Po t'i thuhej atij: “O Adem, këta janë pasardhësit e tu” do të habitej pa masë.

E do të thoshte: “All-llahu është pa të meta!” Të gjithë këta janë fëmijët e mi? “Të gjithë këta janë pasardhësit e mi!”

Pasardhësit e Ademit kanë shumë vendbanime, dhe kanë ndërtuar shumë shtëpi. Ata kanë lëvruar tokën, e kanë mbjellë, kanë marrë prodhimet dhe ashtu kanë jetuar. Njerëzit e pasuan Fenë e babait të tyre Ademit, adhurojnë All-llahun dhe nuk i bëjnë kurrfarë idhujtarie Atij!

Njerëzit janë një popull, babai i tyre është Ademi dhe Zot i tyre All-llahu xh.sh.

## 2 ZILIA E SHEJTANIT (SATANIT)

Mirëpo si të kënaqet shejtani, ndërsa pasardhësit e Ademit edhe më tutje merren me këtë punë?

A edhe më njerëzit nuk pushojnë duke e adhuruar All-llahun?

Edhe më njerëzit nuk pushojnë së qeni një ummet (popull) që nuk e kundërsh-tojnë njëri-tjetrin. Vërtet nuk bën kështu! Kurrsesi nuk bën kështu!

A të hyjë pasardhësi i Ademit në xhennet, e pasuesi i shejtanit të hyjë në xhehennem?

Vërtet kjo nuk bën, kurrsesi nuk bën!

Ai (shejtani) nuk iu përkul Ademit e All-llahu e përzuri dhe e mallkoi.

A mos të hakmerret ndaj bijve të Ademit dhe të hyjnë në xhehennem me të (ferr)?

Patjetër të bëhet kjo! Patjetër të ndodhë kjo.

## 3 IDEJA E SHEJTANIT (DREQIT)

Ideja e shejtanit është që t'i thërrasë njerëzit për t'i adhuruar statujat e të hyjnë në zjarr dhe kurrë mos të hyjnë në xhennet (parajsë).

Shejtani e dinte se All-llahu nuk e fal politeizmin (besimin në shumë zota), e fal çdo send tjetër po që se do.

E dëshira e shejtanit ishte që njerëzit t'i tërhiqte në politeizëm, e kurrën e kurrës mos të hynin në xhennet.

Mirëpo si ta gjente rrugën për ta arritur këtë qëllim, meqë njerëzit e adhuronin All-llahun?

Dihej se po të shkonte dhe t'u thoshte njerëzve: “Adhuroni idhujt e mos e adhuroni All-llahun, njerëzit do ta shanin dhe do ta rrihnin.

Ata do të thoshin: “All-llahu na ruajtë, a t'i bëjmë shok Zotit tanë? A t'i adhurojmë idhujt?”

Vërtet ti je shejtan i mallkuar! Me të vërtet ti je shejtan i pistë!

## 4 DREDHIA E SHEJTANIT

Atëherë shejtani gjeti derën përmes së cilës do të hynte në kokat e njerëzve.

Njerëzit i frigoheshin All-llahut, e adhuronin Atë natë e ditë dhe e përkujtonin vazhdimisht.

Ata e donin All-llahun, por edhe All-llahu i donte ata dhe u pranonte lutjet atyre, poashtu ata e donin dhe e madhështonin Atë, e shejtani këtë e dinte shumë mirë.

E këta njerëz vdiqën dhe kaluan në mëshirën e All-llahut!

Shejtani shkoi tek njerëzit dhe ua përkujtoi këta njerëz. Ai tha: “Si i njihni ju filanin dhe filanin?”

Njerëzit thanë: “Subhanell-llah (All-llahu është pa të meta)! Burra që i ka dashtë All-llahu! Ata po qe se iu janë lutur, Ai u është përgjigjur, e po që se i kanë kërkuar diç, Ai ua ka dhënë.”

## 5 FOTOGRAFITË E TË MIRËVE

Shejtani u tha (njerëzve): “A jeni të pikëlluar për ata (njerëzit e mirë)?”

Ata thanë: “Shumë”.

Shejtani tha: “Si e keni mallin për ta?”

Ata thanë: “Të madh!”

Shejtani tha: “E pse mos t’i shihni ata për çdo ditë?”

Ata thanë: “Cila është rruga deri atje, meqë ata kanë vdekur?”

Shejtani tha: “Bëni fotografitë e tyre dhe t’i shihni për çdo mëngjes”.

Njerëzve u pëlqeu ideja e shejtanit, i bënë fotografitë e njerëzve të mirë e pastaj i shihnin fotografitë për çdo ditë, e kur i shikonin, i përkujtonin ata njerëzit e mirë.

## PREJ FOTOGRAFIVE DERI TE STATUJAT

Dhe kështu kaluan prej fotografive në statuja.

U bënë njerëzve të mirë statuja të shumta, i vunë ato nëpër shtëpitë dhe xhamitë e tyre.

E ata ishin të atillë, që e adhuronin All-llahun dhe nuk i bënë shok Atij.

E ata e dinin se këto janë statuja të njerëzve të mirë.

Ndonëse ishin gurë që nuk u bënë dobi, që nuk i dëmtonin e as u jepnin gjë, ata kërkonin bekimin me ta dhe i madhështonin sepse ata ishin statuja të të mirëve.

Dhe kështu u shumuan idhujt në mesin e tyre, dhe u shtua respekti ndaj tyre.

E kur vdiste ndër ta ndonjë njeri i mirë, ia bënë statujën dhe e emërtonin me emrin e tij.

## 7 PREJ STATUJAVE E DERI TE IDHUJT

Kjo brezni kaloi, mirëpo bijtë e tyre i patën parë se si ata kërkonin të mira nga statujat dhe si i madhështonin pa masë.

Gjithashtu patën parë ata se si i puthnin, i lëmonin dhe luteshin pranë tyre.

Poashtu i patën parë duke i ulur kokat dhe duke u përkulur para tyre, e të bijtë e tyre bënë edhe më tepër se baballarët e tyre dhe për hir të statujave e vinin kokën në tokë pranë tyre, kërkonin ndihmë nga ato dhe prisnin kurban për to.

Kështu që këta idhuj u shndërruan në zota dhe njerëzit i adhuronin sikur adhuronin All-llahun më parë.

Këta zota u shumuan ndër ta, e mes tyre ishin: Vudd-i, Suva-i, Jeguth-i, Juk-i dhe Nesr-i.

## 8 HIDHËRIMI I ALL-LLAHUT X.H.S.H.

Dhe kështu All-llahu u hidhërua shumë ndaj njerëzve dhe i mallkoi ata. E si mos të hidhërohet All-llahu ndaj njerëzve e mos t'i mallkojë?

A për këtë i krijoi ata, a për këtë u jepte të mirat?

Ecim mbi tokën e All-llahut e nuk e besojnë All-llahun!

Ngrënin furnizimin e All-llahut, mirëpo i bëjnë shok All-llahut?

E kjo është mizori e madhe! Vërtet ky është zullum i madh!

All-llahu u hidhërua ndaj tyre, ua ndali shiun dhe ju vështirësua jeta atyre. Ua pakësoi furnizimin dhe pasardhësit. Megjithatë njerëzit nuk kuptuan dhe nuk u penduan.

## 9 I DËR GUARI

Dëshira e All-llahut ishte që t'u dërgonte një njeri nga mesi i tyre që t'u fliste dhe t'i këshillonte.

All-llahu nuk i flet çdonjërit personalisht, All-llahu nuk i ligjëron secilit dhe nuk i thotë “vepro ashtu, vepro kështu”.

Në të vërtetë as mbretërit nuk i flasin secilit një nga një.

As mbretërit nuk shkojnë tek çdo njëri që t'i thonë “vepro ashtu, vepro kështu”.

Por edhe mbretërit janë njerëz si njerëzit e tjerë, çdokush mund t'i shohë dhe të dëgjoj fjalën e tyre, por nuk mundet dikush ta shohë All-llahun, ta dëgjojë fjalën e Tij dhe të flasë me Të, e këtë nuk mund ta bëjë askush, me përjashtim të atij për të cilin do All-llahu dhe nëse dëshiron All-llahu.

E All-llahu dashi që të dërgonte tek njerëzit Pejgamber që t'u fliste dhe t'i këshillonte.

# 10 NJERI APO ENGJËLL

All-llahu deshi që ky Pejgamber të ishte njeri, dhe të ishte një prej njerëzve, të cilin e njohin njerëzit dhe e kuptojnë fjalën e tij. Por nëse do të ishte Pejgamberi engjëll, njerëzit do të thoshin: “Çfarë lidhje kemi ne me të? Ai është engjëll e ne jemi njerëz!”

Ne hamë dhe pijmë, ne kemi familje dhe pasardhës e si ta adhurojmë All-llahun?

E po që se Pejgamberi është njeri, ai thotë: “Unë ha ushqim dhe pi, unë kam familje dhe pasardhës por unë e adhuroj All-llahun, e përse ju nuk e adhuroni All-llahun?”.

E po të ishte Pejgamberi engjëll, njerëzit do të thoshin: “Ty nuk të merr etja e as uria, ti nuk sëmuresh e as nuk vdes, prandaj e adhuron All-llahun dhe e përmend vazhdimisht!

E ne jemi njerëz, na merr etja dhe uria, sëmurimi dhe vdesim, e si ta adhurojmë

All-llahun dhe ta përmendim  
vazhdimisht?

E po që se Pejgamberi është njeri, ai thotë: “Unë jam si ju, kam etje e uri, sëmurem dhe vdes, e adhuroj All-llahun dhe e përmend, e përse ju nuk e adhuroni All-llahun dhe nuk e përmendni?”

Kështu ndalen fjalët e njerëzve dhe nuk mund të gjejnë arsye.

## NUHU PEJGAMBER

Dëshira e All-llahut ishte që ta dërgonte Nuhun tek populli i tij.

Në mesin e popullit kishte të pasur dhe prijës, por All-llahu e zgjodhi Nuhun për dërgatën e Tij. E nuk zgjodhi ndonjë prej tyre.

All-llahu e di kujt ia ngarkon dërgatën e Tij, All-llahu e di kujt ia ngarkon emanetin e Tij.

Nuhu ishte burrë i mirë dhe fisnik,  
Nuhu ishte i mençur dhe i butë.

Nuhu ishte këshillues dhe i dhembshëm, i drejtë dhe besnik, andaj All-llahu e zgjodhi Nuhun për dërgatën e Tij dhe ia shpalli: “... (dhe i thamë) *Tërbiqja vërejtjen popullit tënd para se ata t'i godasë dënimi i rëndë!*”

Andaj Nuhu u ngrit në mesin e popullit të vet duke u thënë: “*Unë jam për ju Pejgamber besnik*”.

## 12 SI IU PËRGJIGJ ATIJ POPULLI

E kur Nuhu u ngrit në mesin e popullit të tij dhe u tha: “*Unë jam për ju Pejgamber besnik*”, disa njerëz u ngritën dhe i thanë: “Kur u bë ky Pejgamber?”

Dje ishte një njeri nga mesi ynë, ndërsa sot thotë: “Unë jam i Dërguar i All-llahut tek ju!”

E shokët e Nuhut thanë: “Ky ishte ai i cili në vegjëli lozte dhe rrinte me ne për çdo ditë, e kur na i paska ardhur pejgamberlluku? Natën apo ditën!...”

E të pasurit dhe kryelartët thanë:  
“A nuk gjeti All-llahu tjetër përpos tij?”  
A të gjithë njerëzit vdiqën? A nuk gjeti  
në mesin e popullit tjetër përpos një të  
varfëri?

E të paditurit thanë: “...*Ky nuk është tjetër  
pos njeri sikurse edhe ju...*” Gjithashtu  
thanë: “*Po të dëshironte All-llahu do të dër-  
gonte engjëj; një gjë të tillë nuk e kemi dëgjuar  
as nga të parët tanë!*”.

E disa njerëz thanë “Vërtet Nuhu  
përmes kësaj rruge dëshiron të arrijë  
autoritet dhe të bëhet udhëheqës”.

## 13 MES NUHUT DHE POPULLIT TË TIJ

Njerëzit mendonin se adhurimi i  
idhujve është i drejtë dhe se adhurimi i  
idhujve është i arsyeshëm.

Poashtu mendonin se ai, i cili nuk i  
adhuron idhujt, është në humbje dhe  
kokëtrashë.

Andaj thoshin: “Baballarët tanë i adhuronin idhujt, përse Nuhu mos t’i adhuroj këta?”

E Nuhu mendonte se adhurimi i idhujve është humbje, dhe se adhurimi i idhujve është marri.

Poashtu Nuhu mendonte se baballarët kanë qenë në humbje dhe të marrë dhe se Ademi është babai i të gjithë etërve, mirëpo nuk i adhuronte idhujt, por e adhuronte All-llahun.

E s’ka dyshim se populli është në humbje dhe se është i marrë meqë i adhuron gurëzit e nuk e adhuron All-llahun i Cili e krijoi.

Nuhu u ngrit në mesin e popullit të tij, e ngriti zërin dhe u tha: “... *O populli im, adhuronie All-llahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe!*”.

“*Paria nga populli i tij tha: Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur!*”.

“(Nuhu) *tha: O populli im, unë nuk kam*

*kurrfarë humbje, por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve!” “Unë ju kumtoj shpalljen e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë di nga Zoti im çka ju nuk dini!”.*

## 14 TY TË BESOJNË MË TË ULËTIT

Nuhu bëri përpjekje të mëdha që t'i besonte populli i tij, ta adhuronte All-llahun dhe t'i braktisë idhujt.

Mirëpo Nuhut nuk i besuan, përpos disa individëve nga populli i tij.

Nuk i besuan, përpos disa personave të cilët punonin me duart e tyre dhe që ngrënin të lejuarën (hallall).

E sa u përket të pasurve nga populli i tij, ata i pengoi kryelartësia që ta respektojnë Nuhun.

Meqë ishin të zënë me pasurinë dhe fëmijët e tyre, nuk mendonin për botën tjetër (ahiret) dhe thoshin: “Ne jemi klasa e lartë e ata janë klasa e ulët”.

E kur Nuhu i thirri në rrugën e All-llahut, ata thanë:

*“... E si të besojmë ty, kur ty të besojnë më të ulët?”.*

Dhe kërkuan nga Nuhu që t'i përzinte të varfrit.

Mirëpo Nuhu kundërshtoi dhe tha:

*“... Unë nuk do ti përçë besimtarët.”*

Porta ime nuk është portë sundimtari.

*“Unë nuk jamë tjetër, por vetëm se t'u tërbeq vërejtjen haptas”.*

E Nuhu e dinte se ata të varfërit ishin besimtarë dhe të sinqertë.

E All-llahu hidhërohet po që se përzihen të varfërit, dhe nuk e ndihmon askënd.

Dhe Nuhu tha: *“... O populli im, nëse unë i përçë ata, kush do të më mbrojë mua nga All-llahu (dënimi i Tij)?”.*

## 15 ARGUMENTI I TË PASURVE

Pasanikët thanë: “Ajo që thërret Nuhu nuk është e vërtetë e as e mirë.”

Përse?

Meqë ne e kemi provuar se jemi të parët në çdo të mirë.

Ne i kemi të gjitha të mirat ushqimore dhe ato të veshmbathjes, e njerëzit na përcjellin në çdo send.

Ne e kemi parë se nuk gabojmë për të mirën dhe ska kush që na konkuron në vendin tonë.

Po të ishte e mirë kjo fe, ne do të afro-heshim para atyre të gjorëve. “*Sikur të ishte ai (Kur’ani – feja) ndonjë e mirë, ata nuk do ta përqaфонin para nesh!*”

## THIRJA E NUHUT

Nuhu e thirri popullin e tij dhe bëri përpjekje për t’i këshilluar.

“*Ai tha: O populli im, unë jam i dërguar te ju, jam i qartë. Adhuronie All-llahun, kini frikë prej Tij dhe mua më dëgjoni. Ai ju fal nga mëkatet tuaja dhe ju vazhdon jetën deri në një afat të caktuar (pa u dënuar), e kur të*

*vijë afati i caktuar prej All-llahut, ai nuk shtyhet për më vonë, nëse jeni që dini”.*

All-llahu ua kishte ndalur shiun, ishte hidhëruar me ta dhe ua pakësoi frytet dhe pasardhësit.

Nuhu u tha: “O populli im, nëse besoni All-llahu do të jetë i kënaqur prej jush dhe e largon këtë ndëshkim.”

U dërgon juve shi dhe ua bekon ushqimin dhe fëmijët tuaj.

Nuhu e thirri popullin e tij në rrugën e All-llahut dhe u tha: “A nuk e njihni All-llahun?”

Gjithçka që ju rrethon janë argumentet e All-llahut, a nuk shikoni në to? A nuk e shihni qiellin dhe tokën? A nuk i shihni diellin dhe hënën?

Kush i krijoi qiejtë? E bëri hënën të ndritshme e diellin të shkëlqyer?

E kush ju krijoi ju dhe kush jua bëri tokën të gjerë?

Megjithatë populli i Nuhut nuk kuptoi!  
Megjithatë populli i Nuhut nuk besoi!

Nuhu i thërriste në rrugë të All-llahut,

ata i vinin gishtrinjte në veshët e tyre.

E si do të kuptojë ai që nuk dëgjon?

E si do të dëgjojë ai që nuk dëshiron të dëgjojë?

## 17 LUTJA E NUHUT

Nuhu bëri shumë përpjekje dhe mbeti duke e thirrur popullin e tij një kohë të gjatë.

Nuhu nëntëqind e pesëdhjetë vjet mbeti duke e thirrur popullin e tij për ta besuar All-llahun.

Por populli i Nuhut nuk besoi.

Nuk e lanë adhurimin e idhujve dhe nuk iu kthyen All-llahut.

E derikur do të priste Nuhu? Deri kur do ta shihte të keqen në tokë?

Deri kur do të shikojë duke u adhuruar gurëzit?

Deri kur do t'i shikojë njerëzit duke e ngrënë furnizimin e All-llahut e pos Tij adhurojnë tjetërkënd?

Përse nuk hidhërohet Nuhu? Vërtet ai ka bërë një durim që askush nuk e ka bërë si ai!

Kalojnë një mijë vjet pa pesëdhjetë, All-llahu është më i madhi, All-llahu është më i madhi.

E All-llahu i shpalli Nuhut: “... *Nuk do të besojë më askush nga populli yt, përveç atyre që kanë besuar (deri më tash)...*”.

Kur njëherë i thirri, populli i tij tha: “... *O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, e nëse flet të vërtetën, sille pra, të na godasë ajo me çka na kërcënohesh!*”.

Nuhu u hidhërua për hir të All-llahut, e humbi shpresën prej tyre dhe tha: “O All-llahu im, mos e lërë mbi tokë asnjë prej pabesimtarëve”.

## 18 ANIJA

All-llahu e pranoi lutjen e Nuhut dhe deshi ta përmbyste popullin e tij.

Mirëpo All-llahu dëshironte që në një

mënyrë të shpëtonin Nuhu dhe besimtarët.

E urdhëroi Nuhun ta ndërtonte një anije të madhe.

Nuhu filloi ta ndërtonte anijen e madhe.

Populli i tij e panë në këtë punë dhe vazhdimisht e gjenin të zënë.

Dhe filluan të talleshin me të.

“Ç’është kjo o Nuh? Prej kur u bërë zdrukthtar?”

A nuk të patëm thënë mos rri me ata të mjerët?

Po ti nuk e dëgjove fjalën tonë, ndejte me zdrukthtarët dhe farkëtarët dhe u bërë zdrukthtar!

O Nuh, ku do të lundrojë kjo anije? Vërtet e tërë puna jote është e çuditshme.

A do të ecë ajo nëpër rërë apo do të ngjitet në kodër?

Prej këtu deti është shumë larg, a do ta bartin demonët (exhinet) apo do ta tërheqin qetë?”

Nuhu gjithë këto i dëgjonte dhe bënte

durim, e pati dëgjuar edhe më keq por pati duruar!

Por ndonjëherë u thoshte: “... Nëse talleni me ne, edhe ne do të tallemi me ju, ashtu siç po talleni ju!”.

## 19 TUFANI (PËRMBYTJA)

Erdhi koha e premtimit të All-llahut, e All-llahu i përmbahet premtimit.

Shiu binte nga qielli, binte, binte.

Mu ashtu si të ishte qielli përplot dhe nuk mund ta mbante ujin.

Uji nisi të buronte nga toka dhe të rridhte saqë i rrethoi njerëzit nga çdo anë.

E All-llahu i shpalli Nuhut: “Merr me vete kush të ka besuar nga populli yt dhe familja jote”.

All-llahu e porositi Nuhun që të merrte me vete prej secilës kafshë dhe shpezë çift, mashkull dhe femër.

Meqë përmbytja ishte e përgjithshme, nuk mund të shpëtonte prej tij as njeri e

as kafshë.

Ashtu edhe veproji Nuhu, e në anije me të erdhi ai i cili i kishte besuar nga populli i tij.

Po edhe prej kafshëve dhe shpezëve çift.

E anija lundronte me ta nëpër valët si kodrat.

Kështu sa vinte zmadhohej e zgjerohej uji, populli ngjitej në vendet më të larta për të ikur prej dënimit të All-llahut.

Mirëpo nuk mund t'i iket strehimit të All-llahut, veç tek Ai duhet strehuar.

## 20 | BIRI | NUHUT

Nuhu e kishte një djalë, i cili u ishte bashkangjitur pabesimtarëve.

Nuhu e pa të birin e tij në vërshim e i tha: “... O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bëj me mohuesit!”.

“Ai (djali) tha: Unë do të ngjitem në një kodër që do të më mbrojë nga uji (vërshimi)!”.

“Nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të

*All-llahut, pos atij që Ai e ka mëshiruar?”.*

*“Vala hyri në mes tyre të dyve, e djali u mbyt në ujë.”*

Nuhu u pikëllua për të birin, e si mos të pikëllohet meqë ai është biri i tij.

Nuhu deshi ta shpëtonte të birin e tij prej zjarrit të ditës së kijametit meqë nuk mundi ta shpëtonte prej ujit.

Vërtet zjarri është më i rreptë se uji, por s’ka dyshim se dënimi i ahiretit është më i rëndë.

A nuk ka premtuar All-llahu se Ai do të shpëtojë familjen e tij? Po! S’ka dyshim se premtimi i All-llahut është i vërtetë.

Andaj deshi të ndërmjetësonte tek All-llahu për birin e tij.

## 21 NUK I TAKON FAMILJES SATE

*“Nuhu e luti Zotin e vet, duke i thënë: O Zoti im, djali im është i familjes sime, e premtimi Yt është i saktë, ndërsa Ti je më i drejti i*

*të drejtëve!?”.*

Mirëpo All-llahu nuk shikon origjinën, por shikon veprat.

All-llahu nuk pranon ndërmjetësimin për idhujtarët.

E idhujtari nuk i takon familjes së Pejgamberit, qoftë edhe biri i tij.

E All-llahu ia tërhoqi vërejtjen Nuhut duke i thënë: “... O Nuh, Ai (djali) nuk ishte nga familja jote (për të cilën të premtova se do t’i shpëtojë), ai ishte punëkeq, e ti mos më kërko Mua atë që nuk di, Unë të këshilloj që të mos bëhesh me të paditurit!”.

Nuhu u vetëdijësua, u pendua tek All-llahu dhe tha:

*“... Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde që të (mos) kërkoj prej Teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jam i humbur!”.*

## 22 PAS PËRMBYTJES

Pasi u bë ajo që All-llahu dëshiroi dhe u përmbytën pabesimtarët, u pengua qielli dhe uji u avullua.

Anija u ndal në kodrën el-Xhudijj...

*“E u tha: I shkatërruar qoftë populli mizor!”.*

Dhe Nuhut iu tha: “Zbarko, qofsh i shpëtuar”.

Nuhu zbarkoi e ata që ishin në anije ecën mbi tokë si më mirë.

E pabesimtarët nga populli i Nuhut u shkatërruan e për ta nuk qau as qielli e as toka.

All-llahu i bekoi pasardhësit e Nuhut, ata u përhapën në sipërfaqen e tokës dhe u mbush toka.

E në te pati popuj, peygamberë dhe mbretër.

*“Selam i qoftë Nuhut (prej All-llahut e prej krijesave) në mbarë botën (si kujtim ndaj tij)”.*

BISMIL-LAHIR-RRAHMANIRR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Furtuna

4



## PAS NUHUT A.S.

All-llahu i bekoi pasardhësit e Nuhut dhe u përhapën në sipërfaqen e tokës.

Nga pasardhësit e tij pati një popull i cili quhej Ad.

Ishin burra të fortë, trupat e tyre ishin si prej hekuri, e mposhtnin çdokënd e ata nuk mund t'i mundte askush.

Nuk i frikësoheshin askujt e atyre u frikohej çdokush.

All-llahu e bekoi popullin Ad në çdo send, devetë dhe bagëtia e tyre e mbushnin luginën.

Kuajt e tyre e mbushnin hapësirën.

Fëmijët e tyre i mbushnin shtëpitë.

E kur dilnin devetë dhe bagëtia e Adit në kullosë, kishin një pamje fort të bukur.

Kur dilnin fëmijët në mëngjez për të luajtur, kishin një pamje fort të bukur.

Gjithashtu toka e Adit ishte tokë e bukur, me gjelbërim, e kishte kopshte dhe burime të shumta.

## 2 PABESIMTARËT AD

Mirëpo Adi nuk iu falënderua All-llahut për këto dhunti të shumta dhe Adi e harroi ndodhinë e vërshimit për të cilin kishin dëgjuar prej baballarëve të tyre e që i kishin parë gjurmët e tij në tokë.

Kishin harruar përse All-llahu e kishte dërguar përmbytjen mbi popullin e Nuhut.

U bënë prej atyre që i adhurojnë idhujt, siç kishte qenë populli i Nuhut që i adhuronte idhujt.

Me duart e tyre i gdhendnin idhujt prej gurëve, pastaj iu përkuleshin dhe i adhuronin ata.

Kërkonin ndihmë për nevojat e tyre, iu luteshin atyre, u bënë kurban dhe shkonin gjurmëve të popullit të Nuhut.

Kishin mendje të tilla që nuk i pengonin nga adhurimi i idhujve.

Kishin mendje të tilla që nuk i udhëzonin.

Ishin të mençur për këtë botë e kokë-trashë për fe.

## 3 ARMIQËSIA E ADIT

Fuqia e Adit u bë fatkeqësi për ata vetë dhe për mbarë njerëzimin.

Meqë ata nuk i besonin All-llahut e as ahiretit (botës matanshme), çfarë mund t'i pengonte ata nga padrejtësia? Çfarë mund t'i pengonte ata nga armiqësia?

E përse mos t'u bënë zullum (padrejtësi) njerëzve? Ata nuk e shihnin dikë mbi veten, nuk i frikoheshin llogarisë e as ndëshkimit.

Ata ishin si egërsira të malit, i madhi e dëmtonte të voglin e i fuqishmi e hante të dobëtin.

Kur hidhëroheshin ishin si elefanti i zemëruar, që çka gjen përpara vetëm se e mbyt.

Ishin të atillë që kur luftonin gjithçka shkatërronin.

Kur hynin në ndonjë vend turbullonin dhe të parët e atij vendi i nënçmonin.

E të dobëtit i druheshin të keqes së tyre, dhe largoheshin prej zullumit të tyre.

E forca e tyre u bë fatkeqësi për vetë ata dhe për njerëzit.

E i tillë është çdokush që nuk i frikohet All-llahut dhe nuk i beson botës së përtejshme.

## 4 PALLATET E ADIT

Populli Ad nuk kishin punë tjetër përpos ngrënies dhe pijes, zbavitjes dhe lojës.

I lavdëroheshin njëri-tjetrit me ndërtimin e pallateve të larta dhe shtëpive të mëdha.

Pasurinë e tyre e shpenzonin në ujë, baltë dhe gurë, po të shihnin ndonjë vend të zbrazët ose truall të naltë menjëherë ndërtonin mbi të pallat të lartë.

Ndërtonin shtëpi sikur do të banonin përgjithmonë në to dhe sikur mos të vdisnin kurrë.

Ndërtonin pallate pa nevojë, kurse njerëzit e tjerë nuk kishin çka të hanin dhe çka të vishnin.

Kishte të varfër në mesin e tyre, të cilët nuk kishin shtëpi për të banuar e shtëpitë e pasanikëve nuk kishin banorë në to.

Kush i ka parë ata dhe pallatet e tyre, e ka kuptuar se ata nuk i besonin ahiretit.

## SHUDI PEJGAMBER

Dëshira e All-llahut ishte që tek populli Ad të dërgonte Pejgamber.

Nuk ka dyshim se All-llahu nuk është i kënaqur me mosbesimin e robit, vërtet All-llahu nuk e do parregullsinë në tokë.

Populli Ad mendjen nuk e përdorte përpos për ngrënie, pije, zbavitje, lojëra dhe për ndërtimin e shtëpive.

Arsyeja e tyre u pat çrregulluar ngaqë ata nuk e përdornin për fe, populli Ad ishte i mençur për jetën e kësaj bote e torollak për fe, adhuronin gurëzit e nuk kuptonin.

E All-llahu dëshiroi t'u dërgonte Pejgamber për t'i udhëzuar.

All-llahu dëshiroi që ky pejgamber të ishte prej mesit të tyre, ta njihnin dhe ta kuptonin fjalën e tij.

Ai pejgamber ishte Hudi, u lind në një shtëpi autoritative në popullin Ad dhe u rrit me mendje të shëndoshë.

## THIRRJA E HUDIT

Hudi u ngrit në mesin e popullit të tij dhe u tha:

*“... O populli im, adhuroni (një Zot) All-llahun, ju nuk keni zot pos Tij...”*

Poashtu Hudi tha: “O populli im, si i adhuroni gurëzit e nuk e adhuroni atë i Cili ju ka krijuar!?”

O populli im këta gurëz që dje i keni  
gdhendur, si po i adhuroni sot, e  
All-llahu ju krijoi dhe ju furnizoi, jua  
bekoi pasurinë, fëmijët, të mbjellat dhe  
pasardhësit.

Ju bëri pasardhës të popullit të Nuhut,  
ju pajisi me fuqi trupore.

Këto dhunti meritojnë që ta adhuroni  
All-llahun e mos të adhuroni tjetërkënd  
pos Tij.

Vërtet kur qenit që ia qet një asht, ai  
nuk do ta lëshonte shtëpinë tuaj dhe do  
t'ju përcillte si hija.

A keni parë ndonjë qen që ta lërë të  
zotin e tij e të shkojë diku tjetër?

A keni parë që ndonjë kafshë ta  
adhurojë gurin, a keni parë që ndonjë  
kafshë t'i përkulet skulpturës?

A është njeriu më i poshtër se kafsha,  
apo ai është më i lartësuar prej kafshës?

# 7 PËRGJIGJJA E POPULLIT

Populli ishte i zënë me të ngrënë, me pije, zbavitje dhe lojëra.

Ata ishin pajtuar me jetën e kësaj bote dhe ishin të kënaqur me të.

U ishte ngushtuar zemra me fjalët e Hudit dhe njëri-tjetrit i thanë: “Çfarë thotë Hudi? Çfarë dëshiron Hudi? Ne nuk e kuptojmë fjalën e tij!”

Ata thanë: “Ky është i paditur apo i çmendur!”

Në një rast kur Hudi i kishte thirrur, autoritetet e popullit të tij kishin thënë:

*“... Ne po të shohim mendjelehtë dhe të quajmë vërtet rrenacak!”*

*“Tha (Hudi): O populli im, nuk jam i metë nga mendtë, por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve”.*

*“(Jam i dërguar) që t’u komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju.”*

## 8 URTËSIA E HUDIT

Nuk pushoi Hudi duke e këshilluar popullin e tij dhe e thirri me urtësi dhe sjellje të mirë.

Hudi tha: “O populli im, unë dje isha vëllai juaj dhe shoku juaj!

A nuk po më njihni?

O vëllezërit e mi! Përse frikësoheni prej meje dhe largoheni prej meje, unë nuk jua pakësoj diç pasurinë tuaj.

*“... O populli im, për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri, shpërblimi im është vetëm tek All-llahu...”*.

O populli im, përse frikësoheni po qe se i besoni All-llahut, pasha All-llahun nuk humbni diç nga pasuria juaj nëse i besoni All-llahut!

Përkundrazi, All-llahu jua bekon furnizimin dhe jua shton forcën tuaj.

O populli im, përse habiteni për dërgatën time? Vërtet All-llahu nuk i flet secilit një nga një!

Pa dyshim se All-llahu nuk i ligjëron

çdonjërit e t'i thotë: Vepro ashtu, vepro kështu!

Por All-llahu tek çdo popull dërgon një njeri prej mesit të tyre, i cili u flet dhe i këshillon.

Prandaj më ka dërguar mua tek ju që t'ju flas dhe t'ju këshilloja.

*“A mos u çuditët që shpallja ju erdhi nga Zoti juaj përmes gjubës së një njeriu nga mesi juaj, për t'ju tërbequr vërejtjen...”*

## BESIMI I HUDIT

Populli Ad nuk mundi të gjejë përgjigje!  
Nuk ditën se si t'i përgjigjen Hudit!

Mirëpo meqë ishin të dobët, atëherë thanë: “Ndaj teje janë hidhëruar zotat tanë dhe ti je sëmurë mendërisht!

Dhe ty të ka kapluar fatkeqësia për shkak të zotërave.

Hudi tha: “Vërtet këta idhuj janë gurëz që as i bëjnë dobi dikujt e as e dëmtojnë!”

E padyshim se këta idhuj janë gurëz,  
nuk flasin, nuk dëgjojnë e as nuk shikojnë!

Këta idhuj nuk e mbizotërojnë as të mirën e as të keqen.

Nuk mund të ndikojnë tek dikush për dobi e as për dëm.

Poashtu edhe ju nuk e mbizotëroni të mirën e as të keqën!

Por edhe mua nuk mundeni të më bëni dobi e as të më dëmtoni!

Unë nuk u besoj zotërave tuaj e as u frikësohem.

*“... Unë jam larg nga ajo çka ju i shoqëroni.”*

Poashtu edhe juve nuk u frikësohem...

*“Ju pra, të gjithë përpiquni kundër meje...”*

*“Unë iu jam mbështetur All-llabut, Zotit tim dhe Zotit tuaj...?”*

Gjithçka është nën pushtetin e Tij, as një gjeth nuk mund të bjerë përpos me lejen e Tij.

# 10 KOKËFORTËSIA E POPULLIT AD

Populli Ad gjithë këto i dëgjoji, por megjithatë nuk besoi!

Këshilla e Hudit i shkoi huq me ta!  
Urtësia e Hudit i shkoi huq me ta.

Dhe ata i thanë: “O Hud, ti nuk ke sqarime e as argument!

O Hud, nuk i braktisim zotërat tanë të vjetër për fjalën tënde të re.

A t’i lëmë zotërat, të cilët i kanë adhuruar baballarët tanë, për një thashetheme.

Kurrsesi, kurrsesi.

E njëashtu o Hud, ti nuk u beson zotërave tanë e as nuk u frikësohesh.

Andaj edhe ne nuk i besojmë Zotit tënd e as nuk i frikësohemi dënimit të Tij.

Ne po të dëgjojmë ty se shumë po e përmend dënimin, e ku është ai o Hud, dhe kur do të vijë.

*“Hudi tha:... Atë e di vetëm All-llahu, e unë jam vetëm një qortues që ju bëj me dije”.*

Populli Ad tha: “Neve jemi duke e prit-  
tur atë dënim me padurim presim që ta  
shohim”.

Hudi u çudit për guximin e tyre, dhe i  
erdhi keq për marrëzinë e tyre.

## || DËNIMI

Populli Ad pritte shi për çdo ditë dhe  
shikonin kah qielli por nuk shihnin  
ndonjë pjesë reje.

Kishin nevojë dhe dëshirë të madhe për  
shi.

Një ditë kishin parë një mjegull duke  
ardhur drejt tyre dhe ishin gëzuar  
shumë.

E kishin bërtitur: “Kjo është re shiu!  
Kjo është re shiu”.

Dhe filluan të vallëzonin nga gëzimi,  
bërtitnin dhe njëri-tjetrit i thoshin: “Re  
shiu! Re shiu!”.

Mirëpo Hudi kuptoi se ja arriti dënimi.  
E Hudi atyre u tha: “Kjo nuk është

mjegull e mëshirës, por ajo është erë në të cilën ka dënim të dhembshëm”.

Ashtu edhe ishte, ishte një erë rrëmbyese që nuk e kishin parë njerëzit e as kishin dëgjuar për një erë të tillë.

E era e furishme i shkulte drurët, i shemte shtëpitë, barte çdo gjallesë dhe e gjuante shumë larg.

U trazua pluhuri i shkretëtirës, u errësua bota e njeriu nuk shihte asgjë.

I kaploi ata paniku, hynë në shtëpitë e tyre dhe i mbyllën dyert.

Fëmijët i përqaftuan nënat, njerëzit u mbështetën për mure e poashtu hynë nëpër dhoma.

Fëmijët qanin, femrat piskatnin, e burrat luteshin dhe kërkonin ndihmë.

E dikush tha:

*“... Nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të All-llahut...”*

Ashtu vazhdoi shtatë net e tetë ditë.

Populli vdiq, ranë për toke si drurë të hurmave dhe ishte një pasqyrë fort e çuditshme, njerëzit të vdekur i hanin

shpendët, e shtëpitë mbetën të shkreta e në to banonin hutat.

E shpëtoi Hudi dhe besimtarët me besimin e tyre, e u shkatërrua populli Ad me mosbesimin dhe kokëfortësinë e tij.

*“... Le të dibet, Adët mobuan Zotin e tyre.  
Qoftë i shkatërruar Adi, populli i Hudit”.*



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Deveja  
e popullit  
Themud

5



## PAS POPULLIT AD

Populli Themud e trashëgoi popullin Ad siç e trashëgoi populli Ad ummetin (popullin) e Nuhut.

Populli Themud shkonte gjurmëve të popullit Ad, siç shkoi populli Ad gjurmëve të ummetit të Nuhut.

Edhe vendi i popullit Themud ishte me gjelbërime, me kopshte, me kroje e bahçe nëpër të cilat kalonin lumenj.

Edhe populli Themud ishte si populli Ad sa i përket ndërtimtarisë, bujqësisë dhe kopshtarisë.

Bile i tejkalonin në mjeshtëri, i gdhendnin kodrat dhe bënin shtëpi të mëdha dhe të bukura, në gurë gdhendnin gjëra të mrekullueshme.

Tani më, guri ishte i butë për logjikën dhe mjeshttrin e tyre, andaj edhe punonin me gurin siç punon njeriu me dyllin.

Njeriu që hynte në qytetin e tyre shihte gjëra të çuditshme, shihte pallate të mëdha si kodrat thua se i kishin ndërtuar

xhindet, shihte lule të bukura nëpër mure sikur çelin në pranverë.

Popullit Themud Allahu i kishte dhënë të mira nga qielli dhe toka, ja kishte hapur portat e së mirës për çdo send.

Nga qielli u dhuronte shi me bollëk, nga toka u dhuronte prodhime dhe lule, u dhuroi kopshte me pemë, dhe Allahu ua bekonte furnizimin dhe ndërtimtarinë.

## 2 POPULLI PABESIMTAR THEMUD

Mirëpo të gjitha këto Themudit nuk i lanë shenjë për ta falënderuar dhe adhuruar Allahun e Madhëruar.

Përkundrazi, ndikuan për mosbesim dhe shfrenim, e harruan Allahun, gëzoheshin për dhuntitë e dhëna dhe thoshin: “Kush është më i fuqishëm se ne?”

Mendonin se nuk do të vdisnin dhe se

kurrë nuk do të dilnin nga pallatet dhe bahçet e tyre.

Mendonin se vdekja nuk mund të futej në ato kodra dhe nuk do të mundte të gjente rrugë për te ata!

Ndoshta kujtonin se populli i Nuhut u përmyt meqë ai ishte në luginë.

E populli Ad ishte shkatërruar meqë kishin jetuar në rrafshinë!

E këta na paskan qenë në vend të sigurtë prej frikës dhe vdekjes!.

## 3 ADHURIMI I SHTATOREVE

Dhe nuk u mjaftoi kjo, por gdhendën gurëzit dhe adhuruan shtatoret prej tyre.

U bënë të tillë që i adhuronin gurëzit siç i adhuronte populli i Nuhut dhe populli i Adit.

Allahu i bëri mbizotërues të gurit, mirëpo ata nga padituria e tyre, u bënë adhurues të gurëve.

Allahu i nderoi dhe u dha prodhime të dëlira (hallall).

Ndërkaq, ata e nënçmuan veten dhe e nënçmuan njeriun.

*“Allahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata ia bëjnë vetes së tyre”.*

Çudi! Gurin të cilin e skalitnin me duart e tyre, i cili nuk kundërshton e as kundërvihet.

E dëgjonin dhe i përkuleshin atij!

A e adhuron i fuqishmi të dobëtin? A i përkulet zotëria pengut të vet?

Mirëpo ata e harruan Allahun dhe harruan veten, mohuan adhurimin e Allahut e Allahu i poshtëroi.

## L SALHU (PAQA DHE SHPËTIMI QOFTË MBI TË)

Allahu deshi t’u dërgonte Pejgamber, siç dërgoi tek populli i Nuhut dhe i Adit.

Allahu nuk pajtohet me mosbesimin e pengut (abdit) të Tij, Allahu nuk e do

rrëmujën mbi tokë.

Në mesin e tyre kishte një burrë i cili quhej Salih. Kishte lindur në një shtëpi me emër, u rrit si i mençur dhe i suksesshëm.

Si fëmijë ishte me autoritet dhe jashtëzakonisht i zgjuar, për të bënë me gisht njerëzit.

E thoshin: “Ky është Salihu, ky është Salihu!”

Njerëzit kishin shpresë të madhe te ai dhe thoshin: “Ky do të luajë rol, ky do të luajë rol!”

Njerëzit mendonin se Salihu do të bëhej më i shquari dhe më i pasuri ndër ta.

Poashtu mendonin se ai do të kishte pallat të bukur dhe pemishte të madhe.

I ati mendonte se biri i tij me mendjeprehtësinë që kishte do të fitonte pasuri të madhe dhe do të dilte ndër njerëz.

Do të dilte hipur mbi kalë me shalë, pas tij do të ishin shërbëtorët e njerëzit do ta përshëndetnin dhe do të thoshin:

“Ky është i biri filanit, ky është i biri filanit!”

E sa do të gëzohej i ati kur do t’i dëgjonte njerëzit duke thënë se biri i tij është fort i lumtur, se biri i tij është shumë pasunik.

Megjithatë, Allahu deshi diçka tjetër, Allahu deshi ta nderonte atë me pejgamberllëk (dërgatë) dhe ta dërgonte te populli i tij, për t’i nxjerrë ata nga errësira në dritë.

A ka nder më të madhe se ky? A ka respekt më të madh se ky?

## **S**THIRRJA E SALIHUT

Salihu u ngrit në mesin e popullit të vet dhe e çoi zërin, duke thënë: “... *O populli im, besoni Allahun (një), nuk keni Zot tjetër pos tij...*”

E të pasurit ishin të zënë me haje e pije, me zbavitje e lojra.

I adhuroni shtatoret dhe nuk shihnin Zot tjetër pos tyre, thirrja e Salihut nuk u pëlqeu, u hidhëruan pasanikët e popullit Themud dhe thanë: “Kush është ky?”

Shërbëtorët thanë: “Ky është Salihu”.

Ata thanë: “Çfarë thotë?”

Shërbëtorët u përgjigjën se ai thotë: “Adhuroni Allahun, nuk keni Zot tjetër pos Tij, Allahu do t’ju ringjallë pas vdekjes dhe do t’ju shpërblejë, unë jam i dërguar i Allahut, më ka dërguar te populli im”.

Pasanikët qeshën dhe thanë: “I gjori! A bëhet ky Pejgamber? Ai as ka pallat e as ka pemishte, ai as ka të mbjella e as ka hurma! E si bëhet ky Pejgamber?”

## MËTIMI I PASANIKËVE

Të pasurit panë se disa njerëz e nderonin Salihun, e meqë frikoheshin për udhëheqësinë e vet, thanë:

*“... Ky nuk është tjetër pos njeri sikurse edhe ju, ha ashtu si hani ju dhe pi ashtu si pini ju!”*

*E nëse i përuleni një njeriu që është si ju, vërtet, atëherë do të jeni të humbur e të mashtruar.*

*Mos vallë ai po ju premtton se pasi të vdisni, të bëheni eshtra e dhé (të kalbur), do të ngriheni të gjallë?*

*Sa larg e larg është sendërtimi i asaj për çka ju premtobet.*

*Nuk ka tjetër, pos jetës sonë të kësaj bote, vdesim, lindim dhe nuk do të ngjallemi!*

*“E ai (Salihu) nuk është tjetër pos njeri që trillon gënjeshtër ndaj Allahut, po ne nuk i besojmë atij.”*

## 7 NA ZHGENJEN MENDIMI YNE

Njerëzit e mohuan Salihun dhe nuk i besuan.

E kur i këshillonte Salihu dhe i ndalonte nga adhurimi i shtatoreve, ata thoshin:

“O Salih, si fëmijë ishe me autoritet të madh, si fëmijë ishe fort i zgjuar, e ne

mendonim se do të bëheshe prej  
njerëzve të mëdhenj dhe me nam të  
madh. Mendonim se do të bëheshe si  
filani e filani, por nuk u bërë gjë. E ata  
që ishin moshatarë të tu, e që ishin më të  
dobët se ti, u bën burra të mëdhenj”.

E ti o Salih e more rrugën e varfërisë.  
Paskëshim pasur mendim të gabuar për  
ty, i humbëm shpresat te ti.

I gjori yt atë, kurrfarë dobie nuk arriti  
prej teje.

E gjora jot ëmë, më kot u lodh me ty!”  
Të tëra këto i dëgjoji Salihu dhe iu  
dhimbs populli i tij.

E kur Salihu kalonte diku, popullsia  
thoshte: “Allahu e mëshiroftë të atin e  
Salihut, i biri i tij dështoi”.

## KËSHILLA E SALIHUT

Salihu nuk pushoi duke e këshilluar  
popullin e vet dhe duke e thirrur në  
rrugën e All-llahut me urtësi dhe butësi.

Ai u thoshte: “O vëllezër! A mendoni se do të mbeteni këtu sajeta?

A mendoni se në këto pallate do të banoni përgjithmonë?

Dhe se nuk do të pushoni duke ngrënë prej këtyre të mbjellave dhe këtyre pemëve?

Dhe se nuk do të pushoni duke skalitur shtëpi nëpër kodra?

Jo, kurrën e kurrës! Kjo nuk bëhet!  
Kurrsesi nuk bëhet!

O vëllezër, e përse vdiqën baballarët tuaj?!

Ata patën pallate, e poashtu patën pemishte dhe kroje.

Patën të mbjella dhe hurma, skalitën shtëpi nëpër kodra në të cilat banuan.

Ndërkaq, e gjitha ajo nuk u bëri dobi!  
E gjitha ajo nuk i mbrojti!

E engjulli i vdekjes arriti tek ata, pra e gjeti rrugën për tek ata!

Edhe ju do të vdisni njësoj, e Allahu do t’ju ringjallë dhe do t’ju pyesë për këto dhunti.”

## 9 "UNË PËR KËTË NUK KËRKOJ PREJ JUSH NDONJË SHPËRBLIM..."

“O vëllezërit e mi, përse ikni prej meje?  
Pse frikoheni?

Unë nuk ua pakësoj pasurinë, unë nuk  
kërkoj diçka prej jush.

Unë ju këshilloj dhe ju përcjell kumtin e  
Zotit tim.

*“Unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë  
shpërblim, shpërblimi për mua është vetëm prej  
Zotit të botëve”.*

Dhe përsëri o vëllezër, përse nuk më  
respektoni, ndonëse jam një këshillues  
besnik?

E përse i respektoni ata të cilët u bëjnë  
padrejtësi njerëzve dhe që ua hanë  
pasurinë? Dhe ata që prishin dhe bëjnë  
rrëmujë në tokë e nuk përmirësojnë!”

Populli mbeti i pafuqishëm dhe nuk  
mundi të përgjigjet.

Andaj thanë: *“Ti je vetëm i magjepsur, ti*

*nuk je tjetër vetëm se njeri sikurse edhe ne,  
e nëse e thua të vërtetën, sille pra ndonjë  
dëshmi!”*

## 10 DEVEJA E ALLAHUT

Salihu tha: “Çfarë dëshmie dëshironi?”

Ata thanë: “Nëse thua të vërtetën, na e nxirr prej kësaj kodre një deve me barrë!”

E njerëzit e dinin se deve nuk mund të lindte përpos deveja.

Dhe se deveja nuk mbin prej tokës, e as nuk del prej gurit.

Kishin bindje se Salihu do të mbetet i pafuqishëm e ata do të korrin sukses!

Mirëpo Salihu kishte besim të fuqishëm në Zotin e tij dhe e dinte se Allahu është mbizotërues i gjithçkaje.

Salihu iu lut Allahut e u bë ajo që kërkuan njerëzit. Doli nga kodra deveja me barrë dhe lindi.

Njerëzit u shastisën dhe u habitën,

mirëpo përsëri ata nuk besuan, përpos  
njërit.

## || RENDI

Salihu tha: “Kjo është deveja e Allahut,  
kjo është dëshmi e Allahut!”

E kërkuat dhe Ai e krijoi me fuqinë  
e Tij.

Bëjini nder kësaj deveje. “... e mos e  
*prekni me ndonjë të keqe se do t’ju godasë  
menjëherë dënimi!*”

Kjo deve ha dhe pi mbi tokën e  
Allahut, vjen dhe shkon, nuk ka nevojë  
që të merreni me ushqimin dhe ujin e  
saj, meqë ushqim dhe ujë ka mjaft”.

Kjo deve ishte shumë e madhe dhe kri-  
jesë e jashtëzakonshme, e bagëtia e pop-  
ullit Themud frikohej dhe ikte prej saj.

Sa herë që bagëtia vinte për të pirë ujë,  
frikohej dhe ikte. Salihu e vuri re këtë  
dhe tha: “Një ditë i takon deves, e një  
ditë bagëtisë juaj. Një ditë do të pijë

deveja, e në tjetrën ditë bagëtia juaj.”  
Ashtu edhe u bë, kur ishte rendi i saj,  
deveja shkonte dhe pinte. E kur ishte  
rendi i bagëtisë së popullit Themud,  
shkonte dhe pinte.

## 12 REBELIMI I POPULLIT THEMUD

Mirëpo populli u kapadais dhe ngriti krye. Thanë: “Përse bagëtia jonë mos të pijë ujë për çdo ditë?”

Njerëzit ishin bezdisur nga ajo deve, nga e cila frikohej bagëtia e tyre. Salihu ua kishte tërhequr vërejtjen që mos ta shqetësonin devenë, mirëpo ata nuk e kishin marrë parasysh vërejtjen.

Ata thanë: “Kush e mbyt këtë deve?”

U ngrit njëri dhe tha: “Unë!”

U ngrit edhe një tjetër, e tha: “Unë!”

Shkuan këta dy të pafat, u ulën dhe po prisnin kur të dilte deveja, e kur ajo doli, i pari e gjuajti me shigjetë, e tjetri e preu me thikë dhe e mbyti.

# 13 DËNIMI

Kur Salihu kuptoi se devenë e kishin therur, u shqetësua dhe u pikëllua fort; dhe u tha njerëzve:

*“... Përjetoni në vendin tuaj tri ditë, ky është caktim jo i rrejsbëm!”*

Në qytet ishin nëntë burra të cilët bënin rrëmujë në tokë, e për të mirë nuk dinin.

U betuan dhe thanë: “Ta mbysim Salihun dhe familjen e tij gjatë natës, e kur të na pyesin, themi se nuk dimë gjë”;

Mirëpo Allahu e mbrojti Salihun dhe familjen e tij.

E në ditën e tretë u erdhi dënimi.

U ngritën në mëngjes si zakonisht, kur ushtoi klithma me një tërmet të tmerrshëm.

Nga britma pëlcisnin zemrat, nga tërmeti u shembën shtëpitë; ishte një ditë e tmerrshme për Themudin.

Mbarë njerëzimi vdiqën e qyteti u shkretua.

Salihu dhe besimtarët u shpërngulën

prej këtij qyteti të pafat. E çfarë të bënin në të?

Salihu doli dhe kur e pa popullatën e tij të vdekur, tha me zë të pikëlluar:

*“... O populli im, unë ju komunikova dërgesën e Zotit tim, ju këshillova sa munda, por ju nuk i përfillni këshilluesit”.*

E sot njeriu nuk mund të shohë atje gjë tjetër përpos pallateve të shkreta dhe burimeve të prishura.

Nuk sheh përpos fshatra të shkatërruara, në të cilat nuk ka në to as thirrës e askush që përgjigjet.

E kur kaloi i Dërguari i All-llahut (Muhammedi)/paqa dhe shpëtimi qofshin mbi të/nëpër vendbanimin e Themudit, në rrugën e tij për në Siri, shokëve të vet u tha:

**“Mos hyni në vendet e atyre të cilët vetveten e dëmtuan, bëni kujdes dhe duke u frikësuar që mos ju godasë ajo që i goditi ata”.**

*“...Kuptoni pra, (populli) Themud e mohoi Zotin e vet. Mallkimi qoftë kundër Themudit”.*

BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Prej  
Ken'anit  
në Egjipt

6



## PREJ KEN'ANIT NË EGJIPT

Jakupi (paqja dhe shpëtimi qofshim mbi të) u shpërngul me bijtë e tij në Egjipt.

U shpërngulën në Egjipt, meqë Jusufi (paqja dhe shpëtimi qofshim mbi të) atje e kishte pushtetin.

Në Ken'an mbanin dhen, i milnin dhe shisnin leshin e tyre.

Ndërkaq, pengjet dhe shërbëtorët e Jusufit hanin dhe dëfreheshin në Egjipt!

E çfarë të bënin në Ken'an? E përse mos të shkonin në Egjipt? Jusufi dërgoi përfaqësuesin e tij te Jakupi e familja e tij, dhe kërkoi të tërhiqeshin prej Ken'anit.

Jusufit nuk i bënte mirë as haja e as pija, deri sa të shihte babanë dhe vëllezërit e tij.

E si t'i bëjë mirë haja e pija, e si të kënaqet me jetën e tij, kur është i vetmuar në Egjipt?

Çfarë të bëjë me pallatet, ndërsa babai dhe vëllezërit e tij janë në një shtëpi të vogël në Ken'an?!

Jakupi dhe bijtë e tij erdhën në Egjipt, Jusufi i priti dhe u gëzua shumë për ta.

Edhe Egjipti e priti familjen e zotërisë dhe sunduesit fisnik, dhe për ta që gëzim i madh.

Popullata e Egjiptit e deshi këtë shtëpi fisnike, meqë ata e donin Jusufin për fisnikërinë dhe mirësitë që u bënte njerëzve.

Poashtu ata e shihnin Jusufin si një vëlla që këshillon me ngushëllim, Jakupin e shihnin si baba të dëgjuar dhe fisnik. Jakupi ishte autoritet i Egjiptit, e banorët e Egjiptit ishin si bijtë e tij.

Jakupit dhe bijve të tij iu bë mirë qëndrimi në Egjipt, dhe për ta u bë atdhe.

## 2 PAS JUSUFIT

Pas një kohe vdiq Jakupi, u pikëllua për të Jusufi dhe u pikëlluan banorët e Egjiptit.

E varrosën këtë autoritet në Egjipt, dhe

e ndienin se kishin humbur babanë.

Pas një kohe vdiq gjithashtu Jusufi, e për banorët e Egjiptit ishte një ditë e rëndë.

Banorët e Egjiptit u pikëlluan shumë për të dhe qanë mjaft kohë për të.

Njerëzit i harruan brengat e veta, sikur të mos i kishte goditur fatkeqësi tjetër para kësaj dite.

Po ashtu e varrosën Jusufin, i shprehën ngushëllime njëri-tjetrit, e para Jusufit ishin të barabartë.

Të rinjtë kishin humbur babanë, e të mëdhenjtë humbën vëllanë.

Njerëzit shkuan te vëllezërit dhe bijtë e vëllezërve të Jusufit për t'u shprehur ngushëllime.

E atyre u thoshnin: “O zotërinj! Sot humbja juaj nuk është më e madhe se humbja jonë”.

Në varrimin e sotshëm kemi humbur një vëlla të sjellshëm, një zotëri të mëshirshëm dhe sundimtar të drejtë.

Ky ishte ai i cili njerëzve u ofroi qetësi dhe largoi padrejtësinë nga vendi.

Ishte ai që pengoi të madhin t'i bënte padrejtësi të voglit, dhe e pengoi të fuqishmin të mos e hante të dobëtin.

Ishte ai që e ndihmoi të shtypurin, e mori nën mbrojtje të frikuarin dhe e ushqeu të uriturin.

Ishte ai që na udhëzoi drejt së vërtetës, na thirri për t'i besuar Allahut, e para ardhjes së tij ne ishim si kafshë, nuk njihshim Allah e as njihshim botë të përtejme.

Ishte ai që na ndihmoi në ditët e urisë, ne hanim e ngopeshim, kur nëpër shtetet e tjera njerëzit vdisnin.

Ne kurrë nuk e harrojmë sunduesin tonë fisnik, dhe nuk harrojmë, o zotërinj, se ju jeni vëllezërit e tij dhe familja e tij.

E sa u gëzua me ju udhëheqësi ynë, në ditën e ardhjes suaj në Egjipt, e sa u gëzuam me gëzimin e udhëheqësit tonë.

E shteti ynë është shteti juaj, o zotërinj, ne për ju jemi ashtu siç kemi qenë kur ishte gjallë udhëheqësi ynë.

### 3 BENI (BIJTË) IZRAILËT NË EGJIPT

Kështu vazhdoi një kohë të gjatë!  
Egjiptasit i rrinin mbas asaj që e  
kishin folur dhe ua njihnin ken'anasve  
përparësitë.

Ishin ata ken'anas të cilët quheshin  
“Beni Izrailë – bijtë e israilëve”, dhe që  
zotëronin autoritet e pasuri.

Mirëpo pas kësaj ndryshoi gjendja,  
shkoi duke u prishur morali i tyre, e  
braktisën thirrjen në besimin në Allahun  
dhe në rrugën e Tij, dhe ranë pre e kësaj  
bote.

E edhe njerëzit e ndryshuan qëndrimin  
ndaj tyre, e nuk i shikonin ashtu siç i  
shikonin baballarët e tyre.

Kështu u bënë të barabartë dhe si  
njerëzit e tjerë, nuk dallonin prej të  
tjerëve përpos nga prejardhja.

Andaj njerëzit filluan të kishin smirë  
për të pasurit ndër ta, e t'i nënçmojnë të  
varfërit ndër ta.

E egjiptasit filluan t'i shikojnë ata si të huaj që vijnë nga ndonjë shtet tjetër.

E që nuk ka për ta të drejtë në Egjipt.

Egjiptasit besonin se ata ishin të zotët e shtetit dhe se Egjipti u takon egjiptasve.

Disa nga egjiptasit mendonin se Jusufi ishte një i huaj, i cili kishte ardhur nga Ken'ani.

E atë e kishte blerë sunduesi i Egjiptit.

E ken'anasit nuk i takonte ta qeveriste Egjiptin.

Shumica e njerëzve e kishin harruar vlerën e Jusufit, fisnikërinë dhe të mirën e tij.

## 4 FARAONI I EGJIPTIT

Në fronin e Egjiptit kishin ardhur faraonët, “sunduesit e Egjiptit”, të cilët i urrenin Beni Izrailët tej mase.

Në pushtetin e Egjiptit kishte ardhur një sundues shumë i egër.

Ai nuk e merrte parasysh se Beni Izrailët ishin të bijtë e pejgamberëve dhe

se ishin të shtëpisë së Jusufit, i cili kishte qenë sundues fisnik i Egjiptit.

Madje nuk i quante si njerëz të cilët e meritojnë mëshirën e drejtësinë.

Erdhi në pushtet të Egjiptit një sundues shumë tiran.

Ai mendonte se populli i tij “Kibti” dhe populli Beni Izrail ishin dy raca të ndryshme.

Kibtitë janë racë e sunduesve, janë të krijuar për të qeverisur. E Beni Izrailët i takojnë racës së robërve, janë të krijuar për të shërbyer.

Faraoni sillej ndaj Beni Izrailëve si të ishin ata gomarë dhe kafshë që i shërbejnë njeriut, dhe ushqim u jepte aq sa të kishin forcë ditore.

Faraoni ishte sundues tiran dhe kryelartë, mbi vete nuk shihte tjetër.

Ai nuk i besonte Allahut, por thoshte: *“Unë jam zoti juaj më i madh”*.

I ishte rritur mendja me pushtetin, pallatet dhe forcën e tij, dhe thoshte: *“A nuk është imi pushteti i Egjiptit dhe i*

*këtyre lumenjve që rrjedhin në pallatin tim, a nuk po shihni?”*

Posi të ishte trashëgimtar i Nemrudit, sunduesit të Babilonit. Ishte i atillë, që po të shihte dikë mbi veten hidhërohej.

I thërriste njerëzit që ta adhurojnë dhe t'i përkulen, e njerëzit iu nënshtruan.

E Beni Izrailët ngurruan meqë ata i besonin Allahut dhe të dërguarve të Tij, e hidhërimi i faraonit ndaj Beni Izrailëve u shtua edhe më.

## 5 PRERJA E FËMIJËVE

Një fallxhor kibti kishte shkuar te faraoni dhe i kishte thënë:

“Në mesin e Beni Izrailëve do lindë një fëmijë, e pushteti yt do të kalojë në duart e tij”.

Faraoni u çmend, urdhëroi policinë për të therur çdo fëmijë që lind ndër Beni Izrailët.

Faraoni mendonte se ai ishte zot i

njerëzve, kë të donte e priste e kë të donte jo.

Si pronari i dheneve, që ther nga dhentë e tij çka dëshiron e çka nuk dëshiron e lë.

Ashtu policia u vu në lëvizje në tërë Egjiptin, kontrollonin dhe hulumtonin, e po qe se hetonin se kishte lindur ndonjë fëmijë tek Beni Izrailët, e merrnin dhe e thernin posi delen.

Në male jetonin ujquit, në fusha jetonin gjarpërinjtë e akrepat dhe askush nuk i shqetësonte.

Mirëpo në mbretërinë e faraonit nuk mund të jetonte një fëmijë i Beni Izrailëve.

U prenë me mijëra fëmijë para syve të nënave dhe baballarëve të tyre.

Dita në të cilën lindej një fëmijë ndër Beni Izrailët ishte ditë e vështirë.

Ishte ditë e dëshpërimit dhe e vajit.

Dita në të cilën lindej një fëmijë nga Beni Izrailët ishte ditë e ngushëllimeve dhe e dhimbsurisë.

Me qindra fëmijë priteshin për një ditë

si në Bajramin e Kurbanit.

Siç theren në të (Festën e Bajramit) qindra dhen, deve dhe lopë.

*“Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kryet lart në tokë, e popullin e saj e ka ndarë në grupe dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, e gratë ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve”.*

## LINDJA E MUSAIT

Allahu deshi që të ndodhë ajo nga e cila faraoni frikohej dhe ruhej.

Lindi fëmija si e kishte caktuar Allahu që pushteti i faraonit të kalojë në duart e tij.

Lindi ai fëmijë si e kishte caktuar Allahu që çlirimi i Beni Izrailëve të ishte në dorën e tij.

Lindi ai fëmijë si e kishte caktuar Allahu që t’i nxirrte njerëzit nga adhurimi i njerëzve në adhurimin e Tij.

Lindi ai fëmijë si e kishte caktuar Allahu

që t'i nxirrte njerëzit nga errësira në dritë.

Lindi Musai, i biri i Imranit, për kundër vullnetit të faraonit dhe ushtrisë së tij.

Musai jetoi tre muaj, krahas ushtrisë dhe mbikëqyrjes së tyre.

## 7 NË NIL

Mirëpo nëna e Musait u frikua për fëmijën e saj të bukur, e si mos të frikosej kur armiku i fëmijëve ishte në pritje?

E si mos të frikësohej, kur policia kishte rrëmbyer dhjetëra fëmijë nga prehri i nënave në familjet e tyre?

Çfarë të bëjë nëna e gjorë, ku ta fshehë këtë fëmijë të bukur, kur policia ka sy të korbit dhe nuhatje të buburrecit?

Atëherë Allahu e ndihmoi nënën e ngratë dhe e frymëzoi që ta vinte në një arkëz dhe ta hidhte në Nil.

Allahu është më i madh! Si nëna e mëshirshme ta vinte fëmijën e saj në arkëz dhe ta hidhte në Nil?!

Kush do t'i jepte gji fëmijës në arkëz?  
E si do të merrte ajër fëmija në arkëz?!  
Të gjitha ato i mendoj nëna e mëshirshme, megjithatë u mbështet në Allahun dhe frymëzimin e Tij.

Për fëmijën as shtëpia nuk është më e sigurtë sesa arkëza!

Policia ishte gjithandej, armiku i fëmijëve rrinte në pritë.

Policia ka sy të korbave dhe nuhatje të buburrecave.

Nëna e gjorë veproi ashtu siç e urdhëroi Allahu, fëmijën e saj të bukur e vuri në arkëz dhe e hodhi në Nil.

Nëna e mëshirshme u pikëllua, por megjithatë bëri durim dhe u mbështet në Allahun.

*“Ne nënën e Musait e frymëzuar: t'i japësh atij gj, e kur të kesh frikë për të, atëherë hidhe në lumë, e mos u frikëso as mos u pikëll, se Ne do ta kthejmë atë ty dhe do ta bëjmë nga të dërguarit”.*

## 8 NË PALLATIN E FARAONIT

Faraoni kishte shumë pallate në breg të Nilit.

Ai bartej prej pallatit në pallat, dhe e bënte piknikun në breg të Nilit.

Në një ditë të piknikut në breg të Nilit ishte ulur dhe po shikonte lumin se si rridhte nën këmbët e tij.

E me të në shëtitje ishte edhe mbretëresha e Egjiptit, e shikonin Nilin se si rridhte, e duke shëtitur u ranë sytë në një arkëz me të cilën loznin valët e Nilit thua se e puthnin.

O zotriu im, a e sheh atë arkëz?

Ku mund të ketë arkëz në Nil? Ajo është copë druri që ka rënë në Nil.

Jo, o zotëria im, por ajo është arkëz!

Dhe arkëza u afrua, e njerëzit thanë:  
“Po kjo është arkëz!”

E mbreti e urdhëroi një shërbëtor, dhe i tha: “Puna e arkëzës është detyrë jotja!”

Shërbëtori shkoi dhe e nxori arkëzën.

Arkëzën e hapën, kur ja një fëmijë i

bukur e i buzëqeshur.

Njerëzit u habitën, çdo njëri e merrte dhe e shikonte.

Edhe faraoni u habit dhe e shikonte.

Një shërbëtor tha: “Ky fëmijë është izraelit, patjetër mbreti ta mbysë”.

Edhe mbretëresha e pa fëmijën, e deshi dhe i hyri në zemër, e mori në krah dhe e puthi.

Ndërmjetësoi për të tek mbreti dhe i tha: *“Shpresë gëzimi për mua dhe për ty, mos e mbysni atë, ndoshta do të na sjellë dobi ose do ta adaptojmë për fëmijë...”*

Kështu pra Musai, i biri i Imranit, kishte hyrë në pallatin e faraonit, dhe jetoi përballë faraonit dhe policisë së tij.

Dhe policia nuk mundi t’i binte në gjurmë këtij fëmije izraelit, edhe pse ata kanë sy të korbit dhe nuhatje të buburrecit.

Deshi Allahu që Faraoni, “armiku i fëmijëve”, të rriste një fëmijë në duart e të cilit do të kalonte pushteti i tij.

I ngrati faraon! Kishte gabuar në punën e Musait. E krahas tij kishte gabuar edhe

ministri i tij Hamani dhe ushtria e tij.

*“E atë e gjeti familja e faraonit, ashtu që në fund ai t’u bëbej atyre armik e dëshpërim.*

*Vërtet, faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre ishin kundërshtarë (gabonin me qëllim)”.*

## **Q**KUSH DO TI JEPTË GJI FËMIJËS

Fëmija i ardhur ishte fëmijë i bukur, ishte lodër e pallatit dhe zbavitje e shtëpisë.

Çdonjëri e merrte dhe e puthte, çdokush e donte dhe e lavdëronte, meqë mbretëresha e donte atë shumë.

E si mos ta donin atë zonjat e pallatit dhe shërbëtorët e pallatit?

Çdokush e merrte dhe e puthte, meqë fëmija ishte i bukur.

Mbretëresha kërkoi mëndeshë për t’i dhënë gjë fëmijës, erdhi një mëndeshë, e mori fëmijën, mirëpo fëmija qante dhe nuk e merrte gjirin.

Mbretëresha kërkoi mëndeshë tjetër,  
u paraqit ajo dhe e mori fëmijën, mirëpo  
fëmija qante dhe nuk e pranonte gjirin.

Edhe e treta, e katërta dhe e pesta  
erdhën, megjithatë fëmija qan dhe nuk  
e merr gjirin!

Çudi! Përse nuk thith fëmija, për çfarë  
arsye qan?

Mëndeshat bën përpjekje që t'i jepnin  
gji fëmijës, ta gëzonin mbretëreshën dhe  
të merrnin dhuratat prej saj, mirëpo në  
këtë Allahu i kishte penguar mëndeshat.

Kështu fëmija u bë temë e bisedës në  
pallat dhe shqetësim i shtëpisë.

Oj motër, a e ke parë fëmijën e por-  
saardhur?

Po, e kam parë, fëmijë shumë i bukur.

Por ai është fëmijë i jashtëzakonshëm,  
nuk është si fëmijët! Ai nuk thith.

E kur e merr mëndesha qan dhe nuk e  
qas, i gjori si jeton? Vërtet ai do të vdesë.

Po, kanë kaluar disa ditë që nuk ka pirë.

# 10 NË PREHRIN E NËNËS SË VET

Nëna e mëshirshme i tha motrës të Musait: “Oj bija ime, shko e shikoje vëllanë tënd, ndoshta është gjallë.

Vërtet Allahu më ka premtuar se Ai do ta kthejë fëmijën tek unë, dhe se Ai do ta ruajë.”

Motra e Musait shkoi që të hulumtonte për vëllanë e saj.

I dëgjoji njerëzit duke biseduar për një fëmijë të bukur në pallatin e mbretit.

Zonja shkoi dhe u ndal për t’i dëgjuar bisedat e grave në pallat.

A ka ardhur mëndesha, të cilën e kërkoi mbretëresha nga Esvani?

Po, oj zonjë, por fëmija përsëri nuk pranon dhe nuk thith.

O Zot! Si është puna me këtë fëmijë?  
Po kjo është mëndesha e gjashtë që e provon mbretëresha.

- Po, dhe thonë se ajo është mëndeshë shumë e pastër, dhe secili fëmijë thith prej saj.

Motra e Musait pasi i dëgjoji ato fjalë, me urtësi dhe afrueshmëri tha:

Unë e njoh një grua në qytet, fëmija patjetër do ta pranojë gjirin e saj.

Një grua tha: “Unë nuk besoj, kemi provuar gjashtë mëndesha, por fëmija nuk thith”.

Një tjetër grua tha: “E përse të mos provojmë me të shtatën, çfarë na kush-ton?”

Dhe kështu mbretëreshës i arriti lajmi, ajo e kërkoi shërbëtoren dhe i tha: “Shko dhe merre me vete atë grua”.

Erdhi nëna e Musait, erdhi edhe shërbëtorja dhe ia afroi asaj Musanë.

Fëmija e përqafoi gruan dhe filloi të thithë, thua se atë e kishte pritur.

E përse mos të thithë, kur ajo është nëna e dhimbsur e tij?!

E përse mos të thithë, kur ai është i uritur tani më prej tri ditësh?!

U habit bashkëshortja e mbretit, u habitën edhe oborrtarët, e faraoni dyshoi dhe tha: Përse ky fëmijë e pranoi këtë

grua, mos është kjo nëna e tij?

Nëna e Musait i tha: “O zotëria im, unë jam femër me erë të mirë, e kam qumështin të mirë, andaj çdo fëmijë më pranon.”

Faraoni heshti dhe e shpërbleu atë me ushqim.

Nëna e Musait u kthye në shtëpi të vet, e në prehër e kishte Musanë.

*“Dhe ashtu atë e kthyem te nëna e vet që ajo të jetë e kënaqur e jo e pikëlluar dhe që ta kuptojë ajo se premtimi i Allahut është i vërtetë e i sigurt, por shumica e tyre nuk e dinë”.*

## || DERI NË PALLATIN E FARAONIT

Kur nëna e Musait mbaroi me gjidhënien, e ktheu atë në pallat. Musai u rrit në pallat, ashtu siç rriten bijtë e mbretërve.

Dhe kështu nga zemra e Musait u largua frika prej mbretërve dhe pasanikëve.

Dhe Musai pa me sy të vet se si kënaqej faraoni dhe familja e tij.

Dhe si vuajnë Beni Izrailët për t'u dëfryer faraoni dhe familja e tij.

Se si vuajnë nga uria Beni Izrailët, për t'u ngopur shtazët e faraonit.

Se si sillen me Beni Izrailët, siç sillen ndaj gomarëve dhe shtazëve.

Se si i shfrytëzonin dhe i keqtrajtonin si mos më keq.

Tërë këto Musai i shihte mëngjes e mbrëmje, por heshte.

Mirëpo e gjitha kjo e hidhëronte Musanë.

E si mos ta hidhëronte nënçmimi i popullit të tij dhe i familjes së tij?

E ata janë të bijtë e pejgamberëve, e ata janë të bijtë e fisnikëve.

E cili është mëkati i Beni Izrailëve, e pse ata nuk janë Kibti (me prejardhje egjiptase)?!

A pse ata janë nga Ken'ani?!

Jo, ky nuk është mëkat! Jo, ky nuk është mëkat!

## 12 TË MËSHUARIT VDEKJEPRURËS

Që në moshën e pjekurisë, Allahu i dha Musait urtësi dhe dituri.

Musai ishte i tillë që i urrente mizorët dhe i përbuzte, e i donte të dobëtit dhe të shtypurit e njëherit i ndihmonte, e i tillë është secili peygamber.

Në një rast Musai hyri në qytetin e faraonit, ku disa prej njerëzve zbavitëshin e disa merreshin me ndonjë punë.

Aty gjeti dy burra duke u rrahur, njëri ishte nga Beni Izrailët e tjetri nga kibtitë, të cilët ishin armiq të Beni Izrailëve.

Izraeliti bërtiti, e thirri Musanë për ta ndihmuar dhe iu ankua për kibtiun.

Musai u hidhërua dhe i ra kibtiut, e rënia e qiti të vdekur.

Kibtiu vdiq, e Musai u pendua shumë, njëherit kuptoi se kjo vinte nga puna e djallit (shejtanit).

Musai u pendua tek Allahu dhe e brejti ndërgjegjja, e i tillë është çdo peygamber.

*“... Ai (Musai) tha: Kjo është prej veprave të djallit, e s’ka dyshim se ai është armik i hapët që shpie në humbje.”*

E Allahu ia pranoi Musait pendimin, meqë Musai nuk pati për qëllim që ta mbyste kibtiun, por i mëshoi atij e ai ra i vdekur.

Musai falënderoi Allahun dhe tha:  
“Vërtet Allahu më dhuroi të mira dhe më fali”.

*“... se kurrë nuk do të vibem në ndihmë të kriminelëve”.*

Dhe ai gdhiu i frikësuar në qytet, duke pritur dhe duke pasur vëmendje se kur do t’i vinin policët e faraonit, të cilët kishin sy të korbave dhe nuhatje të buburrecave.

Gdhiu i frikësuar e duke pritur se kur do t’i vinte policia që ta merrnin e t’ua dorzonin tiranëve.

Policia e kishte parë kibtinë e mbytur, i cili ishte nga shërbëtorët e faraonit, e hulumtuan dorasin por nuk arritën t’i binin në gjurmë.

E kush mund t'i udhëzonte për gjakësorin, kur atë çështje nuk e dinte kush përpos Musait dhe izraelitit?!

Dhe i mbyturi u bë temë e bisedës në shtet dhe shqetësim për qytetin, çdokush bisedonte lidhur me të, por nuk dinte kriminelin.

E faraoni u hidhërua dhe policisë i tha: “Patjetër ta hulumtoni dorasin”.

## 13 DEL NË SHESH FSHETËSIA

Edhe një ditë tjetër Musai e pa izraelitin në armiqësi dhe duke u rrahur me një kibti tjetër.

Izraeliti nuk u turpërua, por bërtiti dhe e thirri Musanë për ta ndihmuar.

Musai i tha: “Ti je burrë i paturp, a nuk do të pushosh nga përleshja dhe të rrahurit me njerëzit, a vazhdimisht do të bërtasësh dhe do të më thërrasësh?”

A vazhdimisht do të të ndihmoj ty

*“... Vërtet t’i qenke ngatërrestar i njohur”.*

Kështu Musai deshi ta edukonte pak kibtiun dhe u nis drejt tyre. Izraeliti e pa hidhërimin e Musait dhe qortimin e tij.

U frikua se po i mëshon atij Musai dhe do ta mbyste, sikur i kishte mëshuar kibtiut dhe e kishte mbytur.

*“... ai tha: A do të më mbysësh mua siç e mbyte dje njeriun, ti nuk do tjetër, vetëm se të bëhesh arrogant në tokë, e nuk dëshiron të jesh nga përmirësuesit!”*

Këtu e kuptoi kibtiu se Musai është si gjakësori i djeshëm.

Kibtiu shkoi dhe e njoftoi policinë se Musai ishte ai dorasi. Lajmi arriti deri te faraoni, i cili u hidhërua dhe tha:

A ai djaloshi i edukuar në pallat dhe thithësi i birësuar?

Mirëpo Allahu deshi ta shpëtonte Musanë nga e keqja e faraonit dhe e policisë së tij.

Sepse Musai nuk kishte synuar që ta mbyste kibtiun, por i kishte rënë një herë dhe kishte ndodhur vdekja.

Mirëpo faraoni dhe policia e tij nuk e merrnin parasysh atë, dhe nuk ia pranonin Musait për arsytim.

Vërtet Allahu kishte caktuar që pushteti i faraonit të kalonte në dorë të Musait, Allahu kishte caktuar që çlirimi i Beni Izrailëve të ishte në dorë të Musait.

Allahu kishte caktuar që Musai t'i nxi-rrte njerëzit nga adhurimi i njerëzve në adhurimin e Allahut të Lartmadhëruar.

E si do të bëhej ajo, po qe se tek ai arrinte dora e policisë mizore?

Njerëzit e faraonit dhe ministrat e tij ishin këshilluar dhe kishin vendosur për mbytjen e Musait.

Një njeri kishte dëgjuar dhe kuptuar tërë ato e kishte ardhur te Musai dhe e kishte lajmëruar, e i kishte thënë:

*“... pra ti dil (ik), unë jam këshillues yt”.*

E ai doli prej aty i frikësuar e duke prit-ur (se ç'po ndodh) dhe tha:

*“O Zoti im, më shpëto prej popullit zullu-  
mqar”.*

## 14 PREJ EGJIPTIT DERI NË MEDJEN

Por deri ku do të shkojë Musai, meqë Egjipti në tërësi është nën pushtetin e faraonit?!

E policia e faraonit është në pritë, ata kanë sy të korbit dhe nuhatje të bubur-recit!

Allahu e frymëzoi Musain për të shkuar në qytetin arab Medjen, ashtu që mos të arrinte tek ai dora e faraonit.

Medjeni është shkretëtirë dhe ka fshatra në të cilët nuk është qytetërimi i Egjiptit.

Dhe në të nuk ka pallate të Egjiptit dhe rrugë të Egjiptit.

Mirëpo ato vise janë të lumtura, meqë janë larg prej faraonit.

Vërtet ato janë të lumtura, meqë janë vise të lira, nuk janë nën pushtetin e faraonit.

Oh, sa e dashur është prapambetja me liri dhe drejtësi!

Oh, sa i pafat është qytetërimi me peng

dhe nënçmim!

Atje çdokush gdhin duke mos iu frikësuar dënimit dhe dhunës së faraonit.

Atje secili i hyn natës duke mos iu frikësuar policisë së faraonit dhe të keqes së tij, atje nuk i therin bijtë.

Musai ia mësyni Medjenit. Doli nga Egjipti duke u frikësuar dhe duke pritur a do ta ndiqte dikush, mirëpo policia kishin fjetur.

Musai doli në emër të Allahut, duke iu lutur Allahut dhe duke kërkuar ndihmë prej Tij.

“Dhe kur u drejtua kah Medjeni tha:  
*“Shpresoj që Zoti im të më orientoj rrugës së drejtë”*.”

## 15 NË MEDJEN

Musai arriti në Medjen, ai nuk njihte ndokënd, e as atë nuk e njihte ndokush.

Te kush do të kërkonte strehim gjatë natës? Ku do të bunte?

Kishte rënë në mëdyshje Musai, por megjithatë u bind se nuk do ta prishte Allahu!

Aty kishte patur një burim, nga i cili njerëzit u jepnin ujë bagëtisë së tyre.

Aty i gjeti dy femra të cilat i mbanin larg dhentë e veta dhe prisnin që të tjerët t'u jepnin ujë dhenve të tyre, e pastaj këto t'u jepnin të vetave.

Musai i pa, ndërsa në zemrën e tij kishte ndjenja fisnike dhe brengë të një prindi të mëshirshëm.

Dhe u tha: “Përse nuk u jepni ujë dhenve?”

Ato u përgjigjën: “Nuk mundemi t’ju japim ujë dhenve tona derisa t’u japin njerëzit e tjerë, meqë ata janë të fuqishëm, e ne jemi të dobëta, dhe meqë ata janë burra e ne jemi femra”.

Po si ta dinin se Musai do t’i pyeste: “E përse nuk u jep ujë ndonjë burrë i shtëpisë suaj?”

Ato iu përgjigjën: *“Ati ynë është plak i shtyrë në moshë”*.

Musait iu trazuan ndjenjat e fisnikërisë,  
u dha të pinin ujë dhenve të tyre, dhe ato  
u larguan.

E ku do të shkonte Musai tani?

Ku do të strehohej gjatë natës dhe ku  
do të bunte?

Ai nuk njih askënd, as atë nuk e njih  
askush!

*“... pastaj u largua anash nën një hije e tha:  
‘O Zoti im, unë kam nevojë për çkado që të  
më japësh.’”*

## KËRKESA

Dy vajzat arritën në shtëpi para kohës  
së caktuar, e babai i tyre u habit dhe i  
pyeti për shkakun.

Dhe u tha atyre: “Oj bijat e mia, çfarë  
u shpejtoi, e si arritët sot para kohës?”

Dy zonjushat i thanë: “Allahu na e  
kishte caktuar një njeri fisnik, i cili  
dhenve tona u dha ujë”.

Plaku u habit dhe e kuptoi se ai njeri

është i huaj, meqë askush nuk i ka mëshiruar ndonjë ditë.

Plaku u tha: “E ku e latë njeriun?”

Ato iu përgjigjën: “E lamë në vendin e tij, ishte burrë i huaj e nuk kishte strehim!”

Plaku tha: “Nuk keni bërë mirë, oj bijat e mia, burri i huaj na bëri mirë, ndërkaq ai nuk ka ku të strehohet.

Ku do të strehohet gjatë natës, e ku do të bujë?!

Ne ndaj tij kemi borxh si mysafir, ndaj tij kemi detyrimin e së mirës!

Le të shkoj njëra prej jush dhe le ta marrë me vete”.

*“E njëra prej tyre erdhi tek ai, ecte e turpëruar, e tha: ‘Babai im të thërret që të paguaj ty shpërblimin për atë që na u dhe (bagëtisë) ujë!’”*

Musai e kuptoi se Allahu iu përgjigj lutjes së tij, e vendosi dhe nuk e kundërshtoi.

Musai doli para vajzës që mos e shihte duke ecur, e Musai eci si i ka hije një të denji.

E kur arriti te plaku, ai e pyeti për emrin, vendin dhe ç’i kishte ndodhur.

Musai i tregoi për ndodhinë dhe ia rrëfeu ngjarjen.

Plaku i dëgjoji të tëra me durim dhe qetësi, e kur mbaroi nga rrëfimi i tij:

*“... ai tha: ‘Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar!’”*

## 17 MARTESA

Musai qëndroi tek ata si një mysafir i çmueshëm, saqë mes tyre mori vendin e djalit të dashur.

Një ditë njëra prej vajzave, i tha të atit qartë dhe me sinqeritet:

*“... O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi, e besniku”.*

Plaku tha: “Oj bija ime, çfarë njohuri ke ti për forcën dhe besnikërinë e tij?”

E bija u përgjigj: “Sa i përket fuqisë së tij, ai e ngriti vetëm kapakun e burimit,

atë nuk mund ta ngrinte veçse një grup njerëzish.

E sa i përket besnikërisë së tij, o babai im, ai ecte para meje dhe gjatë tërë rrugës nuk më ka vështruar.

E patjetër qiraxhiu, shërbëtori duhet të jetë i fuqishëm dhe besnik. Po qe se nuk është i fuqishëm, punon dobët.

E po qe se nuk është besnik, nuk na bën dobi fuqia e tij krahas tradhtisë”.

Fjala e vajzës u përputh me atë që dëshironte zemra e plakut, por ai mendoj për çështjen si prind.

Mendoj për çështjen si plak i mençur.

Plaku tha me vete: “Kush ka më shumë të drejtë sesa ky djalosh, të më bëhet dhëndër?”

E ku mund të gjej në botë djalosh më të mirë se ky?!

Sa i përket në Medjen, nuk mund t’i gjindet shoku!

Ndoshta Allahu ma ka sjellë këtë djalosh për të m’u bërë dhëndër dhe ndihmës.”

Në vazhdim, me dinjitet, ndjenja dhe urtësi tha:

*“... Unë dëshiroj të martobesh me njërën prej këtyre dy vajzave të mia, me kusht që të më shërbesh tetë vjet...”*

Kjo është paja jote, ato tetë vjet janë të detyruara.

*“... e nëse i plotëson dhjetë, ai është vullneti yt, e në dashtë Allahu, ti do të gjesb tek unë mirëkuptim”.*

Plaku frikësohej se djaloshi do të largohej me bijën e tij, e ai do të mbeste i vetmuar.

Andaj, plaku kishte vendosur ta sprovonte djaloshin gjersa atij t'i flinte zemra për ta përcjellë.

Musai u pajtua me të, e quajti se ajo ishte prej Allahut dhe se Allahu do t'i jepte bereqet në të.

Allahu atë e kishte sjellë në Medjen, e kishte dërguar te plaku dhe kishte hedhur në zemrën e tij dhembshuri dhe dashuri.

E tha (Musai): *“... Kjo le të mbetet mes meje dhe teje...”*

Mirëpo Musai me talentin dhe urtësinë e tij, deshi të ruante të drejtën për të zgjedhur, dhe më në fund, për të mos ngjallur mërzi, tha:

*“... e cilindo afat që do ta kryej nga këta të dy, nuk do të ketë përgjegjësi për mua. Për këtë që po themi Allahu është dorëzanë”.*

## 18 DREJT EGJIPTIT

*“E kur Musai e kreu afatin dhe udhëtoi me familjen e vet...”*

U përshëndetën me njëri-tjetrin, e plaku u lut për të:

“Me uratë të Allahut, biri im! Nën mbrojtjen e Allahut, bija ime!”

E Musai udhëtoi me familjen e tij, e nata ishte e ftohtë dhe e errët.

Mirëpo ku të gjenin zjarr në shkretëtirë?

Dhe çfarë të bënin po qe se nuk gjenin zjarr për t’u ngrohur, dhe po qe se nuk gjenin dritë për t’u drejtuar në rrugë?!

Në udhëtim e sipër Musai kërkonte

zjarr. *“Kur ai e pa një zjarr, e i tha familjes së vet: ‘Rrini ku jeni, se vura re një zjarr, e ndoshta do t’ju sjell ndonjë gacë prej tij, ose do të gjej te zjarri ndonjë udhërrëfyes’.”*

Musai shkante drejt zjarrit me dëshirë të flaktë.

*“E kur shkoi tek ai (zjarri), u thirr: O Musa! Vërtet Unë jam Zoti yt, hiq atë që ke mbathur (opingat e nallet), se je në luginën e shenjtë Tuva”.*

Aty i kishte folur Allahu Musait dhe i kishte shpallur:

*“Unë të zgjodha ty (për peygamber), prandaj dëgjo mirë se ç’po të shpallet! Vërtet, vetëm Unë jam Allahu, nuk ka zot tjetër pos meje, pra Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua. S’ka dyshim se momenti (kiameti) do të vijë patjetër...”*

Musai mbante një shkop me vete, i cili e ndihmonte.

E Allahu i Lartëmadhëruar i tha:

*“O Musa, ç’është ajo që e ke në të djathtën tënde?”*

Musai u përgjigj thjeshtë dhe pa teklif.

*“... Ai është shkopi im...”*

Dhe Musai filloi t’i numëronte dobitë e atij shkopi hollësisht, meqë ai dëshironte të fliste me Allahun dhe biseda e tij të ishte e gjatë.

*“... Ai është shkopi im që mbahem në të, dhe me të u shkund (gjethe) dhenve të mia, dhe me të kryej edhe nevoja të tjera”.*

*“Ai (Allahu) i tha: ‘Hidhe atë, o Musa!’”*

*“Ai e hodhi atë, kur ja, një gjarpër i madh që lëvizte me shpejtësi”.*

*“(Allahu) i tha: ‘Kape atë, e mos u frikëso, se Ne do ta kthejmë atë përsëri në gjendjen e mëparshme!’”*

Musait i dha mrekullinë e dytë, e ajo ishte dora e bardhë, e i tha:

*“Dhe fute dorën tënde nën sqetullën tënde e do ta nxjerrësh atë të bardhë pa asnjë të metë. Kjo është një mrekulli tjetër”.*

# 19 SHKO TE FARAONI SE AI ËSHTE BËRË ARROGANT

Pas gjithë asaj, Allahu e kishte urdhëruar Musanë për t'ia filluar punës, për të cilën e kishte krijuar Ai.

Vërtet faraoni ishte kapardisur, vërtet faraoni kishte bërë rrëmujë mbi tokë.

Populli i faraonit nuk e kishin besuar Allahun, populli i faraonit kishin bërë fesad mbi tokën e Allahut.

Allahu nuk kënaqet me mosbesimin e robëve të Tij, Allahu nuk e do rrëmujën mbi tokë.

Vullneti i Allahut ishte që Musai të shkonte te faraoni dhe populli i tij. “... se me të vërtetë ata janë popull i prishur”.

Mirëpo si të shkonte Musai te faraoni dhe si të takohej me despotin?

E ai dje e kishte mbytur kibtiun, dhe e djeshmja nuk është larg!

Ishte ai i cili kishte dalë me frikë nga Egjipti dhe duke pritur se ç'po ndodhte, e atë e njohin policia por e njohin edhe

oborrtarët.

*“Ai (Musai) tha: ‘O Zoti im, unë kam mbytur një njeri prej tyre, e frikësohem se do të më mbysin!’”*

Musai përmendi edhe se belbëzon.

Allahu i dinte të gjitha ato, megjithatë, përkundër gjithë asaj, dëshira e Tij ishte që Musai të shkonte.

*“(përkujto) Kur Zoti yt e thirri Musanë: ‘Të shkohsh tek ai populli zullumqar!’ ‘Populli i faraonit, a nuk janë duke iu frikësuar (dënimet)?’”*

*“Ai (Musai) tha: ‘Zoti im, kam frikë se do të më trajtojnë si gënjeshtar. Do të më shtrëngohet krabbarori (shpirti) im dhe nuk do të më lëshohet gjuha (të flas rrjedhshëm), andaj dërgoje (bëje peygamber) Harunin.*

*Madje unë kam një faj ndaj tyre, e kam frikë se do të më mbysin (për hakmarrje)!”*

*“Ai (Allahu) tha: ‘Kurrsesi (nuk do të mbysin), po shkoni ju të dy me argumentet Tona. Ne jemi me ju vështruesit tuaj (ju dëgjojmë e ju ndihmojmë).*

*“Shkoni dhe faraonit i thoni: ‘Ne jemi të dër-*

*guar nga Zoti i të gjitha botëve’.*

*T’i lejosh Beni izrailët të vijnë me ne!”*

Allahu i këshilloi Musanë dhe Harunin për butësi dhe sjellje të mirë me faraonin.

Në suaza të caktuara, Allahu e do shpirtmadhësinë ndaj armiqve të Tij, dhe tha:

*“Atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet”.*

## 20 PARA FARAONIT

Musai e Haruni vajtën te faraoni dhe ndenjën me të për ta thirrur në besim në Allahun.

Tirani u hidhërua prej guximit të Musait dhe me mendjemadhësi e kapadaillëk tha:

“O djalosh, po kush je t’i që vjen në rrethin tim e më këshillon? A nuk je ti ajo foshnja që të gjetëm në det?!”

*“... A nuk të rritëm ty si fëmijë në mesin tonë, ku i kalove disa vjet të jetës sate?”*

*Dhe ti e bërë atë punën tënde që e bërë, pra ti*

*je mobues (i të mirave që t'i bëjnë).*”

Musai nuk hidhërohet, nuk e përgën-  
jeshtron, nuk mohon e as nuk arsyeto-  
het, por i përgjigjet qartë dhe me dinjitet.

*“(Musai) tha: 'E bëra atë, atëherë kur isha i  
pavetëdijsëm. Andaj, edhe ika prej jush kur  
u frikësova nga ju, e Zoti im më dburoi urtësi  
dhe më bëri nga të dërguarit'.”*

Musai tha: “O faraon, ti më përmend  
edukimin, por nuk e shikon atë përse  
rashë në duart e tua dhe si t'u dha  
mundësia për të më edukuar?”

Ti, sikur mos të kishe urdhëruar për  
mbytjen e fëmijëve, nëna ime nuk do të  
më hidhte në Nil dhe unë nuk do të  
kisha rënë në dorën tënde.

Përballë mizorisë dhe vrazhdësisë sate, e  
kjo përmendet dhe numërohet si mirësi?

Ti ndaj mbarë popullit tim u solle  
sikurse ndaj gomarëve dhe shtazëve.

I ke thirrur sikur u thirret qenve.

I ke munduar si mos më keq.

E çfarë mirësie të takon ty, ngaqë qenke  
kujdesur për një fëmijë prej tyre?!

Por edhe atë e ke bërë nga mosdija dhe gabimisht!

*“Më përmend atë të mirë që më bërë mua, e ti robërve Beni Izrailë!”*

## 21 THIRRJA PËR TË BESUAR ALLAHUN

Faraoni ishte i paaftë dhe nuk mundi të përgjigjej, e deshi të dilte dhe tha:

*“...E cili është ai zot i botëve (që ju dërgoi)?”* që po të dëgjoj duke e përmendur.

*“Ai tha: ‘Zoti i qiejve dhe i tokës dhe ç’ka ndërmjet tyre, nëse bindeni!’”*

Faraoni u hidhërua për këtë përgjigje dhe dëshira e tij ishte që edhe të pranishmit të çuditen dhe të revoltohen.

*“Ai (faraoni) atyre që ishin përreth, u tha: ‘A nuk e dëgjoni?!’”*

Musai nuk e ndërpreu fjalën por e priti edhe me ramjen e dytë.

*“Ai (Musai) tha: ‘Zoti juaj dhe i prindërve tuaj të parë!’”*

Faraoni u hidhërua edhe më dhe nuk mundi të duronte, andaj edhe tha:

*“... Vërtet, i dërguari juaj që u është dërguar juve, me siguri është i çmendur!”*

Musai nuk e ndërpreu fjalën, por i mëshoi edhe për së treti.

*“(Musai) tha: ‘Zoti i lindjes e i perëndimit dhe ç’ka ndërmjet tyre, po qe se kuptoni!’”*

E faraoni deshi t’ia largonte vëmendjen Musait nga ajo temë e hidhur për atë (faraonin).

Poashtu ai dëshiroi ta shprehte mllëfin e grumbulluar dhe tha: *“Si është gjendja e popujve të mëparshëm?”*

Faraoni në vete thoshte: “Po sikur Musai të thotë se ata kanë qenë në të drejtë?”.

Unë i them: “Ata i adhuronin idhujt!”

E po qe se Musai thotë se ata kanë qenë në humbje dhe të paarsyeshëm?

Zemërohet suita (rrethi im) dhe thonë: “Vërtet Musai i fyen paraardhësit tanë”.

Mirëpo Musai ishte më i mençur se faraoni, Musai ishte nën dritën e Zotit të tij, dhe tha:

*“...Dija për ata është te Zoti im, e shënuar në një libër. Zoti im nuk gabon e as nuk harron”.*

Pastaj Musai filloi të fliste mbi atë nga e cila faraoni largohej dhe donte të dilte:

*“... Zoti im nuk gabon e as nuk harron.  
(Zoti im) I cili për ju e bëri tokën si djep, për të mirën tuaj hapi rrugën nëpër të, lëshoi shi prej së larti...”*

Faraoni u habit, mbeti me gojë të hapur dhe nuk diti çfarë të thoshte, e pastaj tha atë që e thonë të gjithë mbretërit kur ndihen të paaftë dhe kur zemërohen.

*“(Faraoni) Tha: ‘Nëse ti beson zot tjetër pos meje, do të gjendesh në mesin e të burgosurve!’”*

## 22 MU'XHIZET (MREKULLITË) E MUSAIT

E kur faraoni e lëshoi shigjetën e tij, Musai deshi ta gjuante me shigjetë të Allahut.

*“(Musai) Tha: ‘A edhe nëse të sjell ndonjë argument të qartë?’”*

*“Ai tha: ‘Sille pra, nëse e thua të vërtetën!’”*

*“Atëherë (Musai) e hodhi shkopin e vet, i cili u shndërrua në gjarpër të vërtetë”.*

*Nxori dorën prej xhepit, kur qe, ajo në sy të shikuesve flakëronte nga bardhësia”.*

E faraoni e gjeti një fjalë për t’ua thënë atyre që e rrethonin.

*“(Faraoni) Parisë që e rrethonin, u tha: ‘Vërtet, ky qenka magjistar shumë i aftë!’”*

Paria u pajtua me të. *“... ata thanë: Kjo nuk është tjetër pos magji e qartë”.*

*Musai tha: ‘A së vërtetës i thoni magji? A magji është kjo? Magjistarët nuk shpëtojnë?’”*

E faraoni e gjuajti Musanë me një shigjetë tjetër, dhe tha:

*“Ata thanë: ‘Mos erdhe të na largosh nga ajo (feja) që e gjetëm te prindërit tanë, për t’ju mbetur ju të dyve madhështia në tokë?’*

*Po ne nuk u besojmë ju të dyve”.*

Faraoni deshi t’i frikësonte parinë nga Musai, ashtu siç veprojnë mbretërit.

*“E tha: Ai që me magjinë e vet dëshiron t’ju dëbojë nga toka juaj, e ç’më propozoni mua?”*

Paria i sugjeruan mbretit që t’i tubonte

magjistarët nga mbarë vendi, dhe me ta t'i kundërvihet Musait.

Ashtu edhe u bë, në mbarë shtetin e Egjiptit tellallët kishin thirrur:

“Kushdo që di magji, le të paraqitet te mbreti.”

Ishin tubuar magjistarët nga gjithë anët e shtetit. Ai tubim kishte qenë ditë feste.

*“Edhe popullit iu tha: ‘Ejani e tubobuni’”.*

*“Ashtu që t'i përkerahim magjistarët, nëse ata triumfojnë.”*

## 23 PËR NË SHESH

Dilnin njerëzit nga shtëpitë e tyre në mëngjes! Shkonin për në shesh turma-turma.

Drejt sheshit shkonin fëmijë, të rinj, pleq e burra e gra.

Nuk kishte mbetur në shtëpi pos ndonjë i sëmurë ose i paaftë. Në Matarije (qytet i Egjiptit) nuk dëgjohej pos bisedave të magjisë dhe emrave të magjistarëve.

A ka ardhur magjistari më i madh nga Esvani? Po. Ka ardhur edhe magjistari i Uksurit, edhe magjistari i mirënjohur nga Xhizeti. Ç'mendon, o vëlla, kush do të fitojë?

Egjipti ka afruar njerëzit më të dëgjuar për këtë çështje, ta merr mendja se mund të fitojë dikush!

E si mund të fitojnë mbi ta Musai dhe vëllai i tij (Haruni), po ku e kanë mësuar ata magjinë?

Ai u rrit në pallatin e mbretit, pastaj doli nga Egjipti me frikë dhe duke pritur se ç'po ndodh, e në Medjen kishte disa vjet.

E ku e mësoi magjinë?

A në Egjipt? Jo!

A në Medjen? Nuk kemi dëgjuar se atje ka mjeshtëri të magjisë!

Erdhën Beni Izrailët, e ata ishin mes shpresës dhe brengës, megjithatë brenga mbizotëronte, Allahu e mëshiroftë të birin e Imranit! Allahu u ndihmoftë Beni Izrailëve!

Erdhën magjistarët, u paraqitën me mendjemadhësinë dhe krenarinë e tyre, dolën me veshjet e tyre shumëngjyrëshe, dolën me shkopinj dhe litarë.

Dolën duke qeshur dhe me gëzim, sot është dita e zanatit!

Sot mbreti e sheh mjeshtërinë tonë, sot populli e sheh vlerën tonë!

*“E kur erdhën magjistarët i thanë faraonit:  
‘A do të ketë shpërblim për ne, nëse dalim  
ngadhënjimtarë?’”*

*“Ai tha: ‘Po, bile ju do të jeni atëherë prej më  
të afërmve!’”*

Të tilla janë dhuratat e mbretërve! Ato janë që i japin mbretërit!

Kjo është ajo me të cilën mashtrohen burrat! E kjo është ajo me të cilën joshen trimat!

U gëzuan magjistarët me premtimet e faraonit.

## 24 MES SË VËRTETËS DHE JO SË VËRTETËS

*“Musai atyre u tha: ‘Hidhni atë që keni për ta hedhur!’”*

E ata i hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre, duke thënë:

*“Për hir të madhërisë së faraonit, ne me siguri do të jemi ngadhënjyes!”*

Njerëzit panë çudi, gjarpërinjtë ecnin nëpër shesh, njerëzit u hutuan, filluan të tërhiqen prapa dhe të bërtasin:

“Gjarpërinj! Gjarpërinj!”

Gratë piskëllonin, fëmijët qanin, e bërtimat u ngritën në shesh: “Gjarpërinj! Gjarpërinj!”

Edhe Musai pa atë që panë njerëzit dhe u habit.

*“...Kur, ja, atij iu duk se nga ajo magji e tyre litarët dhe shkopinjtë lëviznin (si gjarpërinj).”*

Dhe Musait zuri t’i hynte frika në zemër, e përse të mos frikësohej Musai?

Ajo ishte ditë e ndeshjeve! E në provim ka ose nderim ose nënçmim!

Po sikur të ngadhënjejnë magjistarët –  
jo, Allahu mos e bëftë ashtu!

E po qe se mundet Musai – jo, Allahu  
nuk lejon një gjë të tillë.

E çfarë bëhet? Allahu na ruajt!!

E fitorja e Musait nuk është fitore e një  
njeriu, por ajo është fitore e Fesë para  
mbretit.

Ashtu ajo është fitore e së vërtetës para  
së padrejtës.

Jo, Allahu nuk e ka vendosur asnjë gjë të  
tillë! Jo, Allahu nuk lejon një gjë të tillë!

Megjithatë, Allahu e trimëroi, dhe tha:

*“... Mos ki frikë, është më se e sigurt se t’i do  
të jesh triumfues!”*

*“Tani hidhe atë që e ke në dorën tënde të  
djathtë (shkopin), që t’i gëlltisë ato që i bënë  
ata, sepse ajo që bënë ata nuk është tjetër pos  
mashtrim magjistari, e magjistari nuk do të  
ketë sukses kudo qoftë”.*

*“... Musai u tha: ‘Kjo që e sollët ju tash,  
vërtet është magji! Po Allahu do ta asgjësojë  
këtë, sepse Allahu nuk e përkrash veprën e të  
prishurve.’”*

*“Dhe me argumentet e veta All-llahu e fuqizon të vërtetën, ndonëse e urrejnë të pabesët”.*

*“Atëherë edhe Musai e hodhi shkopin e vet, i cili menjëherë gëlltiste gjithë çka kishin sajuar ata”.*

*“Atëherë u dëshmuua e vërteta dhe u zhbduk ajo që kishin përgatitur”.*

Magjistarët u habitën dhe u hutuan.

Çfarë është kjo? Ne e dimë magjinë dhe rrënjët e saj, ne e dimë magjinë dhe llojet e saj.

Ne jemi mësues të këtij arti (magjisë)!

Ne jemi dijetarë të këtij zanati!

Kjo nuk i përket magjisë! Kjo nuk ka të bëjë me magjinë!

Po të ishte magji, do ta sulmonim magjinë me magji, dhe do ta luftonim artin (mjeshtërinë) me art!

Mirëpo mjeshtëria jonë u tret para tij, dhe humbi ashtu siç humbet vesa para diellit.

E prej nga vjen kjo? Kjo mund të jetë prej Allahut!

Magjistarët u bindën se Musai është i

dërguar, dhe se Allahu i ka dhënë mrekulli, andaj edhe u pikëlluan dhe brohoritën:

*“Ne i besuam Zotit të Harunit e të Musait!”*

*“E magjistarët u hodhën (u përulën) në sexhde. Dhe thanë: ‘Ne i besuam Zotit të gjithësisë. Zotit të Musait dhe të Harunit!’”*

## 25 KËRCËNIMI I FARAONIT

Faraoni thjesht u çmend!

Faraoni u ngrit e u ul, murmuriste e kërcënohej i gjori, ndodhi ajo çka nuk e shpresonte!

Ai deshi ta mposhtë Musain me magjistarët, e magjistarët u bënë ushtarë të Musait.

Ai deshi t’i largojë njerëzit nga Musai e për këtë erdhi me magjistarët, kur ja ata të parët u bënë besimtarë!

Vërtet sulmi i tij iu kthye bumerang.

Faraoni besonte se ai ishte mbret i mendjes, siç ishte mbret i trupave.

Se ai kishte pushtet mbi zemrat, siç kishte pushtet mbi gjuhët.

Dhe s'ka kush të besonte diç, pos me lejen e tij, dhe me mendjemadhësi e me fuqi tha:

*"... I besuat atij, para se t'ju lejoja unë?!"*

Dhe i sulmoi faraoni me një sulm ashtu siç dinë të bëjnë mbretërit, dhe tha:

*"... S'ka dyshim se ai (Musai) është prijësi juaj që ua mësoi juve magjinë..."*

I sulmoi për së dyti, e tha:

*"... Kjo është një dredhi që ju e përgatitët në qytet (Misir) për t'i dëbuar prej tij banorët e tij (kibtitë), po më vonë do ta kuptoni (çka do t'ju gjejë)"*

I sulmoi edhe për të tretën herë dhe të fundit ashtu siç dinë të bëjnë mbretërit:

*"Kam për t'ju prerë duart dhe këmbët tërthorazi, pastaj të gjithëve do t'ju gozhdtoj."*

Besimtarët i përballuan të gjitha ato sulme nën mburojën e besimit dhe durimit, e thanë:

*"...S'ka rëndësi, ne i kthebemi Zotit tonë".*

*"Meqë ne jemi besimtarët e parë, shpresojmë"*

*se Zoti ynë do të na i falë mëkatet tona!”*

Pastaj, me besim dhe shend thanë:

*“Ne i besuam Zotit tonë që Ai të na i falë gabimet tona dhe magjinë, me të cilën ti na detyrove. Allahu është më i miri (në të shpërblyerit) dhe më i përjetshmi (në të dënuar)! Ai që i paraqitet Zotit të vet si kriminel, e ka xhebenemin, në të cilin as nuk vdes as nuk jeton. Ndërsa ai që i paraqitet Atij besimtar e që ka bërë vepra të mira, të tillët i presin merita të larta. (do ta presin) Xhenetet të Adnit, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përjetë. Ky është shpërrblim i atij që është pastruar nga mosbesimi”.*

## 26 NËNÇMUESHMËRIA E FARAONIT

Faraoni u shqetësua prej çështjes së Musait saqë i kishte ikur edhe gjumi.

Kishte rënë faraoni në atë gjendje, saqë nuk kishte më shije as të ushqimit e as të pijes.

Po ashtu, në revoltën e tij ndikuan edhe të tjerët, të cilët thoshin:

*“... A do të lejosh Musanë dhe popullin e tij të bëjnë përçarje në tokë dhe të braktisin ty dhe zotat e tu?...”*

Faraoni u pezmatua dhe u hidhërua.

*“... Ai (faraoni) tha: ‘Do t’ua mbysim djemtë e do t’i lëmë gratë e tyre për shërbim, ne jemi sundues mbi ta’”.*

Faraoni me çdo kusht kishte dashur t’i largonte Beni Izrailët nga Musai.

*“Ndërsa faraoni thirri popullin e vet e tha: ‘O populli im, a nuk është imi pushteti i Egjiptit (Misrit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, a nuk po shihni?’”*

*“Pra, unë jam më i mirë se ky qyqar që mezi flet!”*

Pastaj faraoni me qetësi dhe butësi, tha:

*“... O ju pari, unë nuk njoh ndonjë zot tjetër për ju pos meje...”*

Thua se shumë kishte analizuar e menduar, dhe e kishte këshilluar popullin e tij.

Pastaj, me nënçmueshmëri e çmenduri, tha:

*“... andaj ti o Haman, m’i piq (tullat) nga dheu e më ndërto një kullë të lartë, ndoshta do të arrij ta shoh zotin e Musait, sepse unë mendoj se vërtet ai është gënjeshtar”.*

Hamani i poqi tullat, e ndërtoi kullën, por deri ku? U lodh Hamani e edhe mjeshtrit, u sosën balta e edhe tullat.

Faraoni ishte shumë larg dhe nuk kishte mundur të arrinte as te retë, e mos të flitet për hënën.

Nuk kishte arritur te hëna, e mos të flitet për diellin.

Nuk kishte arritur te dielli, e mos të flitet për idhujt.

Nuk kishte arritur te idhujt, e mos të flitet për qiellin.

Faraoni mbeti pa shpresë, u turpërua, u ligështua dhe u ul.

I gjori, a nuk e dinte se Allahu: *“... Ai që krijoi tokën dhe qiejt e lartë”.*

*“E Tij është çdo gjë që ekziston në qiej e në tokë dhe çdo gjë që gjendet në mes tyre, edhe ç’ka nën dhe”.*

*“Ai është që në qiell është Allah dhe në tokë Allah...”*

Faraonit nuk i mbeti dredhi tjetër, pos ta mbyste Musanë, e argumenti i tij ishte se Musai kishte nxitur trazira në vend.

*“... Më lini mua ta mbys Musanë, e ai le ta thërrasë Zotin e vet. Pse unë kam frikë se po ua ndryshon fenë tuaj, ose po nxit trazira në vend!”*

BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

# Besimtari i familjes së Faraonit

7



## BESIMTARI I FAMILJES SË FARAONIT

Kur faraoni deshi ta mbyste Musanë, u ngrit një njeri nga familja e faraonit, me besimin e fshehur të tij, e tha:

- ... *A doni ta mbysni një njeri vetëm pse thotë 'Zoti im është Allahu', ndërsa ju ka sjellë argumente prej Zotit tuaj?....*". Po ashtu, ai njeri i arsyeshëm nga familja e faraonit kishte thënë:

"Përse e kundërshtoni dhe e mundoni Musanë? Po qe se nuk i besoni, lëreni, ajo është çështje e tij, dhe lëreni në rrugën e tij".

*"...Nëse ai është rrenës, për vete e ka rrenën,..."*

E po qe se e mundoni dhe e turpëroni, ai është i dërguar, atëherë vaj halli për ju!

*"... E nëse është i drejtë, do t'ju goditë diçka nga ajo që ai ju premtton..."*

O vëllezër, mos u mashtroni me pushtetin tuaj, me forcën tuaj dhe me ushtrinë tuaj.

*"O populli im, sot pushteti në vend është juaji,*

*po kush do të na mbrojë prej dënimit të Allahut nëse ai na përfshin?...”*

Përgjigjja e faraonit qe:

*“... Unë nuk kam mendim tjetër t’ju jap, pos atij që ju thashë, dhe nuk jam duke ju udhëzuar tjetër pos në rrugën e drejtë!”*

Njeriu i arsyeshëm kishte dashur që t’ia tërhiqte vërejtjen popullit të tij, për rrugën dhe përfundimin e keq të zullumqarëve, e tha:

*“... O populli im, unë kam frikë për ju, se po ju gjen, si i gjeti popullsitë e mëparshme (grupet e mëparshme)! Si rasti i popullit të Nubut, të Adit, të Themudit dhe të atyre që ishin pas. Allahu nuk bën padrejtësi ndaj robërve.”*

Njeriu i urtë i frikësoi ata me Ditën e Kiametit.

E ç’është Dita e Kiametit?

*“Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet. Prej nënës dhe prej babait të vet. Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet”.*

*“Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të*

*njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të sinqertë në miqësi.”*

*“... atëherë, në atë ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyesë kush për njëri-tjetrin”.*

Është dita kur Sunduesi dhe i Plotfuqishmi (All-llahu) thërret:

*“...I kujt është pushteti sot? (bëhet pyetja). I Allahut, i Atij që është një, i Fuqiplotit (është përgjigjja)!”*

Është dita kur njerëzit frikësohen, piskasin dhe i thërrasin njëri-tjetrin për ndihmë, dhe është dita kur kthehen të ikin, e nuk ka kush që ta prapësojë prej tyre dënimin e All-llahut.

Po ashtu njeriu i urtë tha:

*“O populli im, unë kam frikë për ju ditën e britmës (të mjerimit). Ditën, kur nga frika ktheheni të ikni, e nuk ka kush që ta prapësojë prej jush dënimin e Allahut. Atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë që e drejton”.*

Njeriu i urtë vazhdoi:

- All-llahu ju dha një dhunti, por ju nuk ia ditët vlerën, dhe nuk e vlerësuat ashtu

siç e meriton, e pasi ju doli duarsh, ju erdhi keq për të.

Ai ishte i Dërguari Jusuf (paqa dhe shpëtimi i All-llahut qofshin mbi të), të cilin nuk e njohët dhe nuk e vlerësuar ashtu siç e meritonte.

E kur vdiq, thatë: “Subhanell-llah (All-llahu është i Lartmadhëruar), ishte Pejgamber dhe nuk ka si Jusufi. Ishte sundimtar dhe nuk ka si Jusufi! Ishte burrë dhe nuk ka si Jusufi.

Kush mund të jetë për ne Pejgamber pas tij?! Kush mundet të jetë për ne i barabartë me të?! Kurresi! Nuk vjen më si ai!”

*“Edhe Jusufi, qysh herët ju patë ardhur me argumente të qarta e ju gjithnjë ishit në dyshim ndaj asaj që ju patë sjellë, derisa edhe kur vdiq ai, ju patët thënë: Allahu nuk do të dërgojë pas tij pejgamber!...”*

Njashtu do të veproni pas këtij pejgamberi!

Dhe do të pendoheni!

## 2 KËSHILLA E NJERIUT

Njeriu e këshilloi popullin e tij, ju ofroi dashurinë dhe këshillën e tij.

*“Ai që kishte besuar tha: O populli im, ejani pas meje, e unë t’ju udhëzoj në rrugën e drejtë!”*

Njeriu besimdrejtë e dinte se populli ishte i dehur me jetën e kësaj bote.

Dhe se faraonit i ishte rritur mendja në saje të pushtetit dhe forcës së tij.

Mirëpo, kjo jetë është një ëndërr prej ëndrrave, e kjo botë është si hija që ikën.

Po ashtu, njeriu e dinte se çfarë e pengonte popullin për ta pasuar Musanë, meqë ata ishin të dehur me dehjen e kësaj bote.

E i dehuri as nuk ndien e as ka ndjesi.

Ngaqë ata nuk e dëgjonin zërin e Musait.

E ai deshi t’u tërhiqte vërejtjen për moskujdesinë e tyre dhe u tha:

*“O populli im, kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se një përjetim i përkohshëm, ndërsa bota tjetër është ajo e përhershme!”*

E të paditurit nga populli i tij filluan ta thërrasin në mosbesim (kufër), bestytni (shirk) dhe në fenë e baballarëve.

Kur ai u thoshte:

- Ejani, besoni All-llahun! - ata i thoshin:

- Kthehu në fenë e baballarëve!

E kur e tepruan me atë thirje, ai u kishte thënë:

*“Dhe, o populli im, ç’është kjo që unë ju thërras në shpëtim, e ju më thërrisni për në zjarr?”*

*“Më thërrisni ta mohoj Allahun dhe ta adhuroj atë për të cilin nuk di asgjë, ndërsa unë ju thërras për te i Gjithëfuqishmi, Mëkatfalësi!”*

Njeriu vazhdoi e u tha:

- Cili nga mesi i zotave tuaj ka ardhur peygamber? Cili libër ka zbritur? Dhe kush është ai që thërret në atë libër?

*“Ata (që i adhuroni ju) nuk janë tjetër, vetëm se emra që ju dhe prindërit tuaj i emërtuat, Allahu nuk zbriti për ta ndonjë fakt...”*

E peygamberët që thërrasin për të besuar All-llahun, janë: Ibrahim

(paqa dhe shpëtimi i All-llahut qofshin mbi të), Jusufi dhe ky peygamber i All-llahut, Musai. Për çdo çështje ai argumenton! Në çdo vend ai bën thirrje!

*“Është e vërtetë se atij tek i cili më thërrisni mua, nuk i takon adhurimi as në këtë dynja, as në botën tjetër...”*

E kur njeriu u dëshpërua prej asaj ku e shtynin dhe iu mërzit vendi i tyre, i braktisi dhe u tha:

*“Do t’ju bjerë ndërmend çka po u them, e çështjen time ia besoj Allahut, vërtet, Allahu mbikëqyr robërit”.*

Njerëzit u hidhëruan, e njerëzit e faraonit deshën ta mbytnin, por All-llahu e mbrojti dhe i shkatërroi armiqtë e tij.

*“Dhe Allahu e shpëtoi atë (besimtarin) prej të këqijave që i kurdisën, ndërsa ithtarët e faraonit i përfshiu dënimi më i keq”.*

## 3 BASHKËSHORTJA E FARAONIT

Faraoni besonte se ishte mbret i mendjeve, ashtu siç ishte mbret i trupave.

Se ai kishte pushtet mbi zemrat, ashtu siç kishte mbi gjuhët. Në Egjipt, nuk kishte të drejtë dikush të mbante bindjen në diçka, ose të besonte diçka, pos me lejen e tij.

E po që se dikush, edhe në ndonjë vend më të largët të Egjiptit i besonte Musait, faraoni marrosej krejt. Ngrihej dhe ulej, murmuriste dhe flakëronte. E thoshte:

- Si mund t'i besojë ai Musait, para se t'i jepet leje për të?! Jeton në shtetin tim, e vepron kundër meje, ha prej ushqimit tim e më mohon mua?! Për çdo banor të Egjiptit, unë i jam më i nevojshëm sesa vetja e tij.

E faraoni harronte se ai jetonte nën pushtetin e All-llahut, por nuk i përkulej, hante nga ajo që e jepte All-llahu, por

nuk i besonte Atij.

E All-llahu ia paraqiti një shenjë në shtëpin e tij, në familjen e tij. I tregoi se Ai është Sundues i mendjeve, ashtu siç është i trupave.

Dhe se Ai ka pushtet mbi zemrat, ashtu siç ka mbi gjuhët.

Padyshim se All-llahu ndërhyr mes burrit dhe familjes së tij, All-llahu ndërhyr mes njeriut dhe zemrës së tij.

Kishte hyrë besimi në shtëpinë e faraonit, e ai nuk e kishte hetuar dhe nuk kishte mundur ta mposhte.

Bashkëshortja e faraonit e kishte besuar All-llahun, dhe e kishte mohuar faraonin. I kishte besuar Musait, ndonëse burri i saj ishte mbret i Egjiptit.

Ajo (bashkëshortja e faraonit) i kishte besuar Musait si krijesë e All-llahut, që më së miri e kishte njohur faraonin dhe e cila ishte krijesa më e dashur për të, nga mbarë njerëzimi.

Policia e faraonit nuk kishte mundur të bënte asgjë, nuk e kishte hetuar atë,

ndonëse kanë nuhatje si të buburrecit dhe sy si të korbit. Atë nuk e hetoi faraoni, e ai ishte njeriu më i afërt i saj.

Edhe po të dinte faraoni, çfarë do të bënte? Ai sundonte mbi trupin, por nuk mbretëronte mbi mendjen. Ai kishte pushtet mbi gjuhën, por nuk kishte pushtet mbi zemrën. Gruaja ka për detyrë ta respektojë burrin, por nuk respektohet krijesa kur vjen puna te padëgjueshmëria ndaj Krijuesit.

Fëmija ka për detyrë t'i respektojë prindërit dhe të jetë mirënjohës e i dashur ndaj tyre, por nuk i takon t'i respektojë kur vihet në pyetje shirku (bestytia).

*“E nëse ata të dy kërkojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, pastaj tek Unë do të ktheheni, e Unë do t’ju njoftoj për atë që keni punuar”.*

Bashkëshortja e faraonit ngulmoi në iman (besim), ajo e adhuronte All-llahun në shtëpinë e armikut të All-llahut.

Ajo i frikësohej All-llahut dhe i arsyetohet Tij për atë që vepronte faraoni.

All-llahu që i kënaqur prej gruas së faraonit, e shpëtoi atë nga faraoni dhe veprimet e tij, dhe ua bëri shembull besimtarëve për besimin dhe guximin e saj.

*“E atyre që besuan, Allahu u sollti shembull gruan e faraonit, kur ajo tha: ‘Zoti im, më bëj një vend pranë mëshirës sate në xhenet, më shpëto prej faraonit e vrazhdësisë së tij dhe më shpëto prej popullit mizor!’”*

## 4 PROVA E BENI IZRAILËVE

E kur njerëzit e kuptuan armiqtësinë e faraonit kundër Beni Izrailëve, iu afruan faraonit me armiqtësinë dhe provokimet e tyre.

Edhe fëmijët u trimëruan kundër Beni Izrailëve, por edhe qentë i ndërshenit

kundër tyre.

Për çdo ditë kishin sprovë të re! Për çdo ditë u vinte diç e padëshirueshme.

E Musai (paqa dhe shpëtimi qofshin mbi të) i qetësonte dhe këshillonte me sabër (durim), duke u thënë:

*“...Kërkoni ndihmë prej Allahut dhe keni durim. S’ka dyshim se toka është e Allahut, ia lë në trashëgim atij që do nga robtë e Tij, e ardhmja e lumtur është për të devotshmit”.*

Beni Izrailët u bezdisën nga ato sprova e mundime, dhe Musait i thanë:

“Nuk na bëre diç të mirë! Nuk na begatove gjë!”

*“Ata (populli i Musait) thanë: Ne ishim të shtypur para se të na vije ti, po edhe pasi na erdhe...”*

Kurse Musai nuk ishte shqetësuar. Musai nuk ishte dëshpëruar!

*“... Ai (Musai) tha: Ka shpresë se Allahu do ta shkatërrojë armikun tuaj (faraonin), e ju do t’ju bëjë ta zëvendësoni në këtë vend, e do t’ju shikojë se si veproni ju”.*

*“Musai tha: O populli im, nëse i keni besuar*

*Allahut, vetëm te Ai mbështetuni, nëse jeni të dorëzuar (vendimit të Tij)!”*

*“Ata iu përgjigjën duke i thënë: Allahut i jemi mbështetur, Zoti ynë, mos i mundëso popullit mizor të na sprovujë!”*

*“Dhe me mëshirën tënde, na shpëto prej popullit jobesimtar”.*

Faraoni i pengonte Beni Izrailët nga të adhuruarit All-llahun, dhe hidhërohej kur i shihte se e adhuronin All-llahun dhe i luteshin Atij.

Ai i pengonte për ndërtimin e Xhamive të All-llahut në vendin e tij, dhe hidhërohej kur adhurohej All-llahu në vendin e tij.

Sa i paditur ishte faraoni! Toka është e All-llahut, e jo e faraonit!

E kush është më keqbërës se ai, i cili i pengon robërit e All-llahut nga adhurimi i All-llahut mbi tokën e All-llahut?!

E kush është më keqbërës se ai, i cili thërret në adhurimin e tij, mbi tokën e All-llahut?!

Mirëpo faraoni nuk ia kishte dalë të

pengonte dikë nga veprimi sipas dëshirës në shtëpinë e tij!

E All-llahu, përmes gjuhës të Musait, i urdhëroi Beni Izrailët: “... *shtëpitë tuaja t’i bëni faltore e ta falni namazin rregullisht...*”

Faraoni dhe policia e tij, ishin të paaftë për të depërtuar mes Beni Izrailëve dhe të adhuruarit All-llahun!

E kush mund të ndërhyjë mes robit dhe Zotit të tij? E kush mund të ndërhyjë mes myslimanit dhe të adhuruarit All-llahun?!

## SURIA

E kur faraoni u ndërkrye dhe e teproi në pakujdesi e kokëfortësi, All-llahu deshi t’ia tërhiqte vërejtjen.

All-llahu nuk është i kënaqur me mosbesimin e robit të Vet!

All-llahu nuk e do rrëmujën mbi tokë!

Faraoni ishte krejtësisht i marrë, nuk gjenin vend tek ai urtësia dhe këshilla.

E gomari nuk kupton prej vërejtjes pa i mëshuar!

E All-llahu deshi t'ia bënte me dije!  
Egjipti është vend pjellor dhe i gjelbëruar, vend i të mirave, fryteve dhe drithërave.

E dini se si Egjipti në ditët e urisë i ndihmoi vendet e largëta në kohën e Jusufit, paqa qoftë mbi të.

Dhe si i ndihmoi banorët e Shamit dhe të Ken'anit!

E Nili e njom tokën e Egjiptit dhe i ujit të mbjellat e tyre. Ai është burim i lumturisë dhe së mirës në Egjipt.

E faraoni dhe banorët e Egjiptit mendonin se Nili ishte çelësi i sigurimit të ushqimit. Dhe se Egjipti me Nilin nuk kishte nevojë për shi dhe për çdo gjë tjetër.

E nuk e dinin se All-llahu është Ai tek i Cili janë çelësat e furnizimit.

E All-llahu kujt do i jep furnizim, e kujt do nuk i jep.

Dhe se Nili rrjedh me urdhrin e Tij,

dhe shumohet me urdhrin e Tij.

All-llahu e urdhëroi Nilin, e uji i tij u tërhoq dhe shkoi nën tokë.

E çka i ujit të mbjellat e banorëve të Egjiptit?!

Munguan frytet e tyre dhe munguan drithërat e tyre, dhe ashtu pati zi pas ziele!

Ishin të paaftë faraoni, Hamani dhe policia e faraonit për çdo zgjidhje.

Atëherë banorët e Egjiptit e kuptuan se faraoni nuk është zot i tyre, dhe se furnizimi me ushqim është në pushtetin e All-llahut!

Mirëpo kjo nuk i bëri dobi faraonit, e as banorëve të Egjiptit, dhe nuk ua tërhoqi vëmendjen! E shejtani ndërhyri mes tyre dhe këshillës e mësimit.

E ata thanë:

- Kjo zi dhe këta vjet janë për shkak të kobit të Musait dhe popullit të tij!

Çfarë çudie! A nuk ishte Musai më parë?!

A nuk ishin Beni Izrailët që nga kohërat më të hershme?!

Përkundrazi, kjo vinte nga e keqja e veprave të tyre!! Kjo vinte nga e keqja e mosbesimit të tyre!

Faraoni dhe populli i tij bënë kokëfortësi dhe thanë:

- Ne nuk i nënshtrohemi kësaj magjie.

*“Ata thanë: Me çfarëdo argumenti të na vish, që të na magjepsësh (largosh nga feja që kemi) me të, ne nuk do të besojmë”.*

## **B** PESE SHENJA

All-llahu u kishte dërguar shenjë tjetër.

U kishte dërguar shi, Nili ishte duke e shtuar ujët. Nga qielli kishte rënë shi, kishte rënë e kishte rënë... Derisa ishin përmbytur të mbjellat dhe arat, dhe ishin prishur drithërat dhe frytet.

Dhe shiu u shndërrua për ta në fatkeqësi.

Prandaj ata që ishin ankuar për sasinë e paktë të ujit, që ata po ankoheshin për sasinë e madhe të ujit.

Më pas u kishte dërguar karkaleca, të cilët i hëngrën bimët e fushave dhe të mbjellat, i sulmuan edhe drurët dhe nuk lanë asgjë prej tyre.

Kështu që ushtria dhe policia e faraonit dolën të paafta përballë luftëtarëve të ushtrisë së All-llahut. E si t'i luftonin, ndërsa kundër tyre nuk kishin vlejtur as shpatat e as shigjetat!

Me atë rast, banorët e Egjiptit e kishin kuptuar dobësinë e faraonit, paaftësinë e Hamanit dhe pavlefshmërinë e policisë.

Megjithatë, ata nuk kishin marrë mësim!  
Megjithatë, ata nuk kishin ardhur në vete!

Më pas kundër tyre All-llahu dërgoi ushtri tjetër, e ato ishin rriqrat. E rriqrat kishin ngadhënjyer kundër tyre, All-llahu na ruajtë!

Rriqra në shtrat, rriqra në rroba, e rriqra në kokë, dhe rriqra në flokë.

Gjumi u kishte ikur, natën e kishin kaluar duke i mbytur dhe duke i mallkuar rriqrat, deri në mëngjes.

E si t'i luftonin ato, kur kundër rriqrave nuk vlejnë as shpatat e as shigjetat, në atë punë nuk kanë mundur t'u ndihmojnë as ushtria e tyre e as policia.

Pastaj, All-llahu dërgoi kundër tyre bretkosa, e në ushqim bretkosa, e në pije bretkosa, dhe nëpër rrobet e tyre bretkosa.

Ishin bezdisur nga bretkosat, u ishte nxirë jeta. Ishin përhapur dhe ishin shtrirë bretkosat në të gjitha anët e shtëpisë. Njëra kuak, kjo kërcen e tjetra hidhet.

Një e mbysnin, dhjetë të tjera vinin, një e nxirrnin jashtë, pesë shfaqeshin, po sikur të shumoheshin në shtëpi.

Rojtarët dhe policia u treguan të paaftë para bretkosave.

E All-llahu kundër tyre e kishte dërguar faktin e pestë, e ai ishte gjaku.

Nga hundët e tyre nisi të rridhte gjaku pandërprerë, u dobësuan dhe u lodhën pa masë.

Mjekët nuk patën mundësi të gjenin

ndonjë bar, dhe mjekimi nuk u bënte dobi.

Dhe sa shihnin shenjën, Musait i thoshin:

- Lutju Zotit tënd për ne, të na e largojë fatkeqësinë, e ne do të pendohemi, do të besojmë dhe do t'i përcjellim me ty Beni Izrailët.

E kur All-llahu e largoi fatkeqësinë prej tyre, e kishin shkelur fjalën e dhënë.

*“Atëherë (për shkak të mohimit) Ne lëshuam kundër tyre: vërshimin, karkalecat, rriqrat, bretkosat dhe gjakun, fakte të qarta njëra pas tjetrës, po ata qëndronin me kokëfortësi sepse ishin popull mëkatar”.*

## 7 TË DALET (IKJA)

Për Beni Izrailët u ngushtua toka e Egjiptit, edhe pse ishte e gjerë.

Çfarë të bënin në Egjiptin pjellor dhe me të mirat e tij, kur ishin në burg, përjetonin për çdo ditë lloj-lloj vuajtjesh dhe

përbuzjesh?!

Deri kur do të duronin, a nuk ishin pasardhësit e Ademit, të cilët e ndiejnë shqetësimin dhe dhembjen?

Dhe All-llahu e frymëzoi Musanë për të dalë me Beni Izrailët nga Egjipti, dhe të udhëtonte me ta.

Këtë gjë e kishin hetuar policët e faraonit, meqë ata kanë sy korbi dhe nuhatje të buburrecit, dhe e kishin informuar faraonin.

Musai me Beni Izrailët udhëtoi gjatë natës për në vendin e Shenjtë, e ata ishin dymbëdhjetë fise, e secili fis kishte udhëheqësin e vet.

Rruga për në Sham (Palestinë, Jordan dhe Siri) ishte e njohur dhe e qartë, shkohej nëpër tokë, e Musai e kishte kaluar atë rrugë dy herë.

Kështu që Musai dëshironte diçka, por All-llahu dëshiroi diçka tjetër, dhe u bë ajo që ka dëshiruar All-llahu.

Musai e kishte gabuar rrugën, e duke gabuar Musai, ishte plotësuar caktimi

(kaderi i All-llahut).

Musai kishte menduar se me Beni Izrailët ishte duke udhëtuar drejt veriut. Mirëpo, në errësirën e natës, ata kishin marrë rrugën drejt lindjes.

Kur ja, erdhën para Detit të Kuq, valët e të cilit përplaseshin në breg.

- O Ti që na ruan! O Ti që na fsheh!  
Ku jemi ne?

Përgjigjja ishte: “Para detit!”

U kthyen prapa, kur ja, u ngrit një mjegull pluhuri! Ishte një ushtri e madhe, e cila e kishte mbuluar horizontin.

Me atë rast u ngritën zërat:

- O biri i Imranit! Çfarë të keqe ke parë prej nesh, që mendove mbytjen tonë!  
Erdhe me ne në buzë të detit për të na mbytur faraoni, siç bëhet mbytja në fu-  
rrë, ashtu që nuk ka as ikje e as shpëtim.

Nuk na kujtohet se të kemi bërë ndonjë të keqe, e përse kjo hakmarrje?! A nuk të mjaftoi i gjithë ai mundim dhe ajo fatke-  
qësi që na gjeti për shkak tëndin, e na  
solle këtu?! Para nesh është deti, pas

nesh është armiku, për ne nuk mbetet  
gjë tjetër pos vdekës!

Ndërkaq u errësua bota në sytë e Beni  
Izrailëve, e humbën shikimin, i mposhti  
dëshprimi dhe iu ndalën zërat. Gjithkush  
u trondit, edhe kodrave të patundshme u  
takonte të tronditeshin.

Por bindja e Musait në Zotin e tij nuk  
luhatej, e njerëzit dëgjuan një zë i cili  
përçonte madhërin e peygamberisë:

*“Kurrsesi, me mua është Zoti im, Ai do të më  
udhëzojë!”*

All-llahu e urdhëroi Musanë që me  
shkopin e tij t'i mëshonte detit.

I ra detit dhe u nda, uji u ngrit anëve si  
kodër.

Dhe ja dymbëdhjetë rrugë, për dym-  
bëdhjetë fise, për çdo fis rrugë e veçantë.

Populli udhëtoi i sigurt, dhe e arriti të  
mirën e sigurisë e të shpëtimit.

## 8 PËRMBYTJA E FARAONIT

Faraoni e pa se si Beni Izrailët udhëtuan dhe e kaluan detin të sigurtë. Dhe ushtrisë së vet i tha:

- Shikoni detin se si u nda duke iu bindur urdhrit tim, që t'i zë këta që ikin!

Faraoni u nis përpara me ushtrinë e tij, e Beni Izrailëve u shkoi piskëllimi për së dyti herë:

- Qe ky armiku, qe ky mizori, kërkon ta kalojë rrugën për te ne. Nuk e pengon gjë drejt nesh, do të na zërë e do të na marrë për në Egjipt si peng dhe të për-buzur, ose do të na shfarosë në këtë shkretëtim të huaj.

Musai deshi që me shkopin e tij t'i binte tokës, e të kthehej ashtu siç kishte qenë, mirëpo All-llahu e frymëzoi: Lëre detin të qetë “... se ata janë ushtri që do të përmbytet”.

E kur faraoni me ushtrinë e tij arriti në mes të detit (e aty ishte tokë), ai u mbyll mbi ta. E kur faraoni e pa të vërtetën,

atëherë u kthjellua:

*“...derisa e përfshiu përmbytja, e ai tha:  
Besova se nuk ka Zot tjetër pos atij që i besuan  
Beni Izrailët, edhe unë jam nga myslimanët!”*

Mirëpo kishte qenë vonë. “Nuk është  
(i pranueshëm) pendimi i atyre që  
vazhdimisht bëjnë punë të këqija dhe vetëm  
atëherë kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të  
thotë: ‘Unë tash u pendova!’”

*“... (në) ditën kur vijnë disa shenja të Zotit  
tënd, asnjë njeriu nuk i vlen besimi i tij, nëse  
nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë në bes-  
imin e tij kurrfarë të mire...”*

Po ashtu, atij i është thënë: “Ti tani  
beson, ndërsa më parë kundërshtove dhe ishe  
njëri prej shkatërruesve!”

Faraoni vdiq në det i mbytur.

Kishte vdekur dhunëbërësi, i cili kishte  
mbytur me mijëra fëmijë e burra duke i  
prerë dhe ngulfatur.

Kishte vdekur tirani, i cili kishte mbytur  
mijëra e mijëra, në mënyrë të dhunshme  
dhe duke i varur.

Kishte vdekur mbreti i Egjiptit larg

fronit të tij, larg pallatit të tij, larg pushtetit të tij, nuk kishte mjek për ta shëruar, as shok për ta qetësuar, e as sy për ta qarë.

Beni Izrailët dyshonin për vdekën e faraonit, ata thoshnin se faraoni nuk vdes.

- A nuk e kemi parë se me ditë të tëra, as hante e as pinte?!

E deti e nxori trupin e tij, dhe u bindën për vdekjen e tij.

All-llahu i Lartmadhëruar i tha faraonit: *“Sot po të shpëtojmë ty (po të nxjerrim prej detit) me trupin tënd (të vdekur), që të shërbesh si argument për ata që vijnë pas teje...”*

E mërcina e faraonit ishte fakt për ata që e panë, dhe mësim për mësim-marrësit.

Ushtria e faraonit u mbyt deri te i fundit, dhe asnjë nuk shpëtoi prej tyre.

Egjiptin e kishin lënë pas vetes, e në atë tokë të gjerë nuk kishin gjetur një bërryl toke për varrosje.

*“Sa kopshte e kroje kanë lënë! Edhe ara të mbjella e vende të bukura. Dhe sa të mira që i*

*kanë gëzuar. Ja, ashtu ato ua lëmë në trashëgim një populli tjetër. Për ata nuk qanë as qielli e as toka dhe atyre nuk iu dha afat’.*

## **9** NË SHKRETËTIRË

Beni Izrailët arritën në tokën e sigurisë dhe shpëtimit dhe në ajrin e saj morën frymë si të lirë dhe të ndershëm.

Këtu nuk i frikësohen faraonit, nuk i frikësohen Hamanit, as i frikësohen policisë së tij.

Aty ecin të sigurtë, të qetë dhe nuk i frikësohen askujt pos All-llahut.

Mirëpo, ata ishin banorë që kishin jetuar në qytet, e dielli në shkretëtirë i mundonte.

Ata ishin mysafirë të All-llahut!

A nuk i ke parë mbretërit se si i nderojnë mysafirët e tyre?!

Se si përgatisin për ta tenda për t’i mbrojtur nga vapa e diellit?!

E nderimi i All-llahut është mbi çdo

nderim (mirëpritje)!

E All-llahu i urdhëroi retë që t'u bënë hije, e ata ecnin nën hije të mjegullave, e mjegullat udhëtonin me ta ashtu siç udhëtonin ata, dhe ndaleshin kudo që ndaleshin ata.

E Beni Izrailët i mori etja, ngaqë në shkretëtirë nuk ka ujë, as lumë, e as pus.

Shkuan te Musai t'i ankohen për etjen, ashtu si fëmija që i ankohet nënës së vet dhe kërkon ndihmën e saj.

Musai iu lut zotit të tij! E kë ka Musai pos Tij?!

E (All-llahu) tha: “...*Bjери gurit me shkopin tënd...*”

“... *atëherë nga ai gufuan dymbëdhjetë kroje, që secili grup ta dinte vendin ku do të pinte ujë...*”

Beni Izrailët i kishte marrë uria dhe iu ankuan Musait ashtu si fëmija që i ankohet nënës së vet dhe kërkon ndihmën e saj.

Dhe i thanë:

- Ti na nxore prej Egjiptit, vend i

pemëve dhe prodhimeve, vendi i të mirave dhe të këndshmeve, e kush do të na japë ushqim në këtë shkretëtirë?

Musai iu lut Zotit të tij! E kë ka ai pos Tij?! E u zbriti atyre ushqim.

Ua zbriti atyre mbi gjethet e drurëve në përbërje të ëmbëlsirës, dërgoi tek ata shpendë të cilët i zinin nëpër drurë me lehtësi.

Ajo ishte rrëshirë e mirë dhe ishin shkurtëza, gosti e All-llahut për Beni Izrailët në shkretëtirë.

## 10 MOSMIRËNJOHJA E BENI IZRAILËVE

Mirëpo, periudha e gjatë e robërisë ua kishte prishur Beni Izrailëve shijen dhe moralin.

Nuk mundeshin të vendosnin për diçka, me asgjë nuk qetësoheshin, dhe kishin veti si të fëmijëve.

Shumë pak mirënjohës ishin, shumë

ankoheshin, shpejt bezdiseshin, dhe e dëshironin atë që u pengohej dhe urrenin atë që u jepej.

Nuk zgjaste shumë e i thoshin Musait:

- Na u ka mërzitur ky ushqim i vetëm, jemi bezdisur prej këtij mishi dhe prej kësaj ëmbëlsire. Na ka marrë malli për perime dhe barishte.

*“O Musa, ne nuk mund të durojmë vetëm një ushqim (të njëjtë), lute pra Zotin tënd të na dërgojë çka rrit toka prej perimeve të saj, prej trangujve, prej hudhrave, prej thjerëzave dhe prej qepëve të saj!...”*

Musai u çudit nga ajo kërkesë e pazakonshme, dhe me një zë i cili tregonte mohim, habi dhe qortim, u tha:

*“... A kërkoni ta ndërroni të mirën me atë që është më e thjeshtë?...”*

- A barishte dhe perime, në vend të shpendëve dhe ëmbëlsirave, që nuk i ka prekur dora e njeriut?! A ushqim të bujqve, në vend të ushqimit të mbretërve?

Oh, sa shije e prishur! Oh, sa përzgjed-

hje e keqe!

Mirëpo, Beni Izrailët nuk hiqnin dorë nga kërkesa e tyre, nuk pushonin nga kërkesa për perime dhe barishte.

Dhe Musai tha:

- Atë që kërkonti ju gjendet në çdo fshat dhe qytet.

*“... Zdirgjuni pra në qytet, se aty do të keni atë që kërkonti!...”*

## KOKËFORTËSIA E BENI IZRAILËVE

Beni Izrailët kishin natyrë fëmijësh, si fëmijët me teka.

Për çkado që të urdhëroheshin, kundërshtonin për diç të kundërt dhe talleshin me të.

Ata mendonin se e kishin për detyrim të bënin ndryshe nga ajo që u thuhej.

Si fëmija me teka, nëse i thuhet ‘ngrihu’, ai ulet, nëse i thuhet ‘ulu’ ai ngrihet. Nëse i thuhet ‘hesht’, ai flet, e nëse i

thuhet 'fol', ai hesht.

Ata ishin me teka si fëmijët, kishin sjellje të pamoralshme, talleshin me armiqësi dhe ishin nënçmues çmendës.

Dëshironin të banonin në fshat, të hanin ushqimin për të cilin kishin oreks, si perimet dhe barishtet.

Mirëpo, kur u ishte thënë: “... *Hyni në këtë vendbanim dhe hani lirisht ku të dëshironi, e hyni në derën (e fshatit) të përulur dhe thoni: “Hittatun” – ndjesë, Ne ua falim mëkatet, e bamirësve ua shtojmë shpërblimin*”.

U hidhëruan për këtë urdhër të Zotit, dhe hynë në fshat nga zori, duke u tallur dhe duke u zhagitur bythazi.

*“E ata që ishin mizorë, atë që u ishte thënë e ndryshuan me një fjalë tjetër...”*

E All-llahu u zbriti fatkeqësi, u dërgoi atyre murtajën nga e cila u shfarosën si minjtë.

E kur urdhëroheshin për ndonjë çështje, pyesnin shumë dhe grindeshin.

Si puna e njeriut që kur nuk do të punojë, pyet shumë dhe grindet.

Në mesin e Beni Izrailëve kishte ndodhur një vrasje, e Beni Izrailët ishin shqetësuar për të.

Mirëpo, nuk i binin dot në gjurmë dorasit, e çështja e vrasjes ishte biseda kryesore në mesin e njerëzve.

Kishin ardhur te Musai (paqa dhe shpëtimi qofshin mbi të) dhe i kishin thënë:

- O peygamber i All-llahut, na ndihmo në këtë rast dhe lutju All-llahut të na tregojë për dorasin.

## 12 LOPA

Musai iu lut Zotit të tij, e Ai e frymëzoi që t'i urdhëronte ata për therjen e një lope.

Mirëpo atëherë lindi ngatërresa, Beni Izrailët filluan të pyesnin dhe të zgërdheshin.

*“(përkujtoni) Edhe kur Musai popullit të vet i tha: “Allahu ju urdhëron ta therni një lopë!...”*

*“... Ata thanë: ‘A po talleh me ne?’”*

*“... Ai tha: ‘Allahut i mbështetem të më ruajë e të mos bëhem nga të paditurit!’”*

Edhe nuk reshtnin pyetjet.

*“Ata thanë: ‘Lute Zotin tënd për ne, të na sqarojë çfarë është ajo?’”*

*“... Ai tha: ‘Ai thotë se ajo është një lopë as e vjetër, as e re (mëshqerrë), është e mesme, zbatoni pra atë që urdhërohet!’”*

Pa mbaruar me këtë pyetje, kishin filluar të pyesnin për ngjyrën e saj.

*“Ata thanë: ‘Lute Zotin tënd për ne, që të na sqarojë çfarë ngjyre ka?...’”*

*“... Ai tha: ‘Ai thotë se është një lopë e verdhë, ngjyra e saj është e fortë që i kënaq shikuesit.’”*

Nuk kishin mund të gjenin pyetje tjetër, e megjithatë, e kishin lëshuar një pyetje.

*“Ata thanë: ‘Lute Zotin tënd për ne, që të na sqarojë si është ajo, se na janë përzier lopët e ne do të gjejmë të vërtetën, në dashtë Allahu!’”*

*“Ai tha: ‘Ai thotë se ajo nuk është lopë e lodhur duke lëruar tokën, as duke ujitur bimët, ajo është pa të meta dhe nuk ka shenjë (ngjyrë tjetër)!’”*

E kësaj radhe u ndalën, meqë kishin

thënë: “... e ne do ta gjejmë të vërtetën, në dashtë Allahui!” dhe e gjetën.

Mirëpo, pyetjet e tyre të shumta ua vështirësuan punën, se do të mjaftonte, po ta kishin therur një lopë çfarëdo, mirëpo ata e vështirësuan punën, e edhe All-llahu ua vështirësoi.

Dhe hulumtuan për lopën e mesme, e të verdhë, e me ngjyrë të fortë, e që nuk kishte lëruar, e që nuk i kishte ujitur bimët, e pa të meta dhe që nuk kishte shenjë.

Gjetja e një lope të tillë të çuditshme kishte qenë punë e rrallë, pasi lopa është ose e vjetër ose mëshqerrë.

Ose e mesme, por jo e verdhë.

Ose lopa është e mesme dhe e verdhë, por jo me ngjyrë të fortë.

Lopa është ose e mesme, me ngjyrë të fortë të verdhë, por atëherë është lopë e lodhur duke lëruar tokën.

Ose është lopë e mesme me ngjyrë të fortë të verdhë që nuk lëron tokën, por ujit bimët.

E hulumtuan sa e hulumtuan dhe e kuptuan se nuk e dinin fundin e asaj ngatërrese, çfarë ishte ajo? Çfarë ngjyre kishte? Çfarë ishte ajo?

Dhe u lodhën.

All-llahu ia deshi të mirën një bonjaku, te ai e gjetën atë lopë si e përshkroi (cilësoi) All-llahu dhe e blenë me një çmim shumë të lartë. “...*dhe e therën atë, po për pak e lanë pa e kryer punën.*”

E All-llahu urdhëroi që të mbyturit t'i mëshohej me një copë nga pjesët e lopës, u ngjall i mbyturi dhe tregoi për emrin e dorasit.

Dhe kështu kishte qenë...

## 13 LIGJI I ZOTIT (SHERIATI)

Beni Izrailët shpëtuan nga jeta shtazarake dhe filluan të bënin jetë njerëzore.

Filluan të jetonin në shkretëtirë si të lirë dhe me dinjitet.

Tani kishin nevojë për një Ligj të Zotit,

që do të gjykonte mes tyre dhe t'ua ndriçonte rrugën.

Sepse njeriu nuk mund të jetojë si njeri, pos me Ligj të Zotit, apo me Dritën nga Zoti i tij.

Bota në tërësi është errësirë, pos atje ku rrezaton drita nga Zoti i tij.

E ajo dritë, është dritë e pejgamberëve, me të cilën u tregojnë udhën njerëzve.

E kush nuk e gjen udhën me këtë dritë është në humbje, dhe bredh poshtë e lart si deveja e verbër.

Besimi (imani) pa këtë dritë, është mashtrim dhe përrallë me të cilën qeshin fëmijët.

A keni dëgjuar për besimet e idhujtarëve, të pabesimtarëve, të çifutëve, të të krishterëve, për dokrrat dhe rrëfimet e tyre?!

Edhe dituria që kanë është padituri, hamendje, parashikim dhe dyshim.

*“Shumica e tyre nuk kërkojnë tjetër pos hamendje, e hamendja nuk është asgjë ndaj së vërtetës...”*

Ka edhe moral të pamatur, të mangët dhe të tepruar.

A e keni parë se si i shkelin të drejtat ata, të cilët nuk i pasojnë pejgamberët, si i kalojnë kufijtë dhe si i pasojnë kajzat?!

Udhëheqja dhe politika e tyre është mizore, fatkeqe dhe prekje në pasurinë e njerëzve, në të drejtat e tyre dhe në gjakun (jetën) e tyre.

A nuk e keni parë parinë, ata që nuk i frikësohen All-llahut dhe nuk e pasojnë Sheriatin, se si tradhtojnë atë që u besohet, se si luajnë me pasurinë e All-llahut, dhe si luajnë me gjakun e njerëzve dhe të drejtat e tyre?!

Se si robërojnë njerëzit, si i quajnë të huaj, si i mbytin burrat e i lënë gratë e tyre të gjalla, a e di se sa u vranë në Luftën e Parë Botërore dhe në Luftën e Dytë Botërore?!

Mbarë bota është krejt në errësi, pos atij që e rrezaton drita e Zotit të tij.

*“... pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit*

*Allahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.”*

E Pejgamberi njerëzit i mëson se si ta adhurojnë All-llahun, e po ashtu i mëson se si të sillen mes veti.

Pejgamberi i mëson njerëzit për edukatën e bashkë me edukatën fetare, u mëson njerëzve si të hanë, si të pinë, të flenë, ndejën e sjelljen dhe çdo edukatë tjetër.

U mëson edukatën sikurse prindi i mëshirshëm që ua mëson fëmijëve të mitur.

E njerëzit janë si fëmijët e vegjël, kanë nevojë për më të vjetrit e tyre për të marrë edukatën e pejgamberëve, më shumë sesa kanë nevojë në vegjëli të tyre për edukatën e prindërve të tyre.

Ata që nuk e njohin dhe nuk e mësojnë edukatën e pejgamberëve, janë si drurët e shkretëtirës, të cilët vetëm mbijnë dhe rriten të shtrembër e me ferra.

## 14 TEVRATI (DHIATA E VJETËR)

All-llahu deshi që Beni Izrailët mos të bridhnin andej e këndeje, siç kishin bredhur popujt e tjerë pa libër qiellor dhe pa udhëzim nga All-llahu.

All-llahu deshi që mos të bridhnin ashtu siç kishin bredhur popujt e tjerë posi deveja e verbër.

All-llahu e urdhëroi Musanë të pastrohej dhe të agjëronte tridhjetë ditë, pastaj të shkonte në Turi Sina (mali Sinai, A.A.) për të biseduar Zoti me të, dhe të pranonte librin për ta pasur udhërrëfyes për ta.

Musai nga populli i tij i zgjodhi shtatëdhjetë burra për të qenë me atë rast dëshmitarë, meqë Beni Izrailët ishin popull kundërshtar dhe mohues.

“... Ndërsa Musai vëllait të vet, Harunit, i tha: *Më zëvendëso mua te populli im dhe mbaj rregull e mos shko rrugës së të këqijve*”. Sepse bashkësia patjetër duhet të ketë prijës.

Musai mori rrugën për t'u takuar me

Zotin e tij, mirëpo e nxiste dëshira për te  
Zoti i tij, nxitoi dhe arriti para kohe te  
kodra Tur.

All-llahu xh.sh. i tha: *“Po ty, o Musa, ç’të  
nguti para popullit tënd?”*

*“Ai u përgjigj: ‘Ja, ata janë pranë meje, e unë  
u nguta te Ti, o Zoti im, që të jesh i kënaqur  
ndaj meje!’”*

All-llahu e urdhëroi ta plotësonte  
takimin me Zotin e tij dyzet net.

Musai arriti në kodrën Sinai, e Zoti i tij  
bisedoi me të, e këshilloi dhe e afroi, e  
kjo ia shtoi dëshirën, dhe tha: *“...Zoti im!  
Më mundëso pamjen tënde ta shikoj!”*

E All-llahu e di se Musai nuk mund ta  
përballonte atë, meqë All-llahu: *“Të parët  
(e njerëzve) nuk mund ta përfshijë Atë, e Ai  
e përfshin të parët. Ai është shumë i  
kujdesshëm, hollësisht i njohur.”*

Edhe malet nuk mund ta mbajnë fjalën  
e tij, nga epërsia e dritës.

*“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur’an mbi  
ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të  
çarë prej frikës nga Allahu...”*

*“...Ai (Zoti) i tha: ‘Ti nuk ke mundësi të më shobësh, por shiko kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të më shobësh Mua...’”*

*“...Kur u drejtua kah kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri atë (Kodrën) thërrmijë, e Musait i ra të fikët...”*

*“... Kur erdhi në vete, tha: ‘E lartë është madhëria Jote, pendohem para Teje (për atë që kërkova), dhe unë jam i pari besimtarëve.’”*

*“Ai (Allahu) tha: ‘O Musa, Unë të ngrita ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit Tim. Merr atë që të dhashë dhe bëhu mirënjohës.’”*

Musai i mori pllakat, e në to kishte çdo çështje që u nevojitej Beni Izrailëve, këshilla dhe sqarime për çdo send.

All-llahu e urdhëroi t’i merrte ato me forcë e kujdes, dhe ta urdhëronte popullin e tij që t’i merrnin gjithato gjërat më të mira.

E kur Musai arriti te shtatëdhjetë burrat nga populli i tij, dhe u njoftoi për dhuntinë që i kishte dhënë All-llahu, ata

të pafytyrë dhe me vrazhdësi thanë:

*“...ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim Allahun haptazi...”*

All-llahu u hidhërua për atë paturpësi dhe guxim, andaj i përfshiu rrufeja me krismë, e ata po shihnin.

Ata e kuptuan se nuk mundeshin ta duronin atë rrufe të krijuar nga All-llahu, e si do ta duronin dritën e All-llahut!

E Musai iu lut Zoti të tij, dhe tha:

*“...Zoti im!, sikur të kishe dashur Ti, i kishe zhdukur më parë ata dhe mua. A po na zhduk për atë që bënë të marrët nga ne?...”*

All-llahu iu përgjigj lutjes së tij, i ringjalli pas vdekjes së tyre, e ndoshta do të ishin mirënjohës.

## 15 VIÇI

Beni Izrailët në Egjipt me shekuj kishin bashkëjetuar me idhujtarët.

Kibtët në Egjipt kishin adhuruar shumë sende, e Beni Izrailët atë e kishin parë me sytë e tyre.

Ndër ta ishte ngjallur urrejtja ndaj idhujtarisë (shirkut), por i kishte përshkuar dëshira ndaj Tij, siç e përshkon uji ndonjë shtëpi të vjetër dhe të dobët.

E sa herë që u jepej rasti, rrëshqitnin në idhujtari ashtu siç rrëshqet uji shpatit.

Zemrat e tyre kishin dalë nga udha dhe ndjenja e tyre ishte prishur; po ta shihnin rrugën e shpëtimit nuk e merrnin për rrugë, e nëse shihnin rrugën e gabuar, e merrnin për të drejtë.

E kishin kaluar detin, “...*Beni Izrailët i kaluam përtej detit, e ata u takuan me një popull që adhuronte do statuja të tyre, dhe thanë: ‘O Musa, na e bëj edhe neve një zot (statujë) si zotat që i kanë ata.’*”

Musai ishte hidhëruar dhe kishte thënë: “... *Ju jeni popull që nuk dini?*”

- Sa çudi është kjo! Sa e padrejtë është kjo! All-llahu ju dha dhunti dhe ju vlerësoi, e ju dha atë që nuk u dha njerëzve tjerë. “... *Mos deshët që, pos Allahut, të kërkoj për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?*”

Musai shkoi për në kodrën Sinai dhe humbi disa ditë prej tyre, e ata ishin bërë pre e shejtanit dhe flijim i idhujtarisë.

Ishte ngritur një mashkull prej tyre me emrin Samiriu, *“E ai (Samiriu) ua bëri një viç me trup që pëlliste, e ata thanë: ‘Ky është zoti juaj dhe Zoti i Musait, po ai (Musai) ka barruar.’”*

Beni Izrailët u gabuan me atë viç, dhe iu përkulën atij si të shurdhër e të verbër.

*“A nuk e kuptonin ata se ai (viç) as nuk u përgjigjej atyre, e as nuk kishte mundësi t’u sillte ndonjë dobi a dëm?”*.

*“... A nuk e shihnin ata se ai nuk u fliste as nuk u tregonte ndonjë rrugë të drejtë...”*

Haruni kishte bërë përpjekje për t’i larguar nga kjo, dhe u kishte thënë:

*“...O populli im, ju vetëm u sprovuat me të, pse Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi, andaj ejani pas meje dhe më dëgjoni për këtë që po jua them”*.

Mirëpo, Beni Izrailët ishin joshur me magjinë e Samiriut, e adhurimi ndaj viçit ishte përzier me gjak në zemrat e tyre,

dhe i kishin thënë: “*Ne nuk do t’i ndabemi këtij (adhurimit të viçit) deri të kthehet te ne Musai!*”

## **K**NDËSHKIMI

E kur All-llahu e lajmëroi Musanë se Beni Izrailët i kishte futur në rrugë të gabuar Samiriu, u kthye te populli i tij i hidhëruar dhe i pikëlluar.

Ishte hidhëruar ndaj popullit të tij, por ishte hidhëruar për (riza) hir të All-llahut edhe ndaj vëllait të vet, Harunit.

“*Ai (Musai u kthye e) tha: ‘O Harun, ç’të pengoi ty kur i pe se morën rrugën e gabuar? E ti të mos e vazhdoje rrugën time?’*

*A mos e kundërshtove edhe ti porosinë time?* Haruni kërkoi falje dhe tha: “... *unë u frikësova se do të thojë: I përçave Beni Izrailët dhe nuk e ke respektuar porosinë time?’*

“...*Populli më mundi dhe gati më mbyti...*”  
(Musai) *Tha: Zoti im, më fal mua dhe e fal vëllain tim dhe na dhuro mëshirën Tënde, se Ti*

*je mëshirues i mëshiruesvë”.*

Më pas, Musai iu drejtua Samiriut dhe e pyeti: “...*E çka ishte puna jote, o Samiri?”*

Samiriu e kuptoi gabimin e vet dhe u përgjigj: “...*kështu më mashtroi vetvetja”.*

“*Ai (Musai) tha: Prandaj, largohu sepse sa të jesh gjallë ke për të thënë: (këdo që e sheh) ‘Mos m’u afro!’”*

E Musai e dënoi atë me vetmi, të ecte vetëm dhe të jetonte si egërsirë, as ai nuk shoqëron dikë, e as dikush nuk e shoqëron atë.

E ku ka dënim më të madh se ky?

Kështu që ai, i cili mijëra njerëz i fëlliqi me idhujtari, duhet të quhet i fëlliqur dhe të mos i afrohet kush.

Ai që bën ndarje mes All-llahut dhe robërve të Tij duhet bërë ndarje mes Tij dhe njerëzve.

Ai i cili mbi tokën e All-llahut thërret në idhujtari është mëkatar, andaj duhet që për të mbarë toka të jetë burg.

Pastaj Musai u kthye drejt vëçit të mallkuar, urdhëroi të digjej dhe u dogj,

pastaj e flaku në det.

Beni Izrailët vështronin se ç'po ndodhte me viçin e adhuruar, dhe e panë dobësinë e paaftësinë e tij.

Më pas Musai iu drejtua Beni Izrailëve dhe u tha:

*“...O populli im, me adhurimin e viçit (në vend të Zotit), ju i bëtë zullum vetvetes, pra pendohuni para Krijuesit tuaj, dhe mbytoni ndër vete. Kjo për ju është më së miri te Krijuesi juaj...”*

Ashtu edhe vepruan, ata që nuk e kishin adhuruar viçin i mbytën ata që e kishin adhuruar atë, dhe në atë mënyrë All-llahu ua kishte pranuar pendimin.

All-llahu i Lartmadhëruar thotë:

*“Nuk ka dyshim se ata që adhuruan viçin ka për t'i përfshirë përbuzja nga Zoti i tyre dhe nënçmimi në jetën e dynjasë.*

*Kështu i shpërblejmë (me dënim) trilluesit e rrenës.”*

Të tillë janë adhuruesit e viçit deri në ditën e gjykimit, të tillë janë idhujtarët deri në ditën e gjykimit!

## 17 QYQARIA E BENI IZRAILËVE

Beni Izrailët e Egjiptit u rritën me adhurim, me nënçmim, në të pavlerë, ashtu u rritën fëmijët dhe ashtu u thinjosën të rinjtë.

Dhe në djersën e tyre u ftoh gjaku.

E kishin sjellë punën aty sa nuk ëndërronin për qeverisje e as nuk flisnin për ndonjë betejë e as për luftë.

Beni Izrailët i kalonin ditët në mërgim, nuk kishin shtet e as pushtet.

Musai dëshironte, e kjo vinte përmes shpalljes së All-llahut, që ata të hynin në Tokën e Shenjtë dhe të banonin aty si sundimtarë dhe të lirë.

Megjithatë, Musai e dinte natyrën qyqare dhe të dobët të Beni Izrailëve.

Ai deshi t'i nxiste dhe t'ua bënte me dije përbuzjen, meqë Vendin e Shenjtë e qeveriste një popull dhunëbërës dhe shumë i ndërkryer.

Dhe nuk mund të hynin Beni Izrailët në

Vendin e Shenjtë derisa të mos dilnin prej andej ata dhunëbërës.

Ua përkujtoi dhuntitë që u dha All-llahu dhe se i ngriti mbi njerëzit e tjerë, që të niseshin për luftë në rrugën e All-llahut dhe ta urrenin atë jetë të përbuzur e të padenjë.

*“Përkujto (o i dërguar) kur Musai i tha popullit të vet: “O popull im, përkujtoni dhuratën e Allahut ndaj jush, kur në mesin tuaj dërgoi peygamberë, ju mundësoi të jeni sundues dhe ju dha çka nuk i dha askujt nga popujt”.*

*Në vazhdim u tha: “Para jush është Toka e Shenjtë, e nuk u mbetet tjetër pos të ngrihenit dhe ta merrni atë nga armiqtë tuaj. Sepse kur dikujt All-llahu i cakton diçka, është e lehtë për ta marrë dhe nuk ka kundërshtim në përmbushjen e fjalës së All-llahut.*

*O populli im, hyni në Tokën e Shenjtë, të cilën ua premtoi Allahu...”*

U frikësua se mos i mposhtte natyra e qyqarisë, andaj edhe u tha:

*“...dhe mos u ktheni mbrapa, pse atëherë ktheheni të dëshpëruar”.*

Kishte ndodhur ajo për të cilën kishte pasur drojë Musai, e për gjithë atë që u kishte thënë Musai, përgjigjja e tyre kishte qenë:

*“...O Musa, aty është një popull i fuqishëm (i dhunshëm), prandaj nuk do të hyjmë aty kurrë derisa ata të mos dalin prej andej (të na e lirojnë pa luftë), ...”*

E të qetë dhe me seriozitet, thanë:

*“...nëse dalin ata, do të hyjmë ne.”*

*“Dy burra, prej atyre (prijësve) që Allahu i kishte pajisur me bindje dhe kishin frikën e Tij, thanë: ‘Hyni nga dera, e kur t’u hyni nga ajo, atëherë ju jeni ngadhënjyes. Dhe vetëm Allabut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të singertë’”.*

Mirëpo kjo nuk kishte ndikuar mbi ta dhe kishin thënë:

- Nëse duhet hyrë patjetër, hyr ti përmes ndonjë mrekullie, e kur të dëgjojmë se ti ke hyrë, vijmë edhe ne dhe hyjmë në paqe e të sigurtë.

*“Ata thanë: ‘O Musa, kurrë nuk hyjmë derisa ata janë aty, shko pra ti dhe Zoti yt e*

*luftoni, ne po rrimë këtu!”*

Atëherë Musai u hidhërua dhe u dëshpërua me ta.

*“(Musai) tha: ‘Zoti im! Unë nuk kam në dorë pos vetes sime dhe as im vëlla nuk ka në dorë pos vetvetes, na ndaj, pra, ne prej popullit të fëlliqtë.’ ”*

*“(Allahu) Tha: ‘Ajo (tokë) është e ndaluar (haram) për ta dyzet vjet. Do të enden nëpër tokë (të hutuar). Ti mos u ligsho për popullin e shfrenuar.’ ”*

Gjatë asaj periudhe u shua brezi i rritur në Egjipt në robëri dhe përbuzja ishte fshirë.

E po rritej brezi tjetër po në atë bredhje, me vështirësi e mundime, e ky ishte populli i ardhshëm, e ky ishte përfundimi i çifutëve në çdo kohë, popull endacak që jeton në robëri dhe nënçmim.

# 18 RRUGËS NË KËRKIM TË DITURISË

Trasmetohet që Muhammedi a.s. të ketë thënë: “Një herë Musai ishte ngritur dhe u ishte drejtuar Beni Izrailëve, e ata e pyetën:

- Kush është më i dituri prej njerëzve?”

Ai ishte përgjigjur:

- Unë jam më i dituri!

E për këtë All-llahu e qortoi, meqë diturinë nuk ia caktoi Atij!

All-llahu i shpalli atij: Është një rob i Tij, i cili gjendet aty ku takohen dy detrat, e ai është më i ditur se ti.

Musai pyeti:

- O Zoti im, si të takohem me të?

Atij i është thënë: Merre një peshk në valixhe, e kur ta humbësh atë, ai është aty.

Musai e vuri peshkun në valixhe, u nis me një të ri që quhej Jush’a bin Nun, e kur arritën te një shkëmb, mbështetën kokat dhe fjetën.

Peshku ishte larguar nga valixhja dhe e kishte marrë rrugën e vet për në det, e kjo për Musanë dhe të riun që çudi e madhe. E kaluan pjesën e mbetur të ditës dhe natës, e kur u bë mëngjes, Musai i tha të riut:

- Na nxirr sillën tonë (ushqimin), meqë jemi lodhur nga ky udhëtim.

E Musai nuk kishte ndier lodhje derisa e kaluan vendin për të cilin ishte urdhëruar.

E i riu i kishte thënë:

*“A shëb!? Kur u strehuam te shkëmbi, unë e barrova peshkun”.*

Musai i tha: *“Ai është (vendi) që ne po e kërkojmë?”*

*“Dhe u kthyen që të dy rrugës së tyre prej nga kishin ardhur”.*

E kur arritën te shkëmbi, që një njeri i mbështjellë me një rrobë, e Musai i dha selam.

Hidri i tha:

- E si bëhet në vendin tënd paqe (përshëndetje me paqe)?

Musai iu përgjigj:

- Unë jam Musai!

Hidri tha:

- Musai i Beni Izrailëve?

Musai tha:

- Po! – Pastaj i bëri një kërkesë: “*A pranon të vij me ty, që të më mësosh nga ajo që e ke të dhuruar ti: dituri të drejtë e të vërtetë?*”

Hidri i tha: “... *Sigurisht, po ti nuk do të mund të kesh durim me mua!*”

- O Musa, unë kam një dituri nga dituria e All-llahut që ma ka mësuar atë që nuk e ke mësuar ti, po edhe ti ke një dituri, të cilën ta ka mësuar All-llahu e që unë nuk e kam mësuar!

Musai tha: “...*Në dashtë Allahu, do të shohësh se do të jem i durueshëm dhe nuk do të kundërshtoj për asgjë!*”

U nisën të ecnin buzë detit, por nuk kishin barkë, e atypari kaloi një barkë dhe u kishte thënë që të hipnin edhe këta.

Meqë e kishin njohur Hidrin, e kishin marrë në anije pa pagesë.

Kishte ardhur një shpend dhe ishte ndalur anës anijes, e sqeptoi një herë a dy prej detit.

Hidri tha:

- O Musa, dituria ime dhe jotja nuk i bën mangët diturisë së All-llahut, aq sa i bën mangët ky sqeptimi i shpendit detit.

Hidri qëllimish ia kishte hequr një dërrasë anijes.

E Musai i tha:

- Njerëzit na morën në anije pa pagesë e ti e dëmtove dhe e shkatërrove që t'i fundosësh udhëtarët e saj?

Hidri iu përgjigj:

*“... A nuk të thashë se nuk do të mund të kesh durim me mua?”*

Musai tha:

*“...Mos më qorto se harrova dhe mos më mundo me vështirësi në këtë shoqërim timin (lehtësoma punën)!”*

Kjo kishte qenë harresa e parë e Musait. Vazhduan rrugën, kur ja, një fëmijë duke lozur me të tjerë. Hidri e zuri dhe ia përdrodhi qafën.

Musai i tha:

*“...A e mbyte njeriun e pastër, pa vrarë ai askënd?!...”*

Hidri u përgjigj: *“...A nuk të thashë se vërtet ti nuk do të mund të kesh durim me mua?”*

*“Vazhduan të ecnin derisa arritën te banorët e një qyteti, të cilëve u kërkuan t’u jepnin ushqim, po ata nuk deshën t’i pranonin si mysafirë (e as t’i ushqenin) e ata të dy gjetën aty një mur që gati po rrëzohet...”*

Hidri e drejtoi me dorën e tij.

Musai i kishte thënë:

*“... Po të kishe dashur, do t’u merrje shpërblim për këtë.”*

I dijsmhi tha: *“...Tash është koha e ndarjes mes meje dhe teje!...”*

Muhamedi (paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të) ka thënë: **“All-llahu e mëshiroftë Musanë, do të kishim dëshirë të kishte bërë durim, e që neve të na rrëfehej rasti i atyre të dyve!”**

# 19 KOMENTIM

Pastaj Hidri i tregoi Musait.

Dhe i tha: *“Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e do të varfërve, që punojnë në anije, e unë desha ta dëmtoja, sepse para tyre ishte një sundimtar, që grabiste çdo anije.”*

*“Sa i përket djaloshit, dy prindërit e tij ishin besimtarë, e u frikësuan se ai do t’i shpinte të dy në humbje e në mosbesim”.*

*“Deshëm që Zoti i tyre t’u jepte në vend të tij një më të mirë se ai, dhe më të afërt në respekt dhe në mëshirë (ndaj prindërve).”*

*“Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmohave jetimë të atij qyteti, e nën të kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre kishte qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata të arrinin pjekurinë dhe ta nxirrnin vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre)...”.*

*“... Dhe unë nuk i bëra tërë ato sipas bindjes sime (po sipas udhëzimit të Zotit). Ky, pra, është sqarim i asaj për të cilën nuk munde të kishe durim!”*

Atëherë Musai e kuptoi se vetëm një

(njeri) nuk mund ta përfshijë diturinë e All-llahut, por diç nga dituria e Tij gjendet te dikush, e diç te dikush tjetër, dhe se ka dituri mbi dituri.

## 20 BENI IZRAILËT PAS MUSAIT

Musai ndërroi jetë e Beni Izrailët endeshin nëpër tokë, si dënim prej All-llahut e shpërblesë për veprat e tyre.

*“E All-llahu i rëndoi me përbuzje e skamje, e ata i sollën vetes hidhërimin e All-llahut”.*

Ata e hidhëruan All-llahun, i Cili prej mesit të tyre dërgoi peygamber, u mundësoi të ishin sundues dhe u dha çka nuk i dha askujt nga popujt në kohën e tyre.

I Cili i shpëtoi prej popullit të faraonit, nga kush kishin shijuar dënimin më të idhët, duke ua therur bijtë, e duke ua lënë gjallë gratë e tyre.

I Cili për ta e ndau detin, e i shpëtoi, ndërsa ithtarët e faraonit i fundosi, e ata

i shihnin.

I Cili bëri që retë t'u bënë hije, u dha të hanin rrëshirë (të ëmbël) dhe shkurtëza.

I Cili bëri që për ta të gufonin ujëra nga toka, dhe ua bëri me bollëk hajen e pijen.

E për gjithë ato mirënjohja ishte mohimi i dëshmimeve të All-llahut, të bërit mëkate dhe kalimi i kufijve.

E hidhëruan peygamberin e tyre, krijesën e All-llahut më të mëshirshëm ndaj tyre, dhe më i mëshirshmi ndaj tyre sesa prindërit e tyre.

Ai të cilit i dhimbseshin, si i dhimbset gjidhënëses foshnja e gjirit dhe nënës jetimi. Ai të cilin e fyenin, e ai lutej për ta, e sa herë zgërdhieheshin me të ai qante për ta, e sa herë ishin të vrazhdë ndaj tij, ai bënte gjëmën për ta.

Ai i cili i shpëtoi nga syrgjyni i faraonit, i nxori nga burgu i Egjiptit në tokën e lirisë e të nderit, dhe nga jeta e kobshme e robërisë në jetë të lirë dhe me autoritet.

E hidhëruan, e shqetësuan, u inatosën

me të, u tallën me të, e quajtën njeriun  
më të nënçmuar në mesin e tyre, e për  
All-llahun ai është i çmueshëm.

A nuk e kishin merituar atë dënim, turp,  
nënçmim, skamje dhe endjen e  
përgjithshme poshtë e lart, dhe mos të  
kishin kurrë shpëtim?

Po! Pa mëdyshje i meritonin të gjitha,  
por edhe më shumë, sipas veprave të  
tyre: “... *Po Neve ata nuk na bënë kurrfarë  
dëmi, ata dëmtuan vetveten.*”



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIRR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Rrëfimi mbi  
Shuaibin a.s.

8



## VËSHTRIM MBI RRËFIMET E KALLUARA

E lexuat rrëfimin mbi Pejgamberët tanë Ibrahimin, Jusufin, Nuhun, Hudin dhe Salihun. Po ashtu e lexuat rrëfimin mbi Pejgamberin tonë Musanë diç më gjerë e gjatë. Lexuat të tërë me gëzim e vullnet, me respekt e vlerësim, dhe rrëfimet e bukura e përshtypjelënëse kanë gjetur vend në shpirtitrat dhe zemrat tuaja. Me atë që keni përkujtuar e keni mbajtur mend, me to janë pushtuar gjuhët tuaja, e njerëzit ju kanë parë duke ua rrëfyer ato vëllezërve tuaj të vegjël, duke ua përsëritur prindërve dhe vëllezërve të mëdhenj, ju pëlqejnë ato e ndonjëherë edhe dalldiseni në rrëfimin e tyre.

## 2 RRËFIMI MBI LUFTËN MES SË VËRTETËS DHE TË PAVËRTETËS

Nuk është çudi, ngaqë këto janë rrëfime të mrekullueshme të cilat lënë gjurmë, këto janë rrëfime mbi luftën mes së vërtetës dhe të pavërtetës, mes diturisë dhe paditurisë e mes dritës dhe errësirës, mes njerëzisë dhe çnjerëzisë, mes vendosmërisë dhe bindjes, dhe mes mendimit e hamendjes.

Madje, këto janë rrëfime që e ndihmojnë të vërtetën kundër së pavërtetës, diturinë kundër paditurisë, të dobëtin kundër të fuqishmit dhe pakicën kundër shumicës. Janë rrëfime në të cilat ka dituri, urtësi, këshilla dhe përkujtime, e të vërtetën e ka thënë All-llahu i Madhëruar:

*“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësimë e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur’ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjtë) dhe sqarues i çdo*

*sendi, e edhe udhërrëfjes e mëshirë për një popull që beson”.*

Rrëfimi për Shuajbin alejhisselam

Atë që e thamë përmes rrëfimeve mbi pejgamberët nuk është gjithçka që e rrëfen All-llahu përmes Kur’anit, përpos këtyre rrëfimeve në Kur’an ka edhe rrëfime tjera.

## 3 E NË MEDJEN (DËR GUAM) VËLLANË E TYRE SHUAJBIN...

Në Kur’an është edhe rrëfimi i Pejgamberit të All-llahut, Shuajbit, të cilin e dërgoi All-llahu në Medjen dhe për banorët e Ejkës; ata ishin tregtarë, e gjendeshin në rrugën e tregtisë së madhe mes Jemenit e Shamit dhe mes Irakut e Egjiptit në Bregdetin e Kuq.

Ishin idhujtarë, siç ishin popujt e

pejgamberëve në çdo kohë, e përpos  
kësaj matnin e peshonin mangët, sul-  
monin karavanet, u bënëin kërcënime dhe  
i frikësonin, bënëin dëme e çrregullime në  
tokë, ashtu si dinë të bëjnë të pasurit dhe  
të fuqishmit, të cilët nuk e vrasin mend-  
jen për llogari dhe nuk i frikësohen  
dënimit.

All-llahu xh.sh. u dërgoi Shuajbin a.s. që  
t'i thërriste dhe t'u tërhiqte vërejtjen, e u  
thotë: *"...O populli im, adburoni Allahun, ju  
nuk keni Zot tjetër pos Tij, mos matni as mos  
peshoni mangët, unë po shoh se jeni në gjendje të  
mirë jetësore, pra po frikësohem për ju nga dëni-  
mi që do t'ju përfshijë një ditë! O populli im,  
veproni drejt gjatë matjes dhe peshimit, e mos  
dëmtoni njerëzit në asgjë dhe mos shkaktoni  
rrëmyje në tokë!"*

## 4 THIRRJA E SHUAJBIT A.S.

Ai u foli me thjeshtësi dhe konkretisht, e shqyrtoi dhe e zbërtheu ngatërresën që kishin në shpirtrat e tyre, e ai ishte kompleksi, të menduarit dhe lakmia për pasuri sa më të madhe. Ai u tha:

Vërtet e mira që ju mbetet nga fitimi pas matjes dhe peshimit të plotë, është më e mirë për ju sesa t'ua merrni njerëzve pasurinë me të padrejtë dhe mashtrim, e po që se shikoni jetën tuaj dhe të atyre që janë pasuruar e kanë grumbulluar pasuri, do të vëreni se ajo, të cilën e kanë fituar përmes matjes dhe peshimit të mangët, përmes mashtrimit e padrejtësisë, fundin e ka shkatërrim, humbje, çrregullim dhe fatkeqësi. Ashtu ajo pasuri ose vidhet, ose rrëmbehet, ose shpenzohet aty ku nuk është pëlqimi i All-llahut xh.sh. ose e qeveris ai, i cili do ta shkatërrojë dhe do të luajë me të. E pasuri e paktë e cila bën dobi është më e mirë sesa pasuria e shumtë e cila nuk

bën dobi: *“Thuaj: Nuk janë të njëjta e keqja dhe e mira, edhe nëse të mahnit ty shumimi i së keqes...”*

E këshilla ime për ju është e çiltër, e All-llahu Një është kujdestari juaj, i Cili përzemërsisht, me urtësi, me dituri e largpamësi thotë:

*“Ajo pjesë që ju lejoi Allahu është shumë më e mirë për ju, nëse jeni besimtarë, e unë nuk jam roja juaj!”*

## **S**BABA I MËSHIRSHËM DHE MËSUES I URTË

Kur u drejtohej atyre për t’ju ligjëruar, përdori metoda të ndryshme, përdori edhe artin e gojëtarisë gjatë këshillimit, siç di të bëjë babai i mëshirshëm dhe mësuesi i urtë, e u tha:

*“... O populli im, adhuroni Allahun (Një), ju nuk keni zot tjetër pos Tij. Juve ju erdhi mrekullia nga Zoti juaj. Bëjini drejt matjen dhe peshimin, e mos u bëni padrejtësi njerëzve në*

*sendet e tyre, dhe mos bëni çrregullime në tokë pas përmirësimit të saj. Këto janë më të dobishme për ju, nëse jeni besimtarë. Mos zini pusi në çdo rrugë e të kërcënoni dhe të pengoni nga rruga e Allahut atë që i ka besuar atij (Shujbit), e të kërkoni shtrembërimin e saj (e rru-gës). Përkujtoni kur ishit pakicë e Ai ju shu-moi dhe shikoni se si qe fundi i çrregulluesve”.*

## **PËR GJIGJJA E POPULLIT TË TIJ**

Më të “zgjuarit” prej tyre (prej popullit) e kishin rrahur dhe sqaruar shkakun e kësaj thirrjeje, kinse kishin zbuluar ndonjë fshehtësi, apo kishin zgjidhur ndonjë kashë e lashë, e me krenari dhe fodullëk kishin thënë:

*“Ata thanë: O Shuajb, a namazi yt po të thotë të na urdhërosh që ta braktisim atë që adhuruan prindërit tanë, ose (po të urdhëron) për të punuar në pasurinë tonë ashtu si të dëshirojmë? Vërtet, ti qenke i butë e i mençur. (Kjo ishte tallje e tyre).”*

## 7 SHUAJBI E SHPJEGON THIRRJEN E TIJ

Shuajbi u soll mirë me ta, nuk u tregua i ashpër e nuk u hidhërua, dhe ua bëri me dije se çfarë e ngarkoi me atë thirrje dhe këshillë pas një heshtjeje të gjatë, që të mos u kundërvihej, meqë kishin moral të prishur dhe sjellje të padurueshme, pos atëherë kur All-llahu e nderoi me pejgamberllëk e shpallje dhe pasi hapi gjoksin e tij e i dha dritë nga ana e Tij.

Atë nuk e nxiti zilia për të (për thirrjen), ngaqë All-llahu e kishte pasuruar dhe i kishte dhënë furnizim të lejuar (hallall), me të ai ishte i lumtur, shpirtmirë, i rregulluar e i pabrenga, falënderonte All-llahun xh.sh. me zemër dhe gjuhë.

Ndërkaq, nuk ua ndalonte diçka e ta bënte vetë, nuk i pengonte për diçka e vetë t'i afrohet asaj, nuk ishte prej atyre të cilët i urdhërojnë njerëzit për mirë e ndërkaq e harrojnë çfarë bëjnë vetë, e as prej atyre të cilët thonë diçka që nuk e

bëjnë; ai dëshironte vërtet të mirën e tyre, lumturinë e shpëtimitin e tyre nga dënimi i cili u sillej përreth kokave, e tërë e mira kthehet tek All-llahu i Lartmadhëruar dhe në Atë duhet mbështetur. Ai tha: *“O populli im, më thoni pra, nëse unë kam argumente të sigurta nga Zoti im dhe nga ana e Tij, Ai më furnizoi mua me të mira (si mund të mos ju udhëzoj në rrugë të drejtë?). Unë nuk dua t’ju kundërshtoj (duke punuar) për atë nga e cila po ju ndaloj, nuk dua tjetër veç të përmirësuj aq sa mundem, por këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm tek Ai jam i drejtuar!”*

## 8 NE NUK PO E KUPTOJMË SHUMICËN E ASAJ ÇKA THUA

Populli u shtir kinse nuk e kuptonte Shuajbin se çfarë dëshironte, thuaj se ai u fliste në gjuhë të huaj, edhe pse ishte

bir i atij vendi dhe vëlla i atij populli.

Gjithashtu, thua se ai ishte i paqartë dhe njohës jo i mirë i gjuhës letrare, edhe pse ai ishte më i shkëlqyeshmi ndër ta në të shprehurit, në paraqitjen e mendimit dhe në shpjegim. Mirëpo, ashtu flasin njerëzit kur u bëhet e tepërt këshilla dhe kur ia përtojnë punës.

## SHUAJBI ÇUDITET ME POPULLIN E TIJ

Ata kërkonin shkas në dobësinë dhe vetminë e tij, e po të mos ishte familja dhe të afërmit e tij, do ta gurëzonin që ta hiqnin qafe. Mirëpo Shuajbi e kishte të paqartë dhe habitej se si All-llahu i Cili është i Fuqishëm, i Gjithëfuqishëm, i Fortë dhe Mbizotërues, mund të jetë më i parëndësishëm në krahasim me familjen, e cila i nënshtrohet sëmundjes, shkatërrimit, dobësisë dhe pamundësisë.

*“Ata thanë: O Shuajb, ne nuk po e kuptojmë*

*shumicën e asaj që thua dhe të quajmë të dobët në mesin tonë, dhe sikur të mos ishte ai grupi yt, do të të gurëzonim, ngase nuk je i çmuar ndër ne. Ai tha: O populli im, a është më i çmuar te ju farefisi im se Allahu, që e keni hedhur pas shpine? Nuk ka dyshim, Zoti im i di të gjitha ato që veproni.”*

## 10 SHIGJETA E FUNDIT

E kur mbetën pa argumente, e hodhën shigjetën e fundit, të cilën mendjemëdhenjtë e çdo populli e hedhin kundër peygamberit të tyre dhe pasuesve të tij.

*“Paria, që ishte kryelartë nga populli i tij, tha: O Shuajb, ne do të të dëbojmë dhe së bashku me ty edhe ata që besuan nga fshati ynë, ose ndryshe patjetër të ktheheni në fenë tonë...”*

## 11 ARGUMENTI I PRERË

Përgjigjja e tij ishte si përgjigjja e krenarit me fenë e tij dhe si e një etuziasti për bindjen dhe ndërgjegjen e tij:

*“... Ai (Shuajbi) tha: A edhe nëse nuk e dëshirojmë atë (kthimin)? Ne do të shpifnim një gënjeshtër ndaj Allahut, nëse do të ketë beshim në fenë tuaj (idhujtare), pasi Allahu na shpëtoi prej saj. Nuk bën për ne të ketë beshim në të, veç nëse është dëshira e Allahut, e Zotit tonë. Zoti ynë ka përfshirë me diturinë e vet çdo send, ne i jemi mbështetur Allahut. Zoti ynë, mes nesh dhe mes popullit tonë vendos gjykimin Tënd të drejtë, se Ti je më i miri gjykatës”.*

## 12 PËRNDRYSHE ATA THANË ATË QË E PATËN THËNË PARA TYRE

Meqë nuk ia dolën, ata thanë ashtu siç patën thënë para tyre: *“Ata i thanë: ‘S’ka dyshim se ty të ka zënë magjia! Ti nuk je tjetër*

*gjë, pos njeri si edhe ne, dhe nuk të konsiderojmë tjetër veçse gënjeshtar! E nëse je nga të vërtetët, atëherë lëshoje mbi ne një copë nga qielli (si dënim)!”*

## 13 PËRFUNDIMI I NJË POPULLI QË E PËRGËNJESHTRON PEJGAMBERIN E TIJ

Përfundimi ishte një, fundi i çdo populli ishte përgënjeshtrimi i peygamberit të Tij dhe mohimi i dhuntive të All-llahut xh.sh.: “*Ata (popullin e padëgjueshëm) i goditi një tërmet i fortë dhe u gdhinë në shtëpitë e tyre kufoma të gjunjëzuara. Ata që përgënjeshtroan Shuajbin, sikur nuk kishin ekzistuar fare aty, ata që e quajtën Shuajbin rrenacak, vërtet ishin të dështuarit”.*

# 14 E SOLLI MESAZHIN DHE E PËRMBUSHI ATË QË I ISHTE BESUAR (AMANETIN)

Puna e Shuajbit ishte si çështja e çdo pejgamberi, solli kumtin, përmbushi amanetin (porosinë) dhe shtroi dëshminë: “E ai (Shuajbi) u kthye e tha:

*O populli im, vërtet unë ju kumtova porositë e Zotit tim, ju dhashë këshilla, e si të brengosem për një popull që nuk besoi?”*

BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Rrëfimi mbi  
Davudin a.s.  
dhe  
Sulejmanin a.s.

9

## RRËFIMI PËR DAVUDIN A.S. DHE SULEJMANIN A.S.

Kur'ani nuk kufizohet vetëm në të mirat e dënimet e All-llahut dhe me goditjet nga ana e popujve të cilët u dërguan, siç janë: përgënjeshtimi, qesëndisja (tallja), nënçmimi, dëbimi, dënimi, mundimet, shkatërrimi, rrënimi, kurthet dhe përpjekjet për mbytjen e tyre, siç patë mbi rrëfimet për pejgamberët.

## KUR'ANI FLET MBI DHUNTITË E ALL-LLAHUT XH.SH.

Ndërkaq, Kur'ani flet shumë për dhuntitë e All-llahut xh.sh., herë-herë flet gjerësisht e herë-herë shkurtazi për të mira të shumta me të cilat i begatoi shumë peygamberë, e prej tyre janë: Davudi a.s., Ejubi a.s., Junusi a.s., Zekirjai a.s., Jahjai a.s. etj.

Sa i përket Davudit a.s. dhe Sulejmanit a.s., All-llahu i bëri të fuqishëm në tokë, u dha hapësirë për sundim, ua zgjeroi diturinë, u mësoi shumë gjëra që nuk i dinin njerëzit, bëri që t'u nënshtroheshin atyre të fuqishmit dhe të vrazhdët, bota e gjallë dhe ajo jo e gjallë. All-llahu xh.sh. thotë: *“Ne i patëm dhënë Davudit dhe Sulejmanit dituri, e ata të dy thanë: I falënderohemi vetëm Allahut që na dalloi (me të mira) mbi shumë robër të Tij besimtarë. E Sulejmani e trashëgoi Davudin dhe tha: O njerëz, ne kuptojmë gjuhën e shpendëve e na*

*është dhuruar nga gjithçka, vërtet ky është shpërblim i qartë”.*

## 2 TË MIRATE ALL-LLAHUT PËR DAVUDIN A.S.

Kur është fjala për Davudin a.s., atij All-llahu xh.sh. ia nënshtroi kodrat e shpendët e i bashkoheshin në lutje dhe në madhërimin e All-llahut xh.sh.

Gjithashtu i mësoi zejen e parzmoreve dhe bëri që hekuri të zbutej për të.

*“Ne i patëm dhënë Davudit dhuratë të madhe nga ana jonë: O male dhe shpezë, lartësoni (me tesbih) së bashku me të! Ne ia zbutëm (si brumë) atij edhe hekurin.*

*(I thamë) Puno këmisha të plota (nga hekuri) dhe thurri me precizitet ato. Dhe bëni vepra të mira (o familje e Davudit), se Unë vëzhgoj atë që ju punoni”.*

*“...Ne bëmë që kodrat dhe shpezët të madhërojnë (bëjnë tesbih) së bashku me Davudin. Ne kemi mundësi (ta bëjmë këtë) dhe e*

*bëmë. Ne i mësuam (Davudit) punimin e pe-  
tkave (të hekurta) për ju, që t'ju mbrojnë në  
raste lufte. A jeni pra mirënjohës ju për këtë?'*

## **3** DAVUDI A.S. FALËNDERON PËR TË MIRËN

Davudi a.s. edhe pse kishte pushtet të gjerë dhe forcë, ishte abd (adhurues) që i kishte frikë (All-llahut xh.sh.) dhe pendohej, vazhdimisht përkujtonte All-llahun xh.sh., i lutej gjatë dhe e madhëronte All-llahun xh.sh., ishte sundues i drejtë, gjykonte mes njerëzve me të drejtë, nuk mbante anësi dhe nuk lëshonte pe. All-llahu xh.sh. thotë:

*“O Davud: Ne të kemi bërë sundimtar në tokë, e ti pra gjyko me drejtësi mes njerëzve, e mos shko pas dëshirave se ato të shmangin prej rrugës së Allahut. Ata që largohen prej rrugës së Allahut, i pret dënimi i rëndë për shkak se e harruan ditën e përgjegjësisë”.*

## 4 E MIRA E ALL-LLAHUT PËR SULEJMANIN

Për Sulejmanin a.s. All-llahu xh.sh. bëri që erërat t'i nënshtroheshin, të frynin me urdhrin e tij dhe ta bartnin atë prej një vendi në një vend, e arrinte atje për një kohë shumë të shkurtër dhe shpejt. Gjithashtu, për të i nënshtroi demonët (exhinet) e fuqishëm e të shkathët dhe shejtanët e pagjunjësuar. I kryenin urdhrat e tij dhe i përmbushnin projektet e ndërtimitarisë për ngritjen e ndërtesave gjigante.

*“Ndërsa Sulejmanit (ia nënshtroam) erën e fortë, që sipas dëshirës së tij ecte me të deri te toka të cilën Ne e kemi bekuar. Ne jemi të gjithëdijsëm për çdo gjë. Edhe disa nga djajtë (ia nënshtroam) që zhyteshin (në thellësi të ujit) dhe bënë edhe punë të tjera për të (për Sulejmanin), por Ne i ruanim ata (të mos shmangeshin)”.*

*“Edhe Sulejmanit ia nënshtroam erën që paraditja (e udhëtimit) të ishte sa një muaj*

*dhe pasditja e saj (në të kthyer) sa një muaj. I bëmë që atij t'i rridhte burimi i remit dhe me urdbrin e Zotit të tij, ia nënsbtruam xhindët që punonin sipas dëshirës së tij, e kush largohet prej tyre nga urdbri ynë, do ta shijonte zjarrin e fortë. I punonin atij çka i dëshironte: pallate të fortifikuara, skulptura, pjata (të drunjta) sikurse rezervuare, enë (kazanë) të palëvizshme. Veproni duke falënderuar, o familje e Davudit, e nga robërit e Mi, pak janë mirënjohës?'*

## **S** TË KUPTUARIT E SAKTË DHE NJOHURIA E THELLË

Mendjemprehtësia dhe aftësia e tij u tregua me rastin e gjykimit të drejtë që kishte të bënte me një çështje lidhur me babanë e tij. Dikush kishte pasur një vreshtë, ku ishin rritur kalaveshat; kishin hyrë në të dhentë e një personi tjetër që e kishin dëmtuar. Davudi kishte dhënë vendim që dhentë t'i jepeshin pronarit të vreshtës, Sulejmani kishte thënë:

“Çështja qëndron ndryshe, o pejgamber i All-llahut!”. Davudi pyeti: “E si?” Ai u përgjigj: “I jepet vreshta pronarit të dhenve, ai e punon dhe e sjell në atë gjendje që kishte qenë, ndërkaq, dhentë jepja pronarit të vreshtës që t’i shfrytëzojë gjersa të bëhet vreshta ashtu siç kishte qenë, e atëherë vreshta i jepet pronarit të vet e edhe dhentë pronarit të vet”.

E All-llahu e dalloi me të kuptuarit e saktë e me dituri të thellë, dhe tha:

“(Përkujto) *Davudin e Sulejmanin kur pleqëronin për çështjen e bimës (mbjelljes), të cilën delet e atij populli e kishin kullotur natën, e Ne ishim përcjellës të gjykimit të tyre. E Sulejmanit Ne ia mësuam atë (përgjigjen e saktë), po secilit (prej tyre) u patëm dhënë urtësi e dije...”*

## SULEJMANI E DINTE GJUHËN E SHPEZËVE DHE TË KAFSHËVE

Rrëfimi kuranor është rrëfim i arsyeshëm (i urtë) dhe interesant, tregon aftësinë e Sulejmanit në rregullimin e shtetit të tij dhe respektin e pushtetit të tij, se si All-llahu xh.sh. ia ka mundësuar e bashkuar lumturinë e kësaj bote dhe botës së ardhshme, pushtetin dhe pejgamberllëkun. Ai dinte gjuhën e shpezëve dhe të kafshëve.

I bashkoi ushtritë e tij të përbëra prej demonëve (exhineve), njerëzve dhe shpezëve, i nisi të organizuara mirë, në mënyrë dinjitoze e madhështore dhe të prira prej udhëheqësve të tyre. Kështu, Sulejmani kaloi kah lugina e buburrecave, e udhëheqësi i buburrecave u frikësua që kuajt mos t'i shkelnin me thundrat e tyre, kurse Sulejmani dhe ushtria e tij mund të mos e hetonin një gjë të tillë. Andaj udhëheqësi i buburre-

cave i urdhëroi që të hynin në vendet e tyre. Sulejmani e kuptoi këtë gjë, por kjo nuk e shtyu që të krenohej dhe t'i hapte krahët se ishte një prej pejgamberëve të All-llahut, përkundrazi, kjo e shtyu që të falënderonte All-llahun për dhuntitë e Tij, t'i lutet Atij, të kishte sukses për vepra të mira dhe të vazhdonte rrugën e robërve të mirë.

## 7 RRËFIMI MBI HUD'HUDIN (PUPEZËN)

Hud'hudi ishte i tillë që syri i tij vërente vendet ku kishte ujë dhe ato ushtarake. Meqë nuk e kishte gjetur një gjë të tillë, nuk i kishte ardhur mirë dhe e kishte marrë këtë si kërcënim ndaj tij. Pas një kohe të shkurtër që kishte humbur ishte kthyer, i ishte drejtuar Sulejmanit duke i thënë:

- Kam parë çka nuk ke parë as ti e as ushtria jote, dhe të kam ardhur me një

lajm të vërtetë për Sebein dhe mbretëreshën e tij. Ata kanë pushtet të madh dhe shtet me hapësirë të gjerë. E krahas asaj që janë të mençur dhe të kuptueshëm, krahas forcës dhe pushtetit, ata janë të paditur dhe torollakë. Ata i përkulen diellit e jo All-llahut, duke mos e kuptuar këtë, dhe nuk udhëzohen për ta adhuruar All-llahun që është Një.

## 8 SULEJMANI E THËRRET NË FENË E TIJ MBRETËRESHËN E SEBEIT

Pejgamberit të All-llahut i erdhi rëndë që në fqinjësinë e tij mbretërore të kishte një sundimtare dhe një popull të cilët të mos i njihte dhe mos t'u drejtonte thirrjen. Ndërkaq vazhdonin më tej ta adhuronin diellin; kështu tek ai u trazua dëshira e zjarrtë fetare dhe pejgamberike, e pa të arsyeshme që t'i

shkruante mbretëreshës dhe sundimtares së atij vendi, e cila ishte idhujtare, për ta thirrur në Islam, në dëgjesë dhe nënshtrim, para se të marshonte për në vendin e saj me ushtritë e tij të fuqishme. I shkroi asaj një letër, në të cilën i afroi e i thirri në Islam dhe në dorëzim. Gjithashtu letra kishte në përmbajtje butësi dhe ashpërsi, modesti peygamberike dhe xhelozsi sunduesi.

## 9 MBRETËRESHA KËSHILLOHET ME PARINË E SHTETIT TË SAJ

Sulejmani a.s. ishte ai që e bëri afrimin mes tyre.

Kjo grua, e cila sundonte ato vende, ishte e mençur dhe nuk shpejtonte në vendimet e saj. Ajo kishte përvojë të madhe, i dinte rrëfimet që kanë të bëjnë me sunduesit e gjithashtu kishte informata për pushtuesit. Megjithatë, ajo me

mendjen e saj nuk kishte arritur ta njihte All-llahun dhe ta adhuronte. Ishte femër që nuk e kaplonte euforia e qeveritarit dhe nuk e impononte mendimin e vet. Këtë letër, e cila nuk ishte si letrat tjera, ua tregoi udhheqësisë së shtetit, meqë ishte letër nga ana e një sunduesi më me emër në kohën e saj dhe prej një peygamberi, i cili thërret për t'i besuar All-llahut xh.sh.

Kur krerët e shtetit filluan të lavdëroheshin me forcën e tyre dhe numrin e ushtrisë së tyre, ashtu siç dinë të bëjnë ata që rrinë afër mbretërve dhe qeveritarëve, në çdo kohë e vend, ajo nuk e pranoi çka thanë ata dhe nuk u pajtua me ta. Por, ua tërhoqi vërejtjen për pasojat dhe u përkujtoi atë se çfarë bëjnë mbretërit pushtues në popujt dhe vendet e pushtuara, kur thyhen dhe pësojnë disfatë. Andaj, ajo tha:

- Kjo mund t'i ndodhë edhe vendit e popullit tonë, mirëpo unë Sulejmanit do t'i dërgoj dhurata për ta vërtetuar se

kush është ai. Po qe se e pranon dhuratën, ai është një sundimtar si çdo sundues tjetër, atëherë kundërshtojeni.

E, po qe se nuk e pranon, atëherë ai është peygamber, prandaj ta pasoni”.

## 1 DHURATA E OFRUAR!

I kishte dërguar një dhuratë të madhe ashtu siç i takon një mbreti, e kur kishte arritur dhurata te Sulejmani, ai nuk e kishte pranuar dhe kishte thënë:

- A po më jepni një pasuri, që unë t’ju lë në idhujtari dhe në pushtetin tuaj? Ajo që më ka dhënë All-llahu nga pushteti, pasuria dhe ushtria është më e mirë se ajo që më jepni ju. Çështja është serioze e nuk është lojë, ajo ka të bëj me thirrjen dhe nënshtrimin e nuk ka të bëjë me korrupsionin”. Iu kërcënua se do t’i sulmonte në pushtetin e tyre.

## MBRETËRESHA VJEN E NËNSHTRUAR

Kur dërgata u kthye te mbretëresha e Sebeit dhe i tregoi rastin, pasi e dëgjuan ajo dhe populli i saj, pranoi që të shkonte te Sulejmani e nënshtroar në krye të ushtrisë së saj. Kur Sulejmani a.s. e vërtetoi ardhjen e tyre tek ai, u gëzua shumë dhe falënderoi All-llahun xh.sh. Kështu që, deshi t'i jepte një dëshmi nga dëshmitë e All-llahut xh.sh., e cila kishte të bënte me fuqinë e All-llahut dhe dhuntinë ndaj Sulejmanit. Andaj kërkoi që ta sillnin fronin e saj, i cili iu besua njerëzve të fortë e të sigurtë, dhe shpura e vet ta sillnin fronin e saj para se të arrinte vargani i madh (populli me mbretëreshën në krye).

Ajo që deshi Sulejmani u krye brenda një kohe shumë të shkurtër dhe kjo qe një mrekulli. Sulejmani urdhëroi të ndryshohej pamja e fronit si shkas për të vërtetuar diturinë dhe qëndruesh-

mërinë e mbretëreshës kur ta shihte.  
Nëse i koklavitej puna, kjo do të dësh-  
monte dobësinë e saj për t'i parë çësht-  
jet shumë më të ndërlikuara nga ajo.

## 12 PALLATI I MADH PREJ QELQI

Sulejmani urdhëroi mjeshtërit e ndër-  
timtarisë, njerëz e demonë (exhine) të  
ndërtonin një pallat të madh prej qelqi.  
Të sillnin edhe ujë që të rridhte nën të, e  
ai që nuk e dinte punën do të mendonte  
se ishte në ujë, edhe pse mes atij që  
shkelte dhe ujit do të ishte qelqi  
(i dyshemesë). Ç'është e vërteta,  
mbretëresha kur të hynte në këtë pallat,  
do të kujtonte se kishte vetëm ujë dhe  
do ta ngrinte fundin e mashtruar me  
pamjen e jashtme. Ajo dhe populli i saj i  
përkuleshin diellit, meqë ai përfaqëson  
dritën dhe jetën, e kjo është prej cilësive  
të All-llahut të Madhëruar. Po këtu tani

iu largua perdja nga sytë dhe e kuptoi gabimin që kishte bërë duke e kujtuar qelqin ujë. Prandaj e kishte ngritur fundin që mos t'i lagej, po ashtu si kishte gabuar duke e konsideruar diellin si krijues, të cilit i ishte përkulur dhe e kishte adhuruar. E kjo vlejti më shumë sesa njëqind ligjërata dhe një mijë argumente.

## 13 E TASH SË BASHKU ME SULEJMANIN I DORËZOHEM ALLAHUT, ZOTIT TË GJITHËSISË

Dhe kështu ndodhi, edhe pse e mençur e me dhunti, ishte turpëruar dhe kishte bërë gabim të tepruar. Kishte menduar se qelqi ishte ujë i shkëlqyer që rridhte dhe shkonte valë-valë, i përvoli këmbët dhe deshi të hynte në të. Atëherë pejgamberi i All-llahut, Sulejmani, i tërhoqi vërejtjen për gabimin e saj, dhe i tha:

- Ky është një pallat i lëmuar prej qelqi.  
- Kështu asaj i ra pengesa prej syve, e kuptoi se i mungonin njohuritë, meqë bënte krahasimin e dukjes në dëm të së vërtetës, e njëherit adhuronte diellin. Me këtë rast ia priti duke thënë:

*“Zoti im, unë i kam bërë krim vetes e tash së bashku me Sulejmanin i dorëzohem (pranoj besimin) Allahut, Zotit të gjithësisë”.*

## 14 KUR'ANI FLET PËR SULEJMANIN

Lexoni këtë rrëfim të shkëlqyeshëm dhe të këndshëm në Kur'an, ku All-llahu xh.sh. thotë:

*“Dhe vështroi shpendët e tha: Ç’është që nuk e shoh pupëzën? Jo, ajo nuk qenka këtu! Unë do ta dënoj me një dënim të ashpër ose do ta tber, ose ka për të më sjellë ndonjë argument të fortë (si arsyetim). Nuk zgjati shumë e tha:*

*Unë e kuptova se ti nuk ke njohuri dhe të erdha nga Sebei me një lajm të sigurt. Në të*

*vërtetë gjeta një grua që po i sundonte ata (popullin e Sebeit) dhe asaj i ishte dhënë çdo send, e ajo kishte edhe një fron të madh. Madje e gjeta atë dhe popullin e saj që adhuronin diellin e jo Allahun, po djalli ua kishte hijeshuar atë veprim dhe i kishte shmangur prej rrugës së drejtë, andaj ata nuk gjejnë udhërrëfim. Për të mos adhuruar Allahun që nxjerr në shesh (e di) të fshehtën në qiej e në tokë, dhe e di atë që fshihni dhe atë që dëfteni. Allahu është një, nuk ka Zot tjetër pos Tij, Zot i Arshit të madh.*

*Ai (Sulejmani) tha:*

*Do të shohim se a e thua të vërtetën apo je nga gënjeshtarët! Shko me këtë letrën time e hidhura atyre, largohu (pak) nga ata dhe përgjo se çka bisedojnë! Ajo (gruaja-Belkisa) tha:*

*O ju pari, mua më ka ardhur një letër madhështore! Kjo është prej Sulejmanit. Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit (Bismil Lahi Rrahmani Rrahim)! (në vazhdim shkruan) Të mos mbabeni më të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (besimtarë)! - Ajo vazhdoi: - O ju pari, më*

*këshilloni për këtë punë, se unë nuk do të vendos asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqimin! Ata (paria) i thanë:*

*Ne jemi të fuqishëm, dhe jemi luftëtarë të rreptë, por puna qëndron te ti, e ti mendo se çka do të na urdhërosh! Ajo tha:*

*Kur sunduesit e pushtojnë ndonjë vend, e rrënojnë atë e parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrojnë. Kështu veprojnë! Po unë do t'u dërgoj atyre një dhuratë (të madhe), e do të shoh se çka do të na sjellin të dërguarit.*

*E kur i erdhi ajo Sulejmanit, ai tha:*

*A me pasuri më ndihmoni mua? Po ajo që më ka dhënë All-llahu është shumë më e dobishme nga ajo që ju ka dhënë juve! Por ju krenoheni me dhuratat tuaja! Kthehu te ata (i tha kryesuesit të të dërguarve), se për Zotin ne do t'u vimë atyre me një ushtri, së cilës ata nuk do të mund t'i bëjnë ballë dhe do t'i dëbojmë prej aty të nënshtroar e të poshtëruar! Ai (Sulejmani) tha: O ju pari, cili prej jush do të ma sjellë fronin e saj, para se të më vijnë ata të dorëzuar? Njëri prej xhinve të vrazhdë (Ifriti) tha:*

*Unë do ta sjell atë ty para se të ngrihesh nga vendi yt, për këtë kam fuqi dhe jam i sigurt!*

*E ai i cili kishte dituri nga libri tha:*

*Unë ta sjell sa çel e mbyll sytë! (këtij i tha: sille)*

*E kur e pa të vendosur pranë tij (Sulejmani) tha:*

*Kjo është nga dhuntia e Zotit tim që të më sprovovë, se a do ta falënderoj, apo mos do ta përbufz. E kush falënderon, ai falënderon për të mirën e vet, e kush përbufz, Zoti im*

*(s'ka nevojë), është i panevojë e bujar! -*

*Ai (Sulejmani) tha: Ia ndryshoni asaj fronin që ta provojmë se a po e njeh apo është nga ata që nuk dinë ta njohin!*

*E kur ajo erdhi, iu tha:*

*A është i këtillë froni yt? Ajo tha:*

*Si të ishte vetë ai! (Sulejmani tha)*

*Neve na është dhënë dituria përpara saj dhe ne ishim besimtarë para saj.*

*Sepse atë (Belkisën) e kishte penguar (nga besimi i drejtë) ajo që adhuronte, pos Allahut, dhe ishte nga një popull jobesimtar.*

*Asaj iu tha:*

*Hyr në pallat, e kur e pa, mendoi se ishte një  
ujë i madh dhe i përvoli këmbët. Ai*

*(Sulejmani) tha:*

*Ky është një pallat i lëmuar prej qelqi! -*

*Ajo tha:*

*Zoti im, unë i kam bërë krim vetes e tash së  
bashku me Sulejmanin i dorëzohem (pranoj  
besimin) Allahut, Zotit të gjithësisë”.*

Ky është peygamberi i All-llahut Sulejmani, një herë patë përkushtueshmërinë e tij në thirrje për të njohur All-llahun. Një herë tjetër, urtësinë e tij, aftësinë dhe kujdesin për fenë e besimin e tij.

## 15 NUK ISHTE I PAFE SULEJMANI, POR DJAJTË ISHIN TË PAFE

Çifutët e ngarkuan atë me diçka, e cila nuk i përket një besimtarit që e njeh All-llahun. Një, të cilit All-llahu ia ka hapur gjoksin për besim. Aq më tepër, një peygamberi të dërguar, të cilit

All-llahu i ka dhënë urtësi, e ka nderuar me mision dhe e ka nderuar me qeverisje. Ia veshën atij magjinë, mosbesimin, mashtrimin me bestytini dhe paqartësinë në çështjen e njohjes së All-llahut për shkak të grave të tij. Mirëpo, All-llahu xh.sh. nga të gjitha këto e pastroi dhe tha: “... *Sulejmani nuk i ishte i pafe, por djajtë ishin të pafe, sepse u mësonin njerëzve magjinë...*”. Gjithashtu All-llahu xh.sh. thotë: “*Ne Davudit i falëm Sulejmanin, rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zot!*”. Po ashtu All-llahu xh.sh. thotë: “*Ai vërtet ka vend të lartë te Ne dhe ardhmëri të mirë*”.



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Rrëfimi mbi  
Ejubin a.s.  
dhe  
Junusin a.s.

10



## RRËFIMI MBI EJUBIN A.S. ËSHTE LLOJ MË VETE I RRËFIMEVE

Rrëfimi mbi Ejubin a.s. në Kur'an është lloj më vete prej rrëfimeve, dhe dukuri prej dhuntive të All-llahut xh.sh. për robërit e Tij besimtarë, të durueshëm, mirënjohës, dhe për përgamberët e dashur. Ai kishte shumë bagëti, tokë e fëmijë të pranuar, mirëpo u godit me fatkeqësi, ia mori All-llahu. Pastaj, fatkeqësia e goditi në trupin e tij ku nuk i mbeti gjë e shëndoshë përpos zemrës dhe gjuhës së tij, me të cilat e përmendte dhe e kujtonte All-llahun e Lartmadhëruar. Kishte mbetur i vetmuar në skaj të vendit. Asnjë njeri nuk kujdesej për të përpos bashkëshortes së tij, e cila kujdesej për çështjen e tij. Kurse për nevojat e saj dhe të tij kishte filluar të punonte si shërbëtoare.

## 2 DURIMI I EJUBIT A.S.

Përballë gjithasaj ai ishte durimtar dhe falënderues, e ngalliste gjuhën me të përkujtuarit dhe falënderim ndaj All-llahut xh.sh.. Nuk ankohej, nuk kërcënohej, nuk hidhërohej, dhe kështu vazhdoi shumë vjet.

## 3 SPROVË DHE DHURATË

Pas përfundimit të asaj që deshi All-llahu nga goditja dhe që dëshiroi plotësimin, ngritjen në shkallë dhe pajtueshmërinë me atë që ndodhi, e frymëzoi me lutje të pranueshme e cila tregon paaftësinë dhe mjerimin e tij. Kështu që, nuk ka strehim përpos strehimit të All-llahut xh.sh. dhe Ai është me mundësi të pakufishme. All-llahu xh.sh. i dha shëndetin, ia ktheu pasurinë, i dha dhunti të shumëfishtë. All-llahu xh.sh. thotë:

“(Përkujto) *Edhe Ejubin kur iu drejtua Zotit të vet me lutje: Më gjeti belaja, e ti je më mëshiruesi ndër mëshiruesit! Ne iu përgjigjëm atij nga mëshira Jonë, ia hoqëm ato vështirësi që i kishte, i dhamë familjen e tij dhe aq sa ishin ata, dhe e bëmë përkujtim për të devotshmit”.*

## **L**RRËFIMI MBI JUNUSIN A.S. DHE URTËSIA E TIJ

Pason rrëfimi mbi Junusin a.s. i cili ka lidhje me rrëfimin mbi Ejubin a.s. e që ndihmon në vërtetimin e fuqisë, përzemërsisë dhe ndihmës së All-llahut xh.sh. ndaj robërve të Tij. Pikërisht në momentin e gjasës për humbjen e shpresës, kur e mbulon dëshpërimi dhe errësia më e madhe, kur i mbyllen të gjitha rrugëdaljet, kur nuk ka dritë e as ajër, kur nuk ka shpresën më të vogël, kur sillet kërdia e vdekjes e fuqishme dhe e shpejtë, e cila dërrmon farën e jetës së ndërlikuar dhe të brishtë.

Me këtë rast tregohet forca e All-llahut xh.sh., fuqia mbizotëruese, e mëshirueshme dhe sunduese, e cila këtë njeri të dobët e nxjerr nga nofullat e luanit grabitqar dhe vdekja sulmuese. E, ai del i shëndoshë i palënduar, i tëri pa kurrfarë mungese, thua se ka qenë në shtrat në shtëpinë e tij dhe i mbrojtur në mesin e familjes së tij.

## 5 JUNUSI A.S. NË MESIN E POPULLIT TË TIJ

Rrëfimi mbi Junusin a.s. është si vijon:  
All-llahu xh.sh. e dërgoi te popullsia e fshatit Nineve, e thirri në besimin te All-llahu xh.sh. Mirëpo, ata nuk e pranuan dhe vazhduan në mosbesimin e tyre. Nga mesi i tyre doli i hidhëruar ndaj tyre, iu kërcënua me dënim pas tri ditësh. Pasi ishin bindur dhe e kishin kuptuar se peygamberi nuk gënjente, kishte dalë në shkretëtirë me fëmijët dhe

bagëtinë e tyre. I kishin ndarë fëmijët nga nënat e tyre me pendim, i luteshin All-llahut xh.sh. dhe me gjëmë i drejtosheshin Atij. Pëllisnin devetë e mëdha e të vogla, lopët dhe viçat, dhentë dhe qengjat blegëronin, e All-llahu xh.sh. e hoqi dënimin prej tyre. All-llahu xh.sh. thotë: *“Përse nuk pati vendbanim që të ketë besuar e besimi i tij të ketë ndihmuar (në shpëtim), pos popullit të Junusit, pasi besoi, Ne larguam prej tyre dënimin shëmtues në jetën e kësaj bote dhe i lejuam të jetojnë deri në një afat të caktuar”*.

## **JUNUSI NË BARK TË PESHKUT**

Junusi a.s. kishte shkuar me disa njerëz dhe kishte hipur në një anije. Mirëpo, nga pesha e madhe ajo mund të thyhej ose të përmbysëj. Andaj, u kishte hyrë frika për fundosjen e tyre.

Kështu, kishin qitur short që njëri prej

tyre të hidhej në det e anija të lehtësohej; shorti i kishte rënë Junusit. Mirëpo, ata nuk pranuan ta hidhnin dhe e përsëritën shortin, po përsëri atij i ra. Përsëri e përsëritën shortin, megjithatë edhe kësaj radhe i ra Junusit. All-llahu xh.sh. thotë: *“E ai mori pjesë në short, po humbi (i ra shorti atij)”*.

Meqë shorti i ra atij, Junusi a.s. u ngrit, i zhveshi rrobat dhe u hodh në det.

Mirëpo, All-llahu xh.sh. kishte dërguar një peshk dhe në momentin kur Junusi a.s. u hodh nga anija, peshku e përpiu. Gjithashtu All-llahu xh.sh. peshkun e kishte frymëzuar që mos ta hante mishin e tij e as mos t'i thyente ndonjë asht.

## 7 ALL-LLAHU XH.SH. IU PËRGJIGJ LUTJES SË TIJ

Ai ishte në errësirën e barkut të peshkut, në errësirën e detit, në errësirën e natës, errësirë mbi errësirë,

merret me mend pra se çfarë errësire!  
Dhe sa larg shpëtimit! Kështu që e mba-  
jti All-llahu xh.sh. aq sa deshi ta mbante.  
Më pas e frymëzoi me disa fjalë, të cilat  
e përhapën errësirën, i larguan prob-  
lemet dhe e zbritën mëshirën nga shtatë  
qiejtë. Dëgjo se si e tregon Kur’ani këtë  
rrëfim të çuditshëm dhe të veçantë. Në  
të cilin ka ngushëllim për çdo të mjerë  
dhe të pikëlluar, për të dëshpëruarin e të  
shqetësuarin. Të cilit toka përkundër  
gjerësisë së saj, i është ngushtuar. I është  
ngushtuar shpirti dhe e sheh qartazi se  
nuk ka strehim pos te All-llahu xh.sh.

“(Përkujto) *Edhe atë të peshkut* (Junusin)  
*kur doli i hidhëruar* (prej popullit) *dhe men-*  
*doi se nuk do t’i vinte puna më ngushtë, po në*  
*errësirë ai tha: ‘Nuk ka Zot pos Teje. Ti je i*  
*pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra të padrejtë*  
*vetes!’ Ne iu përgjigjëm atij, e shpëtuam nga*  
*tmerri. Kështu i shpëtojmë Ne besimtarët”.*



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Rrëfimi mbi  
Zekirjanë  
a.s.





## LUTJA E ZEKIRJAIT A.S. PËR FËMIJË TË MIRË

Një nga argumentet dhe dhuntitë të All-llahut xh.sh. për robërit e Tij, paraqitet në lutjen e Zekirjait a.s. për fëmijë të mirë, të këndshëm, të devotshëm dhe për ta trashëguar atë (Zekirjanë) dhe familjen e Jakubit a.s. Për gjithë këtë i drejtohet me lutje All-llahut xh.sh. Edhe këtë, kur kishte hyrë në moshë, kur e kishte lënë fuqia, kur e kishte rraskapitur pleqëria dhe e kishte humbur shpresën për të lindur bashkëshortja e tij. E All-llahu xh.sh. i përgjigjet lutjes së tij, i përgënjeshtroi paragjykimet e njerëzve dhe e zhvlerësoi përvojën e mëhershme. Kështu i dhuroi një djalë prijëtar, i cili që herët u dallua për urtësi, butësi, dituri, mësoi shpejt shkrim e lexim që në vegjëli. Kishte prirje për të mirë, ishte i devotshëm e mirëbërës ndaj prindërve, i ndjeshëm, mbrojtës dhe u shtrinte krahët e

mëshirës prindërve dhe All-llahu e lidhi për zemrën e Zekirjait a.s. Ia mundësoi atij që t'i shihte dëshmitë të cilat tregojnë fuqinë e gjithëmbarshme të All-llahut xh.sh., se Ai vepron çka dëshiron dhe krijon çka dëshiron. Ia mundësoi të kuptonte udhëheqjen në krijimin e Tij dhe në pjesët e trupit të tij. Se Ai vë në veprim çka dëshiron dhe ndërpret po ashtu çka dëshiron. U vërtetua për të se mbarë gjithësia është nën fuqinë e All-llahut xh.sh. Ai të gjallin e nxjerr prej të vdekurit e të vdekurin prej të gjallit. Ai kë të dëshirojë e furnizon prej nga nuk e mendon.

## 2 ZOTIMI I BASHKËSHORTES SË IMRANIT

Bashkëshortja e Imranit, e cila i takonte familjes së Zekirjait a.s. kishte marrë një zotim. Ajo ishte grua e mirë, e donte All-llahun dhe fenë e saj. Zotimi i saj

ishte se po të lindte djalë, atë fëmijë do ta dhuronte për hir të All-llahut xh.sh. që t'i shërbente fesë së Tij. Ajo kërkoi nga All-llahu xh.sh. që ta pranonte këtë fëmijë për të pasur dobi feja e Tij dhe robërit e Tij. Që të ishte thirrës e udhëheqës në të besuarit All-llahun xh.sh.

## 30 ZOTI IM, UNË LINDA VAJZË

Gruaja e mirë kishte pasur një dëshirë, por All-llahu kishte dëshiruar diç tjetër. E All-llahu më së miri e di të mirën e robërve të Tij. Meqë ajo lindi vajzë, u dëshpërua dhe e kapëloi pikëllimi. Mirëpo kjo vajzë nuk ishte si çdo femër tjetër, sepse ishte e dhënë në ibadet (përlshmëri) ndaj All-llahut xh.sh.. Ishte e dhënë në bindje dhe punë të mira shumë më tepër nga të rinjtë e tjerë. All-llahu kishte caktuar që ajo të ishte femër, meqë Ai e di një urtësi të tillë, e pejgam-

berinë dhe barrën e tij nuk mund ta bartin pos burrat. Porse All-llahu kishte caktuar që ajo të ishte nëna e një pejgamberi të mirë, i cili do të kishte autoritet.

“(Përkujtohu) *Kur gruaja e Imranit pat thënë:- Zoti im, këtë që është në barkun tim vendosa ta kushtoj thjesht vetëm për shërbimin Tënd, pra pranoje këtë prej meje, vërtet Ti je Ai që dëgjon e di. - Pastaj, kur lindi, ajo tha: - Zoti im, kam lindur femër, e Allahu e dinte më së miri atë që ajo e lindi. E mashkulli nuk është si femra. Dhe unë e quajta Merjeme, e atë dhe pasardhësit e saj po t’i lë Ty në mbrojtje prej djallit të mallkuar.*”

## **K**KUJDESI I ALL-LLAHUT PËR VAJZËN E MIRË

Ajo ishte nën kujdesin e Zekirjait a.s. dhe nën mbrojtjen e All-llahut të Lartmadhëruar. All-llahu e kishte nderuar me fruta dhe pemë pa marrë parasysh kohën dhe vendin (kur bëhen dhe ku

bëhen), çka dëshironte prej tyre hante e çka dëshironte dhuronte.

*“Zoti i saj e pranoi premtimin e saj ashtu si është më mirë, e rriti me një edukatë të mirë e të plotë dhe e vuri nën kujdesin e Zekirjasë. Sa herë që Zekirjai hynte në mibrabin (dhomën) e saj, gjente ushqim e thoshte: - Oj Merjeme, prej nga të vjen ky ushqim? - Ajo thoshte: - Është nga Allahu, se Allahu atë që do, pa masë e furnizon!”*

## **S**FRYMËZIM NGA ZOTI I MËSHIRSHËM

All-llahu xh.sh. e frymëzoi Zekirjanë a.s., e ai është një peygamber prej peygambërëve, i mençur dhe me talent. Ai ka mundësi për ta gostitur vajzën e mirë me fruta, pa marrë parasysh vendin dhe kohën kur bëhen dhe ku bëhen. Vajza nëna e së cilës ishte e singërtë në zotim, bënte lutje, me bindje dhe adhurim. Ai ka mundësi që plakut i cili

kishte hyrë në moshë dhe pleqëri e ishte dobësuar, t'i dhurojë fëmijë. Edhe pse plaku e kishte humbur shpresën për shkak të vjetëve dhe për shkak se bashkëshorten e kishte shterpë.

Gjithashtu për shkak se mëse normale ishte që në një moshë të atillë një burrë të mos kishte fëmijë. Me atë rast zuri t'i rritej interesimi, t'i këndellej shpresa dhe përforcimi në mbështetjen te All-llahu xh.sh. Bënte lutje për të cilën engjëjt (melekët) thoshin amin (pranoje, o Zot). E në gjithë këtë vepronte mëshira e All-llahut (xh.sh.). Gjithë kjo ishte frymëzim nga Zoti i Gjithëmëshirshëm dhe caktimi nga i Gjithëfuqishmi dhe i Gjithëdituri. *“Aty në atë moment Zekirjai e lut Zotin e tij e thotë: -Zoti im, më fal edhe mua nga ana Jote një pasardhës të mirë, vërtet, Ti je dëgjues i lutjes!”*

## LSIHARIQI PËR FËMIJËN

All-llahu xh.sh. e pranoi lutjen e Zekirjaut a.s., i erdhi atij sihariqi për lindjen e fëmijës së mirë në një kohë të afërme.

Njeriu nga vetë natyra e tij është i ngutshëm, e ai kërkoi një shenjë për mundësinë e kësaj ndodhie të madhe, e tha: “... *Zoti im, më jep një shenjë! - Shenja jote, - iu tha, - është që tri ditë nuk do të mund t’u flasësh njerëzve, veç me gjeste, e përmende shumë Zotin tënd dhe madhëroje mbrëmje e mëngjes!*”

All-llahu xh.sh. ka mundësi t’i shtangë shqisat, atë që flet e bën të shprehet me lëvizje të fytyrës por pa mundur ta flasë një fjalë. Gjithashtu Ai ka mundësi t’ia lëje në zotërim kujt të dëshiron nga krijesat e Tij. E i Fuqishmi i cili mundet t’ia pengojë, Ai edhe mundet t’ia japë.

## 7 DËSHMITË E ALL-LLAHUT DHE FUQIA E TIJ

Dëshmitë e All-llahut xh.sh. u shfaqën në trupin e tij e më pas në shtëpinë dhe në familjen e tij. U lindi Jahjai, u gëzua ai me të, iu shtuan fuqitë dhe lutja e tij u bë realitet.

Dëgjoje Kur'anin si e tregon këtë rrëfim, herë shkurt e herë më gjerë, dhe thotë:

“(Përkujto) *Edhe Zekirjanë kur e luti Zotin e vet: - Zoti im, mos më lër të vetmuar, se Ti je më i miri trashëgues (për çdokënd). - Ne ia pranuan lutjen, i dburuan atij Jahjanë dhe ia përmirësuam bashkëshorten. Ata përpiqeshin për punë të mira, luteshin duke shpresuar dhe duke pasur frikë, ishin respektues ndaj Nesh.*”

## 8 JAHJAI MERR PËR OBLIGIM ÇËSHTJEN E THIRRJES PËR TË BESUAR ALL-LLAHUN XH.SH.

Jahjai lind dhe bëhet dritë e syve për prindërit dhe zëvendës i atit të tij. Ngarkohet me barrën e thirrjes në të besuarit të All-llahu xh.sh. dhe të feja e vërtetë. Që në vegjëli u shfaqën të ai shenjat e prejardhjes fisnore. Qysh djaloshe e merrte me dashuri diturinë dhe qysh i ri stolisej me të mira e i druhej fajit. Dallohej nga moshatarët me dashuri, mëshirë dhe mirësjellje ndaj prindërve, aq sa tregohej me gisht. All-llahu xh.sh. duke iu drejtuar, thotë:

*“O Jahja, merre librin me shumë kujdes, dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë. Dhe nga ana jonë i mundësuam të jetë i butë, i pastër dhe respektues (i dëgjueshëm). Edhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte kryelartë e i padëgjueshëm. Dhe salam atij ditën kur u lind, ditën kur vdes dhe ditën kur do të ngrihet i gjallë (e përshëndetëm dhe i garantuam)!”*



BISMIL-LAHIR-RRAHMANIR-RRAHIM

NË EMËR TË ALL-LLAHUT,  
TË GJITHËMËSHIRSHMIT,  
MËSHIRËPLOTIT

Rrëfimi mbi  
Isanë a.s.  
të Birin  
e Merjemes

12



## NDODHIA E JASHTËZAKONSHME!

Vjen periudha e Isait a.s., e ai është pejgamberi i parafundit, para pejgamberit tonë Muhammedit a.s. Ky është një rrëfim në të cilin paraqitet dëshira e All-llahut mbizotërues, fuqia e All-llahut në përgjithësi dhe urtësia e përpiktë e All-llahut. E çështja e tij në tërësi është e mbinatyrshme, edhe lindja e tij është e jashtëzakonshme, ku mendja nuk arrin dhe nuk kanë vend ligjet e natyrës.

Në lidhje me këtë është i papranueshëm të besuarit dhe të vërtetuarit e atij, që ligjet e natyrës i beson si zota që nuk mënjanohen e as ndryshojnë. Po ashtu bie në pozitë të papranueshme ai, i cili i beson përvojës dhe gjendjes faktike, ligjeve të mjekësisë e të natyrës si diçka që nuk pësojnë ndryshime. Të gjitha këto i shpërfill fuqia e All-llahut xh.sh. e cila përthekon çdo gjë dhe mposht gjithçka. E asgjë nuk mund të ndodhë

dhe të goditet përpos asaj që dëshiron All-llahu xh.sh.: “*Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhri i Tij është vetëm t'i thotë: 'Bëhu'! Ai menjëherë bëhet.*”

Ndërkaq, ai që e beson All-llahun e Gjithëfuqishëm, si krijues dhe hartues, thotë për të: “*Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të tij janë emrat më të bukur. Atë (Allahun) e madhëron çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënjyesi, i urti.*”

Dhe ai që e beson krijimin e Ademit a.s. prej ujit dhe baltës, dhe pa babë e pa nënë, e lindja me nënë e pa babë më pak ka rëndësi dhe më e lehtë është për t'u besuar nga lindja pa babë dhe nënë. Shih për këtë All-llahu xh.sh. që thotë:

“*Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj i tha: 'Bëhu'! Ai u bë.*”

## 2 ÇËSHITJE E CILA ËSHTË E ÇUDITSHME FUND E KRYE

Çështja e Isait a.s. në tërësi është e çuditshme. Lindja e tij ka ndodhur në një shekull kur Greqia antike kishte zbulime dhe arritje shkencore në lëmin e logjikës, matematikës, kurse në fushën e mjekësisë ishte në kulmin e vet.

## 3 NËNSHTRIMI I ÇIFUTËVE SHKAQEVE TË DUKSHME

Nënshttrimi i çifutëve – popull i cili pati shumë pejgamberë - ndaj shkencave prijëse në shekullin e tyre, ishte shkas për mohimin e çështjes shpirtërore dhe gjithçkaje që ka të bëjë me të. Ata e kishin tepruar me shpjegimin e së dukshmes në vetëm nga ana materiale. Për ta diçka as nuk ekzistonte e as që kishte mundësi të ndodhte pa shkas të caktuar. E mrekullitë me të cilat All-llahu xh.sh.

e kishte nderuar Isanë a.s. ishin shërim për mendjen e materializuar e të kufizuar dhe nevojë e shekullit dhe e kohës.

Çifutët e kishin tepruar duke u kufizuar në të dukshmen, duke i dhënë përparësi asaj që i takon dorës së dytë e jo asaj që i takon dorës së parë. E kishim tepruar duke këmbëngulur në sipërfaqësoren e jo në realitetin. E tepruan me shenjtërimin e prejardhjes së gjakut dhe me lakminë ndaj pasurisë e materializmit. Ishin dhënë skajshmërisht pas jetës, u ishin ngurtësuar zemrat dhe kishte shterur natyra e tyre (njerëzore). Nuk kishin mirësi ndaj të dobëtisë e as mëshirë ndaj të varfrit. Me ata që nuk kishin prejardhje izraelite silleshin si ndaj shtazëve, qenve dhe gjërave jofrymore. Të fortëve dhe pasanikëve u nënshtroheshin, ndërkaq ushtronin dhunë ndaj të vegjëlve dhe të varfërve. Kur ishin të fuqishëm ishin të vrazhdë, e kur ishin të pafuqishëm ishin të butë. Meqë kishin jetuar nën pushtetin e romakëve, i

cili kishte vazhduar kohë të gjatë në Siri dhe Palestinë, u ishin rrënjësuar nënçmimi, dyfytërsia, tradhtia, paragjykimet, dinakëria dhe moskujdesi për të fshehtat e kësaj bote.

## 4 NËNÇMIMI DHE VRAZHDESI

U kishte lindur ideja për t'i nënçmuar pejgamberët, për t'i kundërshtuar, për t'i mbytur dhe për t'u marrë me kamatë.

Ndërsa mësimet e fesë i shihnin si diçka të kotë, të vështirë e shterpë. Kështu u ishte dobësuar ndjenja njerëzore.

Te shumica prej tyre zemrat u ishin zhveshur nga dashuria e çiltër ndaj All-llahut xh.sh. dhe nga mëshira ndaj njeriut e respekti ndaj tij, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre.

Kishin harruar kuptimin e barazisë, të së mirës dhe fisnikërisë. Në të kaluarën ata i kishin besuar pejgamberisë meqë ndër ta kishte pasur shumë pejgamberë.

Mirëpo më vonë ishin bërë të tillë që nuk kishin besuar përpos asaj që u ishte përshtatur dëshirës së tyre, atë që e kishite vërtetuar e shkuara dhe morali i tyre. E këdo që i kishte kritikuar, i kishte thirrur në fe të vërtetë, në përmirësimin e gjendjes dhe në të vërtetën e qartë, e kanë parë si armik dhe e kanë luftuar. Gjithashtu ata kishin prirje për trillime, për t'u arratisur në një të paqenë, për ta fshehur të vërtetën dhe për të dëshmuar rrejshëm.

## 5 DHUNTITË E ALL-LLAHUT XH.SH. NDAJ BENI IZRAELITËVE

Ishin popull që dalloheshin nga popujt e tjerë në kohën e tyre, me besimin e tyre monoteist. All-llahu xh.sh. thotë:  
“O bijtë e Izraelit, përkujtoni dhuntinë Time, të cilën ua dhurova, dhe Unë ju pata (të parët tuaj) dalluar ndaj njerëzve të tjerë (të asaj kohe).”

## PËRBUZJA E SË MIRËS

Mirëpo për shkak të përzierjes dhe fqinjësisë me popujt besëtytë e idhujtarë, ata kishin besim të kotë. Gjithashtu kishin tradita të paditurosisë dhe bënin refuzimin e mësimëve pejgamberike. Po ashtu, në Egjipt kishin adhuruar viçin, e kishin tepruar me shenjtërimin dhe madhërimin e Uzejrit a.s. sa që i kishin kaluar kufijtë e njerëzisë. Kështu e arritën kulmin e turpit me këto që u përmendën, e sidomos kur disa pejgamberëve ua mbathën disa veprime të besëtytnisë e idhujtarisë. Ua mbathën magjinë, mosbesimin (kufrin), veprimet e nënçmuara, e për të cilat nuk i frikoheshin All-llahut xh.sh.

## 7 KRYELARTËSI DHE MBËSHTETJE

Përballë gjithë asaj, ata ishin të tillë që mbështeteshin skajshmërisht në lozën e

tyre, mbështeteshin skajshmërisht në vetëbesim e utopi, dhe thoshin: .... “*Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij...*” Gjithashtu thoshin: “*...Ne nuk do të na kapë zjarri vetëm për disa ditë të numëruara!*”

## 8 LINDJA E ISAIT A.S. ISHTE ÇËSHTJE MBINATYRORE

Lindja e Isait a.s., jeta e tij, thirrja e tij, mënyra e të jetuarit, të gjitha ishin kundërvënëse. Kundërvënia vinte në shprehje ndaj asaj që është shqisore dhe që ishte e njohur dhe e përhapur. Poashtu ndaj traditave të trashëguara, të ligjeve të përshkruara, dhe të çështjeve me vlerë në të cilat besonin çifutët. Kundërvënia shprehet edhe ndaj qëllimeve për të cilat haheshin dhe luftonin ata. Ai (Isai a.s.) lindi në një mënyrë të panjohur (gjer më atëherë), si foshnje në djep u foli njerëzve, u rrit në prehër të një nëne të varfër e të tërhequr nga bota. Jetoj në një kohë përplot

me fyerje, shpifje dhe larg krenarisë e pasurisë. Isai a.s. shoqërohej me të varfërit, u jepte ushqim, ishte i mëshirshëm ndaj tyre, i ndihmonte të dobët të ngratët. Nuk bënte dallim mes të varfrit dhe të pasurit, mes sunduesit e të sunduarit dhe mes autoritarit dhe të mjerit.

## 9 MREKULLITË (MU'XHZET) E ISAIT A.S.

All-llahu xh.sh. e nderoi me peygamberi (dërgatë) dhe shpallje, i zbriti Inxhilin (Dhiatën e Re), e përforcoi me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin) dhe me mrekulli të qarta. Përmes tij All-llahu xh.sh. i shëronte të sëmurët në rastet kur mjekët ishin treguar të paaftë për t'i shëruar. Ai i shëronte të verbërit e të zgjebosurit, dhe me lejen e All-llahut xh.sh. i ngjallte të vdekurit. Gjithashtu bënte nga balta shpendë, e pastaj u frynte, e me lejen e All-llahut xh.sh. bëheshin të gjallë. Gjith-

ashtu u tregonte njerëzve për atë që hanin dhe për atë që mbanin në shtëpitë e tyre.

Me bindje e përsëriste atë që përm-bante Teurati (Dhiata e Vjetër) për ndodhitë e mrekullitë të pejgamberëve dhe për atë çka tregonte fuqinë e All-llahut xh.sh.. Ai me të përforconte besimin dhe përgënjeshtrohte adhurimin sipas ndjenjës së përvojës (së mëparshme). E ata të cilët e mohonin mundësinë dhe fuqinë e All-llahut xh.sh. u ngritën e vendosën se nuk vlente asgjë e re dhe as diç më tepër, pos asaj që kishin ditur dhe që kishin parë.

## 10 THIRRJA E TIJ NË FE DHE PËRGËNJESHTRIMI I TIJ NGA ANA E ÇIFUTËVE

Çifutët e kishin tepruar në përgën-jeshtrimin e tij me paragjykime.

Ndalonin atë që All-llahu xh.sh. e kishte lejuar, dhe lejonin atë që All-llahu xh.sh.

e kishte ndaluar. E ai u ngrit dhe i thirri në fe të vërtetë, në dashuri për All-llahun xh.sh. që mbizotëron çdo dashuri tjetër. I thirri në mëshirë e respekt njerëzorë dhe në barazi për të varfërit.

I thirri ata në një besim të sinqertë, dhe për ta hedhur poshtë gjithçka kishte hyrë në fenë e pejgamberëve nga traditat e paditurisë dhe besimi i padrejtë.

## || ÇIFUTËT I SHPALLIN LUFTË

E gjitha kjo ishte e padurueshme për çifutët, ata i shpallën luftë dhe u bënë me një mendje për ta sulmuar. E goditën me çështje të dyshimta dhe me shpifje. E përfolën me sharje të pista dhe me fjalë të ndyta. Nënë e tij e cila ishte e tërhequr nga bota, e përfllisnin me shpifje dhe fyerje. I bënë pengesa në rrugë, e kundërshtuan dhe e dëbuan.

## 12 RRËFIMI MBI ISANË A.S. NË KUR'AN

Pastaj deshën ta mbysnin atë dhe t'u shporrej nga sytë. Mirëpo, All-llahu xh.sh. e mbrojti, kurse kurthin e ktheu kundër tyre. Ai e ngriti (afroi) atë ndaj të Vetës dhe e nderoi. Andaj, lexoni rrëfimin për të në Kur'an:

*“Përkujto kur engjëjt i thanë: ‘Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit), emrin do ta ketë Mesih, Isai, biri i Merjemes, do të jetë i njohur në këtë botë e në atë botë dhe një nga të afërmit e Allahut xh.sh. E që duke qenë në djep (foshnja) u flet njerëzve, kurse si i rritur është nga të përsosurit.’ Ajo tha: - Zoti im, si mund të kem unë djalë e mua s’më ka prekur njeriu (nuk jam e martuar)? - Ai (Allahu) tha: - Ja, kështu, Allahu krijon çka të dojë. Kur Ai vendos për një çështje, vetëm i thotë: Bëhu! Ajo menjëherë bëhet. Ai (Allahu) ia mëson atij librin (besimin), urtësinë, Teuratin dhe*

*Inxhilin. Dhe, të dërguar te bijtë e Izraelit: - Unë kam ardhur nga Zoti juaj me argument, unë nga balta ju bëj diçka si shpendi, i fryj atij dhe ai me lejen e Allahut bëhet shpend, unë i shëroj të verbërit, të sëmurët në lëkurë, dhe me lejen e Allahut i ngjall të vdekurit; unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e mbani në shtëpitë tuaja. Vërtet, kjo është fakt për ju nëse jeni besimtarë. Dhe (kam ardhur) t'ju vërtetoj Teuratin që e keni para duarsh, t'ju lejoj disa gjëra që u ishin ndaluar, kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra ta kini frikë Allahun dhe më dëgjoni mua. Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Adhuroni Atë, kjo është rruga e drejtë! - E kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim (dhe qëllimin që ta mbysnin), tha: - Kush janë ndihmëtarët e mij për në rrugë të Allahut? - Havarijunët thanë: - Ne jemi ndihmëtarë të fesë së Allahut, ne i besuam Allahut, e ti dëshmo për ne se jemi muslimanë (të bindur, të dorëzuar)! Zoti ynë, ne e besuam atë që e zëbrite (shpalljen), e pasuam të dërguarin (Isanë), pra shënona bashkë me ata që*

dëshmojnë (besimin e drejtë)! - E ata (jahuditë) i kurdisën një dredhi (mbytjen e Isait), Allahu iu kundërvu dredhisë së tyre, Allahu është asgjësuesi më i fuqishëm kundër atyre që bëjnë dredhi. (Përkujto, o i dërguar) Kur Allahu tha: 'O Isa, Unë po të marr ty, po të ngre tek Unë, po të shpëtoj prej (sherrit të) atyre që nuk besuan. E ata që të besuan ty, do t'i ngre lart mbi ata që nuk besuan deri në ditën e kijametit, pastaj vetëm tek Unë është kthimi juaj, e Unë gjykoj mes jush për atë që kundërshtoheshit. Përsa u përket atyre që nuk besuan, Unë do t'i ndëshkoj me një ndëshkim të ashpër në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ata nuk do të kenë ndihmëtarë. E për sa u përket atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre u jap shpërblim të plotë. Allahu nuk i do të padrejtët. Këto që po t'i lexojmë ty (o i dërguar) janë nga ajetet, janë nga Kur'ani i pa të meta. Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj i tha: 'Bëhu!' Ai u bë. E vërteta është (kjo) nga Zoti yt, e ti kurrsesi mos u bëj nga ata që dyshojnë.'"

## 13 BIOGRAFIA DHE THIRRJA E TIJ NË KUR'ANI KERIMIN

Lexoje përshkrimin e të Lartmadhëruarit për biografinë dhe thirrjen e Isait a.s., në fjalët e Tij:

*“Ai (Isai) tha: - Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më jepet) librin dhe më ka bërë Pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqat për sa të jem gjallë! Më ka bërë të sjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë as të padëgjueshëm! Selami (shpëtimi prej Allahut) është me mua ditën kur u lindi, ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal (prej varrit) i gjallë!”*

## 14 LUFTË E HERSHME

Isait a.s. i ndodhi ajo që u kishte ndodhur pejgamberëve para tij. Nga ai u larguan paria dhe udhëheqësia, u mënjantuan të pasurit dhe të fuqishmit, dhe

quajtën nënçmim e turp t'i besonin e ta pasonin. U vinte shumë rëndë të binin nga niveli dhe pozitat siç ishin në udhëheqësi, nga privilegjet dhe zotnilëku. E fjala e All-llahut xh.sh. është e drejtë, ku thuhet:

*“Ne nuk dërguam në asnjë vendbanim ndonjë nga pejgamberët e ku pasanikët të mos i thoshin: - Ne nuk i besojmë asaj me çka jeni dërguar. - Ata thoshin: - Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë, e nuk do të jemi të ndëshkuar.”*

## 15 BESIMI I MASËS SË GJERË DHE TË VARFËRVE

Pasi Isai a.s. u dëshpërua, ngaqë kishte parë se kundërshtonin atë që i kishte ardhur atij nga faktet dhe rregullat e qarta e bindëse, dhe pasi pa se e ulnin meqë i mungonin forca dhe pushteti, ai iu drejtua masës së gjerë dhe të varfërve. Këta ishin të butë, kishin shpirt të pastër, meqë ushqeheshin me duart e

veta dhe me djersën e ballit. Këta nuk lavdëroheshin me lozën e tyre, nuk e mbanin veten në të madh prej lavdëratave dhe autoritetit. Besuan një pjesë prej tyre, ata që merreshin me endje, me peshkatari, farkatari dhe zeje të ndryshme.

## **16** NE JEMI NDIHMËTARË TË FESË SË ALLAHUT

I besuan Isait (Mesisë) a.s., u afruan rreth tij dhe i shtrinë dorën, duke i thënë: “... *Ne jemi ndihmëtarë të fesë së Allahut...*” All-llahu xh.sh. thotë:

“*E kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim (dhe qëllimin që ta mbysnin), tha: ‘Kush janë ndihmëtarët e mi për në rrugë të Allahut?’ Havarijunët thanë: ‘Ne jemi ndihmëtarë të fesë së Allahut, ne i besuam Allahut, e ti dëshmo për në se jemi muslimanë (të bindur, të dorëzuar)! Zoti ynë, ne e besuam atë që e zëbrite (shpalljen), e pasuam*

*të dërguarin (Isanë), pra shënona bashkë me ata që dëshmojnë (besimin e drejtë)!'*

## 17 UDHËTIM DHE THIRRJE

Isai a.s. pjesën më të madhe të kohës e kalonte në udhëtim, prej një vendi në një tjetër. I thërriste Beni Izrailët në besim te All-llahu xh.sh., dëshironte t'i largonte nga besimet e kota, e t'i udhëzonte në besimin te All-llahu xh.sh. Gjatë udhëtimeve dhe qarkullimeve shfaqeshin qartë si vështirësia, lehtësia, ngushtësia, rehatia, uria, por të gjitha i kishte pritur me durim e falënderim dhe merrte ushqim aq sa për t'u mbajtur gjallë.

## 18 HAVARIJUNËT KËRKOJNË SOFËR NGA QIELLI

Havarijunët nuk ishin të atij brumi, që po t'i godiste diçka, të bënin durim, të

ngulmonin, të ishin të përmbajtur dhe të matur. Kështu që kërkuan nga Isai a.s. të kërkonte prej All-llahut xh.sh. t'u zbriste një sofër nga qielli, prej së cilës do të hanin e do të ngopeshin pas urisë dhe do të ushqeheshin pas lodhjes.

## 19 SJELLJA E KEQE

Ata nuk ishin të kulturuar në kërkesat e tyre, dhe thanë: “... a mund të na zbresë një tryezë nga qielli Zoti yt...?” Isanë a.s. nuk e habiti kërkesa e tyre, mirëpo ai e pa të paarsyeshme mënyrën se si iu drejtuan për të. E të gjithë peygamberët nga popujt e tyre kërkojnë dhe i vënë për të besuar në të padukshmen. E mrekullitë nuk janë diçka e jashtëzakonshme për të ndikuar te fëmijët dhe te të paudhëzuarit. Përkundrazi, ato janë fakte nga ana e All-llahut xh.sh. të cilat u shfaqen peygamberëve atëherë kur Ai dëshiron. Me to vihen në dukje argumentet e

All-llahut xh.sh. ndaj robërve, e ato nuk kanë afat as pas shfaqjes së tyre, e as pas mohimit të tyre.

## 20 PARALAJMËRIMI I POPULLIT TË TIJ PËR PASOJA TË TMERRSHME

Isai a.s. u frikua për një gjë të tillë dhe i paralajmëroi për një përfundim të keq. Ai i parandaloi nga të sprovuarit All-llahun e Lartëmadhëruar, meqë Ai është mbi gjithçka.

## 21 NGULM DHE QËNDRESE

Mirëpo, havarijunët bënë kokëfortësi në kërkesën e tyre, dhe përkujtuan se ishin shumë seriozë për atë çështje. Ata përkujtuan se nuk kishin për qëllim sprovimin (e All-llahut xh.sh.), porse dëshironin t'u flinte zemra dhe kjo të

mbetej përkujtesë për breznitë e ardhshme. E Kur'ani flet për ditët e kaluara dhe është argument për saktësinë e kësaj feje dhe për pozitën e besimtarëve të hershëm e havarijunëve të sinqertë.

## 22 KUR'ANI RRËFEN PËR NDODHINË

Të lëmë Kur'anin të rrëfejë për këtë ndodhi:

*“Dhe (përkujto) kur havarijunët thanë: ‘O Isa, bir i Merjemes, Zoti yt a mund të na zbresë një tryezë nga qielli?’ (Isai) tha: ‘Kini frikë Allahun nëse jeni besimtarë!’ (Ata) thanë: ‘Ne dëshirojmë të hamë nga ajo dhe të na binden (edhe më shumë) zemrat tona dhe të vërtetojmë bindshëm se na e the të vërtetën e të bëhemi dëshmues të saj!’ Isai, bir i Merjemes, tha: ‘O Allah, Zoti ynë, zbritna nga qielli një tryezë, të na jetë festë (gëzim) për neve dhe për ata (që vijnë) pas nesh, të jetë argument prej Teje, dhe dhurona se Ti je*

*furnizuesi më i mirë!’ Allahu tha: ‘Unë ua  
zëbres, e kush prej jush mōhon pastaj, e dēnoj  
me një dēnim qē nuk dēnoj asnjē nga njerēzit’.*

## 23 ÇIFUTËT BËJNË PËRPJEKJE PËR TU SHKARKUAR NGA ISAI A.S.

Ishte harxhuar durimi i çifutëve, ishte mbushur gota e armiqtēsisë dhe zemërimit të tyre, dhe dëshironin të shkarkoheshin nga Isai a.s. Kështu që çështjen e tij e ngritën te gjykatësi romak, dhe thanë: “Vërtet ai është njeri kryengritës, ngatërrestar, na nxori nga feja jonë dhe i magjepsi rininë tonë. U bënë çrregullime me të, e përçau çështjen tonë, na i prishi ëndrrat dhe e rëndoi çështjen tonë.”

## 24 PARIMI I HAKMARRËSVE DHE I POLITIKANËVE

Ai është i rrezikshëm për shtetin, nuk i nënshtrohet ndonjë rregulli dhe nuk i përmbahet ligjit. Poashtu, nuk e respekton atë që është autoritet dhe të mëhershmën nuk e quan të shenjtë. Ai është njeri kryengritës, e nëse nuk pengohet e keqja e tij, do të bëhet edhe më keq. Andaj, nuk duhet shpërfillur e keqja sado që të jetë e parëndësishme.

## 25 DINAKËRIA DHE SHKATHTËSIA

Biseda ishte përplot me dinakëri dhe shkathtësi, i ishte dhënë ngjyrë politike. Ata ishin të vetëdijshëm se sa i përket çështjes fetare, ajo nuk ndikonte te gjyqtari dhe nuk e kthjellonte. Meqë parimi i politikës së tyre ishte që mos të ndërhyjnë në çështjet fetare të çifutëve,

për këtë shkak çështjen e përzier me politikë.

## 26 PROBLEMI

Vështirë ishte që gjykatësit e huaj idhujtarë ta vërtetonin saktësisht çështjen. Ata i dinin prirjet dhe shkaqet e armiqësisë të çifutëve ndaj të krishterëve. Ata ishin shumë të angazhuar me çështjet e administratës. Mirëpo, meqë çifutët ishin këmbëngulës dhe kjo kishte zgjatur shumë, (të huajt) deshën ta hiqnin qafe atë çështje e cila ishte bërë boshti i bisedës në shtet.

## 27 ISAIA A.S. NË GJYKIM

Ishte ditë e premte pas zëmrës (iqindisë), natë e shtunë. Çifutët nuk punonin ditën e shtunë, ishte ditë pushimi dhe e ndaluar për punë. Ata ishin

përpjekur me çdo kusht të mbaronte gjykimi para perëndimit të diellit ditën e premtë. Kështu të rehatoheshin me çështjen e Isait a.s., të flinin të qetë dhe të ngriheshin në mëngjes të qetë sa i përket asaj çështje dhe të mos ishin të shqetësuar.

Mirëpo gjykatësi, ndonëse vërtet ishte ngushtuar dhe lodhur me çështjen për të cilën nuk kishte vullnet, por edhe pajtueshmëria e tij për të nuk sillte interes.

Kurse çifutët të tërë ishin bërë sy e vesh për të dëgjuar vendimin (gjykimin). Gjendja e tyre ishte mes shqetësimit e qetësisë dhe mes të jashtëzakonshmes dhe ironisë. E gjykatësi ishte ngushtuar, meqë koha ishte e shkurtër, e dielli kishte marrë për të perënduar. Ndërkaq, vendimi ishte marrë për ekzekutimin e tij, që do të ishte me kryqëzim.

## 28 LIGJI PËR KRIMET NË ATË KOHË

Ligji për krimet i asaj kohe parashihte që i gjykuari me varje ta barte vetë kryqin në të cilin do të kryqëzohej. E vendi i varjes ishte larg, siç ishte rendi në vendet e qytetëruara. Tubimi ishte i madh saqë njerëzit ishin njëri mbi tjetrin. E njerëzit e sigurimit – shumica e të cilëve ishin të huaj – nuk kishin vullnet për këtë çështje. Kështu çështja e çifutëve ishte e koklavitur dhe e papërcaktuar mes tyre dhe të huajve. Koha ishte fillim i mbrëmjes. E disa çifutë të rinj ishin ambiciozë e të vrazhdë, gjatë kalimit të Isait a.s., haheshin kush e kush për sharjen, turpërimin, mundimin dhe nënçmimin e tij.

## 29 ISAI A.S. U NËNSHTROHET TORTURAVE

Isai a.s. ishte lodhur dhe ishte dobësuar nga qëndrimi i gjatë në gjykim dhe nga torturat që kishte përjetuar. E meqë kryqi që e kishte për të bartur kishte qenë i rëndë, nuk kishte mundur të ecte shpejt.

## 30 PLANI HYJNOR

Këtu ka një çështje të lidhur me një të ri izraelit, që mori përsipër bartjen e drurit. Ai ishte ndër ata më ambiciozët, më të vrazhdët, më ngulmuesit në torturimin e Mesisë (Isait a.s.). Ishte prej atyre të cilët u turrën me qëllim për ta përfunduar çështjen sa më shpejt dhe që të shpëtonin nga ajo përgjegjësi e padurueshme.

## 31 MIRËPO ATYRE U KISHTE NGJARE

Kështu pra, i përcjelluri arriti në portën e vendvarjes, ku e sollën xhelatët dhe ia dorëzuan çështjen policisë qytetare. E panë se ishte i riu që barti kryqin, mirëpo kështu ishte përzier xhelati me të shenjtin dhe piskama po shkonte në qiell. Të riun që e barti kryqin e morën për dore, duke kujtuar se ai ishte i gjykuari me kryqëzim. Mirëpo ai po bërtet e pisket dhe njofton pafajësinë e tij, se çështja nuk ka të bëjë me gjykimin dhe kryqëzimin e tij. Megjithatë, i kishte ndryshuar forma në mënyrë ironike dhe mizore. Xhelatët nuk i vinin vesh kësaj çështjeje, e as e kuptonin gjuhën e tij. Meqë, ata ishin romakë dhe grekë nga populli që qeveriste.

## 32 ZBATIMI I VENDIMIT

Dihet se çdo kriminel arsyetohet për kriminalitetin e tij, çdo kriminel bërtet e kukat, mirëpo e morën dhe e zbatuan vendimin. Ndërkaq, çifutët prisnin e koha ishte errësirë e mbrëmjes, kurse ata mendonin dhe ishin të bindur se i kryqëzuari kishte qenë Isai a.s.

## 33 NGRITJA E ISAIT A.S. NË QIELL

Mirëpo, Isanë a.s. birin e Merjemes, All-llahu i Lartmadhëruar e kishte shpëtuar nga dredhia e çifutëve, për ta nderuar dhe për ta pastruar nga mosbesimtarët.

## 34 KUR'ANI FLET PËR NDODHINË

Kjo qëndron në fjalën e All-llahut xh.sh. dhe Ai flet për çifutët:

*“Edhe për shkak të mosbesimit dhe të thënies së tyre shpifëse kundër Merjemes. Madje për shkak të shprehjes së tyre: ‘Ne e kemi mbytur mesinë, Isanë, birin e Merjemes, të dërguarin e Allabut.’ Por ata as nuk e mbytën e as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhdë), vetëm sa u ngjau ashtu. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë në mëdyshje për të (për mbytje) e nuk kanë kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë veten. E ata me siguri nuk e mbytën. Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes. Allahu është i plotfuqishëm, i dijsbëm.”*

E ai është në qiell ashtu si dëshiron All-llahu i Lartmadhëruar për të, e Ai është i gjithfuqishëm për gjithçka. Andaj lindja e tij ishte e çuditshme, jeta e tij dhe çështja e tij... fillim e mbarim ishin të çuditshme dhe mbinatyrore, për t'u

vërtetuar fuqia e All-llahut xh.sh. në përgjithësi.

## 35 ZBRITJA E ISAIT A.S. PARA KIJAMETIT

Ai do të zbresë nga qielli atëherë kur të dëshirojë All-llahu xh.sh. Do të jetë argument kundër atyre nga çifutët dhe të krishterët që e tepruan, do të ndihmohet e drejta e do të nënçmohet pasuesi i të padrejtës. Ashtu siç na ka informuar për të pejgamberi ynë s.a.v.s., dhe siç burojnë informatat nga hadithet e vërteta, të cilat i kanë besuar muslimanët e çdo shekulli, e All-llahu i Madhëruar ka thënë drejt: *“Nuk ka asnjë nga ithtarët e librit, vetëm se ka për t’i besuar atij (Isait) para vdekjes së vet, e në ditën e gjykimit ai dëshmon kundër tyre.”*

# 3 SHHARIQI I TIJ PËR PEJGAMBERINË E MUHAMMEDIT S.A.V.S.

Isai a.s. nuk e kishte përfunduar detyrën në fushën e misionit (dávetit) për shkak të luftimeve dhe dredhive të ashpra të çifutëve kundër tij ngaqë ai ishte i dobët. Kishte pak që e ndihmonin, i largoheshin njerëzit meqë iu përmbajt urdhrit të Zotit të tij. Andaj, ai i lajmëroi njerëzit për një pejgamber që do të vinte pas tij e që do ta përfundonte atë që ai e kishte filluar, Dhe që do ta thoshte gjerësisht atë që ai e kishte thënë shkurtimisht; me këtë plotësohet dhuntia e All-llahut xh.sh. ndaj robërve të Tij dhe sillet fakti i Tij ndaj krijesave të Tij: “*Dhe kur Isai, bir i Merjemes tha: ‘O Beni Izraelitë, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Teuratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!...’*”

# 37 PREJ BESIMIT TË ÇILTËR NË BESIM TË MJEGULLUAR

Ajo që është për t'u çuditur për historinë e feve nga e cila lotojnë sytë dhe për të cilën trazohen zemrat, është se thirrja e Isait a.s. bëri një kthesë për në besimin e drejtë, fenë e lehtë e të barabartë, është larg prej çdo mjegullimi, ndërlikimi, shtrembërimi e ndryshimi.

Gjithashtu, edhe thirrja në të Vetmin All-llah xh.sh., të kërkuarit ndihmë prej Tij, animi dhe dashuria e sinqertë ndaj Tij, u shndërrua në besim të mjegulluar. Poashtu u shëndërrua në filozofi të shtrembëruar prej pasuesve, të cilët e tepruan dhe zmadhuan, duke dalë nga kornizat njerëzore në ato hyjnore, dhe thanë: “*Mesia (Isai a.s.) është bir i All-llahut (xh.sh.)*”, gjithashtu, thanë: “*All-llahu (xh.sh.) ka fëmijë.*”, e po ashtu thanë: “*Vërtet All-llahu (xh.sh.) ai është Mesia (Isai a.s.) i biri i Merjemes*”. Kështu që, prej All-llahut Një, mbështetës për

çdo krijesë, i Cili as s'ka lindur kënd, as nuk është i lindur, formuan familje të përbërë prej tri pjesëve, ku të gjithë janë zota, dhe thanë: “I ati, i biri dhe shpirti i shenjtë.” Andaj, besuan në Merjemen, nënën e Isait a.s. dhe vlerësuan atë me të cilën arrihet shkalla e shenjtërisë dhe e adhurimit. Kështu thanë: “Nëna e All-llahut (xh.sh.)”, përhapën për të idhuj dhe ikona nëpër kisha, i nënshtroheshin asaj të krishterët duke kërkuar mbrojtje, duke iu lutur, duke iu zotuar dhe me përkulje. E All-llahu xh.sh., sepse mohuan atë që besuan dhe për veprimin e shëmtuar të tyre, thotë:

*“Mesia, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar, para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit e tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj se si i kthejnë shpinën së vërtetës! Thuaju: - A adhuroni pos Allahut atë që nuk mund t’ju sjellë as dëm e as dobi? Allahu është që dëgjon (ç’thoni), që di (ç’veproni).”*

# 38 ISAI A.S. THËRRET NË ADHURIMIN E TË VETMIT ALL-LLAH XH.SH.

Ai thirri në adhurimin e të Vetmit All-llah xh.sh. sikurse edhe pejgamberët tjerë, në Inxhil fjala e tij qëndron:  
“Obligim është që ndaj Zotit tënd të përkulesh dhe vetëm Atë adhuroje.”  
(Mateu, 4:10). Gjithashtu fjala e tij:  
“Obligim është që ndaj Zotit tënd të përkulesh dhe vetëm Atë adhuroje.”  
(Luka, 4:8). E All-llahu xh.sh. thotë:  
*“S’është e drejtë, as nuk i takoi asnjë njeriu që t’i ketë dhënë Allahu librin, urtësinë dhe pejgamberinë, e pastaj ai t’u thotë njerëzve: - Bëhuni robër të mi (adhuromëni mua) e jo të Allabut! - (U thotë): - Bëhuni dijetarë të mësimëve të Zotit, ngase u keni mësuar njerëzve librin dhe e keni studiuar atë.” Dhe as që ju urdhëron ai (pejgamberi) që të adhuroni engjëjt, as pejgamberët për zota. Vallë, a ju urdhëroi ai mosbesimin pasi jeni muslimanë?”*

# 39 KUR'ANI E QARTËSON ÇËSH TJEN E DAVETIT (THIRRJES) TË ISAIT A.S.

Kur'ani ka përcjellë – e ai është libër vërtetues i librave të mëparshëm dhe argumentues i tyre – deklaratën e Isait a.s. për besim të sinqertë dhe për thirrje në të, në mënyrë të qartë dhe të dukshme, që s'ka çka të shtohet mbi të:  
“*Bënë kufër (mohuan të vërtetën) ata që thanë: - Allahu është ai, Mesia, bir i Merjemes. - E vetë Mesia (Isai) tha: ‘O Beni Izraelë, adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.’*”

## 40 VENDI I MONOTEIZMIT NË DAVETIN E ISAIT A.S.

Në mënyrë të bukur dhe rrjedhshëm tha se e josh këdo që e njeh monoteizmin (besimin në një të Vetmin Zot), biografinë e pejgamberëve, ai që ka natyrë për të njohur All-llahun e Lartmadhëruar, për t'iu përkushtuar dhe për t'iu frikësuar Atij:

*“Mesia nuk tërhiqet prej asaj se është rob i Allahut, nuk tërhiqen as engjëjt më të zgjedhur. Kush tërhiqet prej adhurimit ndaj Tij dhe bën mendjemadhësi, Ai do t'i ringjallë dhe do t'i tubojë të gjithë pranë Tij. E përsa u përket atyre që besuan dhe vepruan mirë, atyre do t'u përmbushet shpërblimi i merituar, por edhe do t'u shtohet prej dhuntisë së Tij. Përsa u përket atyre që u tërboqën dhe e mbajtën veten kryelartë, ata do t'i ndëshkojë me një ndëshkim fort të dhimbshëm dhe pos Allahut nuk do t'i gjejnë vetes as mbrojtës, as ndihmës.”*

## 4 FAKT MADHËSHTOR NGA FAKTET E KIJAMETIT

Kur'ani e ka përshkruar përmes interpretimit dhe mrekullive të tij një prej fakteve të çuditshme me të cilin shfaqësohet Isai a.s. nga ajo që e përfolën njerëzit dhe e keqtrajtuuan. Megjithatë, ai thirrjen e tij e shpjegon fuqimisht dhe saktësisht. E për këtë çështje gjykohen ekstremistët nga populli i tij, meqë të vetmit ata janë përgjegjës për këtë kriminalitet. Andaj, lexoni Kur'anin, kuptoni vendin e lartë dhe faktin e shkëlqyeshëm:

*“Dhe kur Allahu tha: ‘O Isa, bir i Merjemes, a ti u the njerëzve: - Më besoni mua dhe nënën time dy zota pos Allahut!?’ (Isai) Tha: - Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua të them atë që s’është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, Ti do ta dije. Ti e di ç’ka në mua, e unë nuk di ç’ka në Ty. Ti je më i dijsbmi i të fshehtave. Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që ti më urdhërove; ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta, kam qenë për-*

*çjellës i tyre, e pasi më more mua, Ti ishe roje (dhe dëshmitar) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send! Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robër të Tu, e nëse u fal atyre, Ti je i gjithëfuqishmi, i urti. - Allahu tha: 'Kjo është dita që të drejtëve u bën dobi drejtësia e tyre. Ata kanë xhenete në të cilat rrjedhin lumenj, janë për jetë të pasosur në ta. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Ky është shpëtim i madh. Vetëm i Allahut është sundimi ndaj qiejve e tokës dhe çka ka në to. Ai është i plotfuqishëm për çdo send.'"*

## 42 NGA BESIMI I MJEGULLUAR, NË IDHUJTARI CERGATARE

Thirrësit (misionarët) të krishterë depërtuan në Evropë me vetësiguri. Atje që herët ishin thelluar dhe kishin përhapur idhujtarinë monade (cergatare). Grekët ishin idhujtarë, cilësitë e All-llahut xh.sh. i përshkruanin në formë të zotave të ndryshëm. Për ta gdhendnin idhuj, ndërtonin faltore dhe

statuja. Kështu që kishte zot të furnizimit, zot të mëshirës dhe zot të mbisundimit. Grekët kishin lëshuar rrënjë në idhujtari dhe ishin të dhënë në legjenda. U kishte hyrë në gjak idhujtaria dhe me të ishin bërë mish e shpirt. E romakët adhuronin zota të ndryshëm. Kur tek ata arriti krishterimi, të cilin e ndihmoi Konstantini i Madh, në vitin 306, pasi e pranoi fenë e re, e përvetësoi dhe e bëri fe zyrtare të shtetit. Krishterimi filloi të merrte shumëçka nga besimi i idhujtarisë dhe imitimit romak e filozofisë greke, që në të u fetarizuan gradualisht. Pasi u shuan bazat e pejgamberisë dhe për shkak të naivitetit të lindjes e euforisë së besimit, e pasi në të hynë disa hipokritë dhe i ushqyen me besimin e tyre të hershëm, ua shtuan idhujtarinë, lindi fe e re dhe aty u paraqitën krishterimi dhe idhujtaria krahas njëra-tjetrës.

Kështu pra, krishterimi u bë luftë e hapur dhe qorrrokak përballë asaj në të

cilën printe dhe thërriste Isai a.s. Kjo i ngjan asaj kur udhëheqësi e humb rrugën – me qëllim ose pa të – në errësirën e natës e udhëtimi i tij vazhdon në një rrugë që nuk bashkohet me rrugën e parë deri në fund. Për këtë arsye urtësinë e përpiktë, nuk e di kush pos atij i cili e ka lexuar historinë e kësaj feje. All-llahu xh.sh. i ka cilësuar me humbje çifutët, i ka përshkruar me hidhërim kundër tyre, e në gjuhën e muslimanëve tha: *“Udhëzoni (përforconi) për në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo të atyre që tërboqën kundër vetes hidhërimin, e as të atyre që e humbën veten!”*

Në këtë qëndron edhe tragjedia e Evropës dhe e njerëzimit, të cilin ajo e udhëhoqi një kohë të gjatë, edhe ku vazhdon pushtimi dhe sundimi i tij.

“E All-llahut xh.sh. i takon çështja fillim e mbarim.”



# Përmbajtja

Fjala e Sejjid Kutubit për Hasan en Nedevium	6
Fjala hyrëse e botuesit	9
Parathënie	10
<b>I. KUSH I THEU IDHUJT?</b>	
1. Shitësi i idhujve	15
2. Djali i Azerit	15
3. Këshilla e Ibrahimit	16
4. Ibrahim i thyen idhujt	17
5. Kush e bëri këtë?	18
6. Zjarr i freskët	19
7. Kush është Zoti im?	20
8. Zoti im është All-llahu	22
9. Thirrja e Ibrahimit	23
10. Pranë mbretit (sunduesit)	24
11. Thirrja për prindërin e vet	25
12. Në Mekë	26
13. Pusi i zemzem-it	28
14. Ëndrra e Ibrahimit	28
15. Qabja	30
16. Shtëpia e shenjtë	32
<b>II. RREFIMET MË TË BUKURA</b>	
1. Ëndërr e habitshme	31
2. Zilia e vëllezërve	38
3. Delegacioni për te Jakubi	40

4.Për në mal	41
5.Pranë Jakubit	43
6.Jusufi në pus	44
7.Prej pusit në pallat	45
8.Besnikëria dhe ndershmëria	46
9.Këshilla në burg	47
10.Urtësia e Jusufit	49
11.Këshilla për monoteizmin (njëshmërinë) e All-llahut xh.sh.	50
12.Komentimi i ëndrrave	52
13.Ëndrra e sundimtarit	53
14.Sunduesi e thërret Jusufin nëpërmjet shërbëtorit të tij	55
15.Jusufi e kërkon përgjegjësin e burgut	56
16.Përgjegjës i depove të vendit	57
17.Ardhja e vëllezërve të Jusufit	59
18.Dialogu ndërmjet Jusufit dhe vëllezërve të tij	61
19.Biseda ndërmjet Jakubit dhe Bijve të tij	62
20.Bunjamini te Jusufi	64
21.Te Jakubi	67
22.Zbulimi i fshehtësisë	69
23.Jusufi ia dërgon këmishën Jakubit	71
24.Jakubi te Jusufi	72
25.Përfundimi i mirë	74

### III. ANIJA E NUHIT A.S.

1.Pas Ademit a.s.	79
2.Zilia e shejtanit (satanit)	80
3.Ideja e shejtanit (dreqit)	81
4.Dredhia e shejtanit	82

5.Fotografitë e të mirëve	83
6.Prej fotografive deri te statujat	84
7.Prej statujave e deri te idhujt	85
8.Hidhërimi i All-llahut xh.sh.	86
9.I Dërguari	87
10.Njeri apo engjëll	88
11.Nuhu Pejgamber	89
12.Si iu përgjigj atij populli	90
13.Mes Nuhut dhe popullit të tij	91
14.Ty të besojnë më të ulët	93
15.Argumenti i të pasurve	94
16.Thirrja e Nuhut	95
17.Lutja e Nuhut	97
18.Anija	98
19.Tufani (Përmbytja)	100
20.I biri i Nuhut	101
21.Nuk i takon familjes sate	102
22.Pas përmbytjes	104

#### IV. FURTUNA

1.Pas Nuhut a.s.	107
2.Pabesimtarët Ad	108
3.Armiqësia e Adit	109
4.Pallatet e Adit	110
5.Hudi Pejgamber	111
6.Thirrja e Hudit	112
7.Përgjigjja e popullit	114
8.Urtësia e Hudit	115

9. Besimi i Hudit	116
10. Kokëfortësia e popullit Ad	118
11. Dënimi	119

## V. DEVEJA E POPULLIT THEMUD

1. Pas popullit Ad	125
2. Populli pabesimtar Themud	126
3. Adhurimi i shtatoreve	127
4. Salihu (paqa dhe shpëtimi qoftë mbi të)	128
5. Thirrja e Salihut	130
6. Mëtimi i pasanikëve	131
7. Na zhgënjën mendimi ynë	132
8. Këshilla e Salihut	133
9. "... Unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim..."	135
10. Deveja e Allahut	136
11. Rendi	137
12. Rebelimi i popullit Themud	138
13. Dënimi	139

## VI. PREJ KEN'ANIT NË EGJIPT

1. Prej Ken'anit në Egjipt	143
2. Pas Jusufit	144
3. Beni (Bijtë) Izrailët në Egjipt	147
4. Faraoni i Egjiptit	148
5. Prerja e fëmijëve	150
6. Lindja e Musait	152
7. Në Nil	153

8.Në pallatin e faraonit	155
9.Kush do t'i jepte gji fëmijës	157
10.Në prehrin e nënës së vet	159
11.Deri në pallatin e faraonit	161
12.Të mëshuarit vdekjeprurës	163
13.Del në shesh fshehtësia	165
14.Prej Egjiptit deri në Medjen	168
15.Në Medjen	169
16.Kërkesa	171
17.Martesa	173
18.Drejt Egjiptit	176
19.Shko te faraoni se ai është bërë arrogant	179
20.Para faraonit	181
21.Thirrja për të besuar Allahun	183
22.Mu'xhizet (mrekullitë) e Musait	185
23.Për në shesh	187
24.Mes së vërtetës dhe jo së vërtetës	190
25.Kërcënimi i faraonit	193
26.Nënqumeshmëria e faraonit	195

## VII. BESIMTARI I FAMILJES SË FARAONIT

1.Besimtari i familjes së faraonit	201
2.Këshilla e njeriut	205
3.Bashkëshortja e faraonit	208
4.Sprova e Beni Izrailëve	211
5.Uria	214
6.Pesë shenja	217
7.Të dalët (ikja)	220

8.Përmbytja e faraonit	224
9.Në shkretëtirë	227
10.Mosmirënjohja e Beni Izrailëve	229
11.Kokëfortësia e Beni Izrailëve	231
12.Lopa	233
13.Ligji i Zotit (Sheriati)	236
14.Tevrati (Dhiata e vjetër)	240
15.Viçi	243
16.Ndëshkimi	246
17.Qyqaria e Beni Izrailëve	249
18.Rrugës në kërkim të diturisë	253
19.Komentim	258
20.Beni Izrailët pas Musait	259

### VIII. RRËFIMI MBI SHUAJBIN A.S.

1.Vështrim mbi rrëfimet e kaluara	265
2.Rrëfimi mbi luftën mes së vërtetës dhe të pavërtetës	266
3.E në Medjen (dërguam) vëllanë e tyre Shuajbin...	267
4.Thirrja e Shuajbit a.s.	269
5.Baba i mëshirshëm dhe mësues i urtë	270
6.Përgjigjja e popullit të tij	271
7.Shuajbi e shpjegon thirrjen e tij	272
8.Ne nuk po e kuptojmë shumicën e asaj çka thua	273
9.Shuajbi çuditet me popullin e tij	274
10.Shigjeta e fundit	275

11. Argumenti i prerë	276
12. Përndryshe ata thanë atë që e patën thënë para tyre	276
13. Përfundimi i një populli që e përgënjeshton peygamberin e tij	277
14. E solli mesazhin dhe e përmbushi atë që i ishte besuar (amanetin)	278

#### IX. RREFIMI MBI DAVUDIN A.S.

##### DHE SULEJMANIN A.S.

1. Kur'ani flet mbi dhuntitë e All-llahut xh.sh.	281
2. Të mirat e All-llahut për Davudin a.s.	282
3. Davudi a.s. falënderon për të mirën	283
4. E mira e All-llahut për Sulejmanin	284
5. Të kuptuarit e saktë dhe njohuria e thellë	285
6. Sulejmani e dinte gjuhën e shpezëve dhe të kafshëve	287
7. Rrefimi mbi Hud'hudin (pupëzën)	288
8. Sulejmani e thërret në fenë e tij mbretëreshën e Sebeit	289
9. Mbretëresha këshillohet me parinë e shtetit të saj.	290
10. Dhurata e ofruar!	292
11. Mbretëresha vjen e nënshtruar	293
12. Pallati i madh prej qelqi	294

13. E tash së Bashku me Sulejmanin i dorëzohem Allahut, Zotit të gjithësisë	295
14. Kur'ani flet për Sulejmanin	296
15. Nuk ishte i pafe Sulejmani, por djajtë ishin të pafe	300

#### X. RRËFIMI MBI EJUBIN A.S. DHE JUNUSIN A.S.

1. Rrëfimi mbi Ejubin a.s. është lloj më vete i rrëfimeve	305
2. Durimi i Ejubit a.s.	306
3. Sprovë dhe dhuratë	306
4. Rrëfimi mbi Junusin a.s. dhe urtësia e tij	307
5. Junusi a.s. në mesin e popullit të tij	308
6. Junusi në bark të peshkut	309
7. All-llahu xh.sh. iu përgjigj lutjes së tij	310

#### XI. RRËFIMI MBI ZEKIRJANË A.S.

1. Lutja e Zekirjait a.s. për fëmijë të mirë	315
2. Zotimi i Bashkëshortes së Imranit	316
3. O Zoti im, unë linda vajzë	317
4. Kujdesi i All-llahut për vajzën e mirë	318
5. Frymëzim nga Zoti i Mëshirshëm	319
6. Sihariqi për fëmijën	321
7. Dëshmitë e All-llahut dhe fuqia e Tij	322
8. Jahjai merr për obligim çështjen e thirrjes për të besuar All-llahun xh.sh.	323

## XII. RREFIMI MBI ISANË A.S.

### TË BIRIN E MERJEMES

1. Ndodhia e jashtëzakonshme! 327
2. Çështje e cila është e çuditshme  
fund e krye 329
3. Nënshtrimi i çifutëve shkaqeve  
të dukshme 329
4. Nënçmimi dhe vrazhdësia 331
5. Dhuntitë e All-llahut xh.sh.  
ndaj Beni Izraelitëve 332
6. Përbuzja e së mirës 333
7. Kryelartësi dhe mbështetje 333
8. Lindja e Isait a.s. ishte  
çështje mbinatyrore 334
9. Mrekullitë (mu'xhizet) e Isait a.s. 335
10. Thirrja e tij në fe dhe përgënje-  
shtrimi i tij nga ana e çifutëve 336
11. Çifutët i shpallin luftë 337
12. Rrëfimi mbi Isanë a.s. në Kur'an 338
13. Biografia dhe thirrja e tij në  
Kur'ani Kerimin 341
14. Luftë e hershme 341
15. Besimi i masës së gjerë dhe  
të varfërve 342
16. Ne jemi ndihmëtarë të fesë  
së Allahut 343
17. Udhëtim dhe thirrje 344
18. Havarijunët kërkojnë sofër  
nga qielli 344
19. Sjellja e keqe 345
20. Paralajmërimi i popullit të tij për  
pasoja të tmerrshme 346

21.Ngulum dhe qëndresë	346
22.Kur'ani rrëfen për ndodhinë	347
23.Çifutët bëjnë përpjekje për t'u shkarkuar nga Isai a.s.	348
24.Parimi i hakmarrësve dhe i politikanëve	349
25.Dinakëria dhe shkathtësia	349
26.Problemi	350
27.Isai a.s. në gjykim	350
28.Ligji për krimet në atë kohë	352
29.Isai a.s. u nënshtrohet torturave	353
30.Plani Hyjnor	353
31.Mirëpo atyre u kishte ngjarë	354
32.Zbatimi i vendimit	355
33.Ngritja e Isait a.s. në qiell	355
34.Kur'ani flet për ndodhinë	356
35.Zbritja e Isait a.s. para Kijametit	357
36.Sihariqi i tij për pejgamberinë e Muhammedit s.a.v.s.	358
37.Prej besimit të çiltër në besim të mjegulluar	359
38.Isai a.s. thërret në adhurimin e të Vetmit All-llah xh.sh.	361
39.Kur'ani e qartëson çështjen e davetit (thirrjes) të Isait a.s.	362
40.Vendi i monoteizmit në davetin e Isait a.s.	363
41.Fakt madhështor nga faktet e Kijametit	364
42.Nga Besimi i mjegulluar, në idhujtari cergatare	365



Boton: LOGOS-A

Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Krahasoi: Adnan Ismaili

Redaktor letrar: Fatmire Ajdini - Hoxha

Redaktor artistik & Disenji: Edi Agaqjyshi

Faqosës: Halil Berisha

Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gogjufi

Shtypi: Focus Print - Shkup

[www.LOGOS-a.COM.mk](http://www.LOGOS-a.COM.mk)

